

Doc.Dr.Hfz. Hajredin HOXHA

**VËSHTRIM ISLAM RRETH
FAKTORIT FETAR NË
HISTORINË SHQIPTARE
MODERNE DHE ANTIKE**



Doc.Dr.Hfz.Hajredin Hoxha

**Vështrim islam rreth faktorit fetar në historinë
shqiptare moderne dhe antike**

**College of Sharia and Islamic Studies
Qatar University
Doha-Qatar**

2013

Recensent: Ajni Sinani

Redaktore gjuhësore: Mimoza Sinani

PERMBAJTJA

Parathënie

KREU I PARE

SHQIPTARËT DHE NJËSIA ETNO-KULTURORE E SHQIPËRISË

A – Prejardhja e popullit shqiptar

B- Shqiptarët dhe historia e tyre e devijuar

C – Metodologjia e gabuar shkencërisht në shkrimin e historisë...

D- Historianët shqiptarë dhe termat banale, jo edukativo-arsimoro-shkencore, kundër Perandorisë Osmane

KREU I DYTE

FAKTORI RELIGJIOZ DOMINUES – I INJORUAR NË PERPILIMIN E HISTORISË SHQIPTARE DHE LUFTËRAVE BALLKANIKE

A-Premisa kur'anore të shenjta dhe të vërtetuara historikisht

B-Kronologji historike e thukete te kryqezatave Ortodokse dhe Katolike

KREU I TRETE

ÇËSHTJA LINDORE

A-Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në luftërat ballkanike

B-Motivi i ardhjes së osmanlinjve në Ballkan

C- Faktorët më kryesorë që kanë ndikuar në dekadencën dhe kolapsin e Perandorisë Osmane

KREU I KATERT

KRONOLOGJI E SHKURTËR HISTORIKE, NGA KU VËREHET NATYRA REZISTUESE E SHQIPTARIT, E NXITUR KRYESISHT PREJ SHTETEVE SLLAVE KATOLIKE (NGA KLERI FETAR) NDAJ PUSHTUESEVE TË HUAJ DHE NDAJ (OSMANLINJVE)

KREU I PESTE

Tanzimati dhe pasojat negative të tij mbi popullin shqiptar dhe Perandorinë Osmane

A-Përse Tanziamti?

B-Natyra e Tanzimatit

C-Prishja e marrëdhënieve shqiptare me Perandorinë Osmane

D-Pasojat e Tanzimatit për shqiptarët

E-Si e përjetuan dhe si e interpretuan shqiptarët Tanzimatin?

F-Lindja e idesë së kombit për bashkim kundër armikut

KREU I GJASHTE

Rrethanat politiko-ndërkombëtare dhe lëvizja pansllaviste ruse

A-Pansllavizmi rus – historiku i tij

B-Shpërthimi i krizës lindore

C-Konferenca e Stanbollit

D-Lufta ruso-osmane dhe pasojat e saj mbi shqiptarët (24 prill, 1877-1878)

KREU I SHTATE

Çështja e të shpërngulurve – muhaxhirëve (1877-1885)

A-Shkaqet e ikjes (emigrimit)

B-Qëndrimi i klerit fetar(hoxhallarëve) përballë kësaj dukurie shkatërruese

C-Mënyrat dhe metodat ruse gjatë dëbimit të popullatës muslimane

D -Shpërndarja e muhaxhirëve në vende të ndryshme dhe mënyra e emigrimit të tyre

E- Pasojat e emigrimit

KREU I TETE

Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe rëndësia e saj historike (1877-1885)

A-Themelimi dhe formimi i Lidhjes

B-Rëndësia e Lidhjes

C-Faktorët që ndikuan në lindjen dhe veprimtarinë e saj

Bismil-lahir-rahmanir-rahijm

Me emër të Allahut, Meshirplotit, Meshiruesit

Parathënie

Të gjitha faënderimet dhe lavdatat i takojnë Allahut Fuqiplot dhe Krijuesit Absolut. Përshëndetjet tona më të përzemërta ia dergojmë krijesës më të bukur, zotëriut tonë dhe të gjithë pejgamberëve Muhamedit a.s. familjes së tij, shokëve të tij dhe për të gjithë ata që ndoçën dhe ndjekin rrugën e tij deri në ditën e fundit të kësaj jete.

Lexues të nderuar!

Studimi dhe analiza e historisë së shqiptarëve dhe Shqipërisë është një temë e komplikuar, delikate dhe shumë sensitive. Për t'ia dhënë hakun këtij studimi lypset një angazhim i madh, një periudhe kohore e gjatë dhe një diapazon i gjerë informatash dhe studimesh. Problemi tjetër kyç qëndron në faktin se pothuajse e tërë ajo histori që është hartuar, shkruar dhe studiuar deri më tani ka qenë prej shkencëtarëve, dijetarëve dhe historianëve që janë edukuar dhe përgatitur nëpër kuzhinat marksiste-leniniste dhe, së këndejmi, edhe ato libra e referenca kanë qenë të shkruara sipas metodologjisë marksiste-leniniste, sipas të cilëve me “...lindjen e materializmit dialektik historia u bë shkencë në kuptimin e vërtetë të fjalës...”¹

Kur ta kemi parasysh këtë çështje të rëndësishme dhe kur kjo problematikë kuptohet në këtë mënyrë, atëherë ne, si studiues të rinj dhe që kemi shpëtuar sadopak prej atyre regjimeve dhe

¹ *Historia e popullit shqiptar*, përgatitur nga një kolektiv punonjësish shkencorë të sektorëve të historisë së kohës së lashtë dhe të kohës së mesme, (Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, bot. i tretë, 1967), I, f. 10.

planprogrameve, duhet të jemi më vigjilentë, më syçelur dhe duhet të mos pranojmë çdo gjë që përmendet nëpër ato referenca në mënyrë paushall, pa i kristalizuar e analizuar ato lajme dhe informata, sepse kemi të bëjmë me një periudhë kohore shumë të gjatë, me shekuj të tërë, ku të dhënat historike dhe hulumtimet e studiuesve të ndryshëm tendenciozë i kanë shkelur shumë pak ato terrene dhe mjedise të minuara.

Çështje tjetër është fakti se ne duhet t'i marrim me rezerva² të mëdha zbulimet e gjurmimeve dhe gjurmimeve arkeologjike³ që janë bërë kohëve të fundit⁴ sa i përket ilirëve, të parëve tanë paganë. E them këtë për arsye se ende nuk i është dhënë përgjigjja definitive prej shkencëtarëve dhe historianëve pyetjes

²Historiani dhe dijetari i njohur shqiptar, prof. Dr. Muhamet Pirraku, thotë: "...Të dhënat për kulturën shqiptare të periudhës ilire janë të pakta dhe edhe ato që janë i përkasin kryesisht sferës së kulturës materiale e onomastikës, por gjatë kohës së robërisë romake e bizantine këto të mira materiale të shkruara u zhdukën sepse të huajt synonin asimilimin e plotë të popullsisë ilire..." Muhamet Pirraku, *Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1989), f. 34.

³Ekzistojnë disa studime artistike për monumentet historike që janë bërë prej shoqatës arkeologjike kroate, që është themeluar në Zagreb në vitin 1878, prej disa pionierëve të studimeve ilire si p.sh.: Franc Buliq në Split dhe Sime Ljubic në Zagreb etj. Po ashtu disa studime edhe gjurmime arkeologjike janë bërë afër Sarajevës, në vendin e quajtur Butmir, në vendin Glasinoc në Bosnjën lindore. Po ashtu, në Sarajevë ekziston muzeu *Bosnisch-Hercegovinische londes muzeum* që dëshmon qartë për historikun dhe kulturën e lashtë ilire në këto troje. Edhe në qytetet e tjera të ish-Jugosllavisë, në pjesën e dytë të shekullit të 20-të, janë bërë studime të ndryshme dhe janë themeluar muzeume në Beograd, Shkup, Ljublanë etj. Po ashtu, në lidhje me këtë çështje, janë themeluar edhe disa revista periodike si p.sh. ajo: 'Starinar' në Beograd, 'Glasnik' në Sarajevë, 'Vjesnik' në Zagreb etj. Më gjerësisht shih: *The peoples of Europe- The Illyrians*, f. 8-9. Në Shqipëri regjistrimet dhe zbulimet e para sistematike për lashtësinë ilire janë bërë prej Corl Patch (1904), para Luftës së Parë Botërore, po ashtu prej Camilo Praschniker-it, Arnold Schober-it (1919) dhe studimet e tyre topografike qëndrojnë bazë për studimet moderne ilire. Po aty, f. 10.

⁴Po aty, f. 21.

së shtruar: *Sa për qind të realitetit dëshmojnë zbulimet arkeologjike për identitetin e një fisi apo të një populli?*⁵

Në këtë pjesë hyrëse të punimit tim, me ndihmën e të Madhit Zot, do t'i qasem këtij studimi serioz, duke u bazuar mbi parimin e objektivitetit dhe të paanshmërisë. Do t'iu referohem referencave të ndryshme historike, në gjuhë të ndryshme, me qëllimin e hulumtimit të sinqertë dhe të mirëfilltë. Në mënyrë që të mos bëhem viktimë e ndonjë autori apo historiani do të përdor logjikën time të shëndoshë për vlerësimin, krahasimin dhe pranimin e të dhënave historike që nuk janë të sakta dhe konkrete. Së fundi, meqë jam edhe studiues i teologjisë, nuk do të nguroj dhe as nuk do të hezitoj fare, që kjo histori të studiohet nën hijen dhe dritën e parimeve dhe bazave të fesë islame, të Kur'anit të madhëruar, që njëherësh është edhe referenca, dokumenti dhe libri më i saktë dhe më absolut që ka dëshmuar historia njerëzore, dhe që ende e gëzon atë autoritet, dhe po ashtu do të kemi në konsideratë edhe fjalët e shenjta pejgamberike të të dërguarit të Allahut xh.sh., Muhamedit a.s. Ishte kjo një parahyrje e rëndësishme para se të fillonim të elaboronim disa çështje të historisë sonë shqiptare.

15.06.2013

Doha-Qatar

⁵Siç thotë studiuesi Noel Malcolm në librin e tij *'Kosova një histori e shkurtër'*: "...por rrënojat materiale s'të thonë se ç'gjuhë fliste një popull, veç rastit kur ka mbishkrime, ndërsa në këtë rast mbishkrimet mungojnë..", f. 30.

KREU I PARE

SHQIPTARËT⁶ DHE NJËSIA ETNO-KULTURORE E SHQIPËRISË

A-Prejardhja e popullit shqiptar

Për prejardhjen dhe lashtësinë⁷ e popullit shqiptar është folur, diskutuar dhe shkruar shumë nga autorë dhe historianë të ndryshëm shqiptarë dhe të tjerë. Për shkak se nuk ekzistojnë⁸

⁶Sa i përket emrit 'shqiptar' dhe trajtave të tij, disa thonë se vjen nga fjala shqiptoj, d.m.th. kuptoj - ai që më kupton dhe e kuptoj. Kur dikujt i thuhet shqipëroj, d.m.th. flas çiltazi e jo me një mënyrë të pakuptueshme. Disa të tjerë thonë se vjen nga fjala 'scapo' dhe 'scupwen', d.m.th. rrufë. Disa të tjerë thonë se vjen nga fjala sqep, që është sinonim i shkëmbit. Në disa vende në Shqipëri thuhet shkrep, që s'ka fill bari. Disa të tjerë thonë se fjala shqipe në gegërisht, d.m.th. shpend që kap zogjtë, skifter ose petrit. Shqipja në të shumtën e herëve qëndron nëpër shkrepë nuk është çudi që ta ketë etimologjinë e saj nga shkëmbi. Disa të tjerë thonë se shqiptar, d.m.th. banues i shkëmbinjve, i maleve. (Shih: Mehdi Frashëri, *Historia e lashtë e Shqipërisë dhe e shqiptarëve*, Phoenix, Tiranë, 2000, f. 51-52.) Ndërsa prifti Gjergji Gashi përmend disa trajta të tjera, ku veç të tjerash thotë: Sa i përket rrafshit Arbëri-Shqipëri nuk ka pasur asnjëherë një emër unitar politik. Ata filluan të quheshin: Shkyptar, Shkiptar, Shyptar, Shqiptar dhe vendi i tyre: Shki/p/ni, Shky/p/ni, Shypni, Shqipni, Shqipëri, që iu janë veshur kuptime të ndryshme: bijtë e Shqipes, shqiponjat grabitqare, vend i shkëmbinjve etj. Disa thonë se vjen nga emri latin 'excipere' që do të thotë: Flas në një mënyrë të qartë... Disa autorë të tjerë thonë se kjo vjen nga fjala latine: 'scindere', që do të thotë shqyej tokën-plugoj tokën... Po ashtu nga kjo është nxjerrë një kuptim tjetër: 'scissi' të ndarë nga Bizanti, nga ortodoksia, të mbetur e të pa shkuar me Romën... Pra Shki(p)ni, Shky(p)... të shkëputur... Prindërit tanë serbët i quanin shkinia-shkie. Për mendimin tim të gjitha mendimet dhe trajtat e dhëna kanë lidhshmëri prej së afërmi ose prej së largu me domethënien e fjalës, me përjashtim të mendimit të dytë që nuk pranohet fare sepse nuk ka për mua asnjë lidhje linguistike ose etimologjike me rrënjën e fjalës... Më gjerë shih: Vatikani dhe Arbëria, Gjergj Gashi:10-11.

⁷Po ashtu shih: *Historia e Shqipërisë*, vëll. 1, Tiranë, 1959, Universiteti shtetëror i Tiranës, Instituti i gjuhësisë dhe i historisë, të hartuar nga: Selim Islami dhe Kristo Frashëri, f. 9

⁸Shih Piraku, Muhamet, *Kultura Kombëtare Shqiptare deri në lidhjen e Prizrenit*, 34. Edwin E. Jacques, *The Albanians-an ethnic history...*, f. 11

kurrfarë dokumentesh apo shkresa të shkruara prej vetë ilirëve të hershëm në mënyrë që të jemi më afër burimeve të sakta, historianët, dijetarët dhe analistët e mëdhenj janë detyruar të bazohen në kanale dhe burime të tjera bindëse dhe plotësuese gjatë studimeve të tyre. Gërmimet dhe zbulimet arkeologjike kanë luajtur një rol të pakontestueshëm rreth këtij problemi dhe kanë dhënë një ndihmesë të madhe për këtë çështje tejet serioze. Po ashtu edhe studimet komperative të gjuhëtarëve dhe linguistëve të ndryshëm ndërkombëtarë kanë kontribuar shumë në këtë fushë të historisë.

Ne, më së pari, do të përqendrohemi në studimet dhe analizat e historianëve tanë e pastaj me radhë. Historiani dhe dijetari i famshëm shqiptar prof.dr. Muhamet Pirraku thotë: “ Shqiptarët “siç dihet janë” *pasardhësit e ilirëve të vjetër. Në viset ballkanike, ku u shtrinë në periudhën parakombëtare, ata janë autoktonë dhe vjetërsia e tyre shtrihet së paku deri në periudhën historike mediterane*⁹ *pellazgjike, përkatësisht epike homerike..”*¹⁰

Është i vërtetë fakti se informatat dhe të dhënat historike për këtë popull të lashtë nuk mjaftojnë dhe janë të pakta, kështu që prej këtyre të dhënave nuk të nxirren konkludime dhe rezultate definitive dhe të prera. Këtë realitet e pohon edhe historiani i

⁹ Mendimi i historianit Mehdi Frashëri, në librin e tij: *Historia e lashtë e Shqipërisë dhe e shqiptarëve*, është krejt i kundërt me teorinë e pellazgëve dhe ai e konsideron të gabueshme dhe të kundërt me shkencën (shih faqet: 54-55), po ashtu edhe se ata janë një popull me origjinë thrako-iliriane, (f. 58) dhe se gjuha jonë, nga pikëpamja linguistike, është gjuhë thrako-iliriane (f. 59).

Është e udhës këtu të përmendet edhe mendimi i këtij historiani se: “Shqiptarët e vjetër ndahen në katër pjesë: ilirët-maqedonasit-thrakasit-frigiasit...”, f. 53. Po ashtu, shih: Sami Frashri në: “*Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet*” f. 26.

¹⁰ Muhamed Pirraku, *Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*, (Prishtinë, Instituti Albanologjik, botimi i parë 1989), f. 13. Po ashtu, shih: J. Swire, *Albania-the rise of a kingdom*, (Arno Press @ the New York Times- New York, 1971), f. 4.

përmendur kur thotë: “...Të dhënat për kulturën shqiptare të periudhës ilire janë të pakta dhe ato që janë i përkasin kryesisht sferës së kulturës materiale e onomastikës... Por gjatë kohës së robërisë romake e bizantine këto të mira materiale të shkruara u zhdukën sepse të huajt synonin asimilimin e plotë të popullsisë ilire.”¹¹

Për lashtësinë e popullit shqiptar,¹² respektivisht të ilirëve, flet edhe prifti Gjergj Gashi, i cili thotë: “Po ashtu është vërtetuar se arbërorët janë trashëgimtarë të drejtpërdrejtë të ilirëve, çka do të thotë se historia e tyre është shumë mijëvjeçare, dhe se ata radhiten si një nga popujt më të lashtë të Evropës dhe Ballkanit.”¹³

¹¹M. Pirraku, *Kultura kombëtare shqiptare*, f. 34. Po ashtu edhe historiani Petrika Thëngjilli, kur flet për popullin shqiptar dhe etnogjenezën e tij, thotë se historianët këtu ndahen në dy grupe të kundërta. Grupi i parë mendon se shqiptarët janë të ardhur në trojet ku banojnë sot, për arsye se mungon dokumentacioni historik dhe shqiptarët shikohen si të ardhur me anë të dyndjeve të ndryshme, ku ka edhe historianë që mendojnë se ata janë të ardhur nga Skocia e sotme. Midis autorëve që mbrojnë këtë tezë është edhe studiuesi: Gaston Miller me veprën: *Hulumtime mbi historinë e hershme të shqiptarëve*. Karakteristika kryesore e këtyre tezave është mohimi i vazhdimësisë iliro-shqiptare. Në këto teza ekzistojnë mangësi metodike dhe, pos kësaj, te disa autorë fshihet synimi politik i maskuar i pansllavizmit të vjetër si p.sh. Selishe, Popoviq, Zaimov etj. Ndërsa grupi i dytë përkrah tezën se shqiptarët janë pasardhës të Ilirëve dhe banorë autoktonë. Për shkak të mosekzistimit të dokumenteve, ata janë bazuar në rezultatet e një vargu disiplinash, si arkeologjia, gjuhësia, etnografia, folklori, antropologjia etj... Më gjerësisht shih: Petrika Thëngjilli, *Historia e Popullit Shqiptar* – 395 – 1875, Botimi Toena, Tiranë, 2000, f. 20.

¹²Shih edhe: *The Peoples of Europe- Illyrians*, John Wilkes, f. 3. Është shumë me rëndësi dëshmia e tij se, një mijë vite para ardhjes së sllavëve në Ballkan, ilirët kanë banuar në ato troje (pjesa veriore dhe qendrore e Shqipërisë që janë okupuar prej Jugosllavisë). Po ashtu, shih edhe artikullin e gazetës gjermane: *Hamburgische corespondents*, 15 tetor 1878. (Çfarë kanë të përbashkët me orientalët, kur dihet se janë populli më i vjetër i Ballkanit.) Marrë nga *Skënder Rizaj- Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1877-1885*, (shtypi Drita – Krushë e Madhe, Prizren, 1998), f. 24. Po ashtu në f. 25, flitet për lashtësinë tonë dhe qëndrimin tonë para çdo sundimi: romak, sllav etj...

¹³Gjergji Gashi, Vatikani dhe Arbëria, Onufri publishing house, Tiranë, 1998, f. 7.

Se sa problematike dhe e diskutueshme është çështja e etnogjenezës shqiptare, shihet edhe nga studimi i historianëve tanë dhe debatimi i tyre rreth kësaj çështjeje në librat e tyre, në të cilat ata kanë paraqitur disa mendime dhe teza rreth këtij problemi nga studiues të ndryshëm.¹⁴

Para se të shqyrtojmë tezat e ndryshme rreth problemit të etnogjenezës së popullit shqiptar, është me rëndësi edhe mendimi dhe analiza e mendimtarit, shkrimtarit dhe historianit-historishkruesit tonë shqiptar, Sami Frashërit. Gjatë elaborimit të tij rreth çështjes së pellazgëve, që ishin banorët e parë të Evropës e që ishin vendosur përtej Adriatikut edhe në Itali dhe rreth detit Egje dhe në krahinat¹⁵ Jugore të Ballkanit para helenëve, ai pohon se: *“Shqipëri i thonë gjithë atij vendi, tek rrinë shqiptarët (të cilët) janë m’i vjetri kombevet t’Evropëse. Duket që këta erdhën më parë se gjithë prej mezit t’Azisë¹⁶, n’Europë, edhe këta prunë në këtë vend ditjen’ e të bërit shtëpi me mur si dhe diturin’ e të lëruarit, të mbjellit e të korrurit; se ata njerës, që gjendeshin më parë tyre n’Europë, ishin t’egër e rronin nëpër pyje e nëpër shpella duke ushqyer me pemra t’egëra e me mish gjahu..”*¹⁷ Siç vërehet qartë prej dëshmive dhe pohimeve të Sami Frashërit, shqiptarët kanë ardhur prej

¹⁴ Shih ‘Historia e Popullit Shqiptar’, vëll. I, f. 21.

¹⁵ Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, (i hartuar nga një grup autorësh, A. Kostullari etj.), botim i parë, Rilindja, Prishtinë, 1981, f. 1396.

¹⁶ Po ashtu dhe studiuesi N. Malcolm, e ka përmendur në fusnotën e librit të tij, f. 378 (fusnota: 26), se: “është edhe një territor i njohur për gjeografët klasikë si Albania në Kaukaz: disa autorë të hershëm, si p.sh. diplomati francez De Pukvil, supozojnë se shqiptarët e Ballkanit kanë ardhur nga ajo anë, megjithëse nuk ka kurrfarë lidhjesh ndërmjet këtyre dy trevave.” Po ashtu krahaso edhe me: Historia e lashtë e Shqipërisë dhe e shqiptarëve, Mehdi Frashëri, Phoenix, 2000, Tiranë, f. 64-65. Po ashtu shih: Sami Frashëri, vepra 9 - Personalitete shqiptare në: Kāmûs-al-a’lām, Logos-A Shkup, 1994, Mehdi Polisi, f. 24

¹⁷ Sami Frashëri, *Shqipëria ç’ka qenë, ç’është, e ç’do të bëhetë*, Prishtinë, “Dija”, 1999, f. 17-20.

Azisë së Vogël,¹⁸ domethënë prej Anadollit, gjë që pajtohet me faktin se gjuha e shqiptarëve – siç pohojnë linguistikët dhe historianët – bën pjesë në familjen¹⁹ e madhe të gjuhëve indo-europiane,²⁰ ku përfshihet shqipja, indishtja, iranishtja, greqishtja, latinishtja, gjuhët romane, gjuhët gjermanike, gjuhët sllave, gjuhët baltike etj.²¹

Unë personalisht nuk pajtohem me parimin dhe teorinë²² e studiuesit N. Malcolm i cili thotë: “...se kush ka ardhur i pari në një vend s’kanë asnjë rëndësi kur vjen puna për të vendosur për të drejtat ose gabimet e një situate të sotme politike. Burimet për zhvendosjet më të hershme të popujve ose të fiseve të çojnë në përfundim të gabuar...”²³, sepse gjendja aktuale politike në disa vende të botës si p.sh. në Palestinë dhe situata

¹⁸ Sami Frashëri, Shqipëria ç’ka qenë, ç’është, e ç’do të bëhet, f. 19. Po ashtu shih: J. Swire, *Albania-the rise of a Kingdom*, Arno Press and New York Times-New York Times-New York, 1971, f.(4-5) ribotim

¹⁹ Shih: *The peoples of Europe-the Illyrians*, John Wilkes, f. 3.

²⁰ Ose gjuhë ariane ose hindogjermane, Mehdi Frashëri, *Historia e lashtë e Shqipërisë dhe e shqiptarëve*, f. 52, dhe se shqiptarët i përkasin kësaj fare, e jo semitikëve ose turanëve. Po ashtu shih: Personalitete shqiptare në Kāmûs-al-a’lām, të Sami Frashërit, f. 23-24. Është karakteristike se në këtë vepër Samiu përmend se shqiptarët kane ardhur prej Azisë Qendrore, ndërsa në një libër tjetër përmend: Azia e Vogël, e me sa di unë ekziston një dallim në mes dy Azive...

Samiu përmend edhe mendimin e disa historianëve që pohojnë se shqiptarët kanë ardhur prej një vendi që quhet Albana në Kaukaz-d.m.th. Dagistanit (f. 23, po aty) dhe mendimin tjetër se shqiptarët kanë ardhur prej një fisi nga Arabia (f. 23, po aty). Mirëpo, ai, më pas, përmend studimet e linguistikëve evropianë që kanë bërë studime komperative në mes gjuhës shqipe dhe gjuhëve të tjera ariane ose arianite (po, aty, f. 24).

²¹ *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*, vëll I, f. 720. Po ashtu, shih: Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, përktheu nga angl. Dr. Abdullah Karjakdiu, Botim i dytë, Koha-Prishtinë, 2001, f. 31.

²² Për këtë shih edhe: John Wilkes, *The peoples of Europe-The Illyrians*, (Blackwell Publishers, Ltd, Oxford, UK, 2000), f. 10, ku edhe autori i librit në fjalë potencon qartë rëndësinë e hulumtimit etnik të një populli për arsye se orientimet politike aktuale po zhvillohen mbi ato premisa që një popull mendon dhe beson bindshëm dhe thellë për vetveten.

²³ Po aty, f. 22.

politike momentale tek ne në Kosovë ka dëshmuar dhe ende dëshmon për dobësinë dhe mosqëndrimin e kësaj teorie. Të gjitha ato masakra që u bënë nga dora gjakatare serbe dhe nga regjimi bolshevik dhe sllavo-helenist i Serbisë në Kosovë ishin arsyetim i teorisë në fjalë, se kinse Kosova është toka e bekuar dhe e premtuar e Serbisë! mu ashtu si është Palestina për çifutët sionistë, prandaj kjo tokë e bekuar për çifutët duhet të rikthehet në çdo mënyrë, ashtu sikurse toka e Kosovës iu duhet kthyer serbëve! *“Larg, tepër larg është ajo që ju është premtuar”* – [Kur’ani i Madhëruar, pjesa 18, suretu El Mu’Minune, ajeti 36].

Siç u tha edhe më lart, është e vërtetë se të dhënat historike antike për popullin apo fisin ilir janë të pakta. Historianë të ndryshëm të periudhës bizantine dhe romake, të vendeve të tjera, janë marrë me studimin e zanafillës dhe të etnogjenezës së popujve dhe fiseve të hershme Ballkanike. Shumë studiues, të kategorive dhe niveleve të ndryshme, kanë bërë spekulime historike dhe nuk kanë qenë fare objektivë.²⁴

Edhe sa i përket çështjes së etnogjenezës së shqiptarëve, nga të parët tanë është trashëguar shekuj me radhë se stërgjyshërit tanë kanë qenë ilirët²⁵ dhe se ata kanë qenë të ndarë në shumë fise dhe vendbanime të ndryshme. *“...Mbi bazën e të dhënave dhe burimeve arkeologjike, gjuhësore dhe antropologjike është arritur në përfundimin se kultura dhe etnosi (populli) ilir kanë origjinë autoktone (vendase). Ata lindën dhe u formuan në bazë*

²⁴Për këtë shih më gjerësisht Noel Malcolm, Kosova një histori e shkurtër, f. 34.

²⁵Sami Frashëri thotë: *“...Pa fije dyshimi është konstatuar se ilirët janë gjyshërit e shqiptarëve të sotëm. Janë ruajtur (regjistruar) me saktësi ngjarjet që kanë rrjedhur që dymijë vjet, kurse në këtë kohë nuk mbahet në kujtesë se një popull ka ardhur nga jashtë dhe është vendosur në trojet e shqiptarëve (në Shqipëri)...”* Sami Frashëri, vepra 9, f. 27.

*të një procesi të gjatë dhe të pandërprerë, gjatë mijëvjeçarit të dytë dhe të parë para erës së re ”*²⁶

Nuk e di se kujt i shërben konkludimi i studiuesit N. Malcolm kur pohon: “...edhe njëherë, pra, do theksuar se një histori kaq e lashtë nuk mund të ketë implikime në politikën e sotme. Megjithatë, ideja se ilirët dardanë ishin stërgjyshërit e shqiptarëve mund të ketë një interes sentimental për shqiptarët e sotëm të Kosovës.”²⁷

Këtë teori mund ta konfirmojmë përsëri edhe me pohimin e studiuesit dhe historianit, Edwin Jacques E., i cili pohon: “... Se pellazgët kanë emigruar në Ballkan në kohën parahistorike... se ata kanë qenë paraardhësit e ilirëve..., se ilirët janë paraardhësit e shqiptarëve të sotëm... dhe se gjuha e tyre quhej apo ishte gjuha barbare.”²⁸ Pastaj, në vijim, ky historian përmend studiues të ndryshëm albanologë dhe linguistë të shquar botërorë të cilët, gjatë studimeve dhe hulumtimeve të tyre shumëvjeçare, kanë arritur në konkludime shkencore që konfirmojnë lashtësinë e gjuhës shqipe dhe lashtësinë e etnogjenezës sonë. Ndër ta mund të veçojmë konsullin austriak të Janinës, Johan Von Hahn (1811-1869) i cili, plot dyzet vite, ka shërbyer në Shqipëri dhe ka bërë disa punime linguistiko-historike të cilat flasin dhe konfirmojnë se shqiptarët janë pasardhës të pellazgëve.²⁹

²⁶ *Historia e popullit shqiptar*, vëllimi 4, për vitin e katërt të shkollës së mesme të përgjithshme, shtëpia botuese e librit shkollor, ribotim, 2000, shtypshkronja: Gutenberg-Tiranë, f. 7. Po ashtu shih: *The Albanians-An Ethnic History from Prehistoric Times to the present*, Edwin E. Jacques, Mc Farland and Company, Inc. Publishers Jefferson, North Carolina and London, 1995, f. 28.

²⁷ M.N.Kosova, f. 41.

²⁸ Edwin E. Jacques, *The Albanians - An Ethnic History from prehistoric Times to the present*, Mc Farland & Company, Inc. Publishers Jefferson, North Carolina and London, f. 39.

²⁹ Po aty, f. 39. Po ashtu shih: *Historia e popullit shqiptar*, vëll. I, f. 21. Po ashtu, shih edhe: *Sami Frashëri, Personalitete shqiptare në Kāmûs-al-a'lām*,

Po ashtu edhe studiuesi Nicolas J. Costa e konfirmon lashtësinë e popullit të Shqipërisë, tokës së shqiponjave dhe burgut pa mure, si dhe faktin se shqiptarët janë kombi i vetëm musliman në Evropë, me mbi tre milionë frymë, që ishin të ndarë në dy fise të njohura, Gegët në veri dhe Toskët në Jug dhe se ata kanë qenë një popull i vuajtur shumë.³⁰

Mjaft serioze dhe shkencore kanë qenë edhe konkludimet e shkencëtarëve dhe linguistikëve të famshëm botërorë në lidhje me çështjen në fjalë se: gjuha shqipe e sotme është gjuhë e ilirëve të hershëm dhe bën pjesë dhe është anëtare e gjuhëve indo-europiane.

Sa për ilustrim, këtu mund të radhitim edhe disa shkencëtarë dhe albanologë të tjerë:

1-Filozofi *Godfried Wilhelm Leibnitz*, (1646-1717)

2-Albanologu gjerman *Hans Erich Thunman*, (1746-1778)

3-Linguisti *Franz Bop*, (1791-1867)

4-Filologu italian *Demetrio Ccamarda*,

5-Prof. austriak *Gustav Meyer*, (1850-1900)

6-Shkencëtari francez *Edouard Schneider*,

7-Studiuesi italian *Jeronim De Rada* (1814-1903)

8-Linguisti dhe qeveritari i Libanit gjatë perandorisë Osmane, *Vaso (Basil) Pasha*

9-Albanologu, filologu dhe linguisti kosovar *Eqrem Çabej* (1908-1980), historiani, shkencëtari kosovar dhe punëtori i palodhur *M. Pirraku*

10-Albanologët nga Tirana: *Aleks Buda*, *Shaban Demiraj* e shumë të tjerë.³¹

f. 25. Dijetari Sami Frashëri e përkrah dhe anon nga kjo ide e pellazgëve dhe mundohet t'i japë një kuptim etimologjik në gjuhën shqipe fjalës 'pellazg'.

³⁰ Shih: *Albania-A European Enigma*, Costa, J. Nikollas, Columbia University Press, New York, 1995, f. 5-6. Po ashtu, shih: *Gjergj Gashi, Vatikani dhe Arbëria*, f. 7.

³¹ Për më gjerësisht shih: Edwin E. Jacques, *The Albanians*, f. 30. Po ashtu shih: Nicolas J. Costa, *Albania-A European Enigma* dhe konkludimin e

B – Shqiptarët dhe historia e tyre e devijuar

*“Historia e shtrembër, e njëanshme, tendencioze dhe e gabuar duhet rishkruar, ristudiuar dhe ripërpunuar ... dhe ky obligim është detyrë e historianit.”*³² Po ashtu është prioritet dhe obligim i muslimanit që ta identifikojë të shtrembrën, ta diagnostikojë atë, më pas ta shërojë dhe, së fundi, t’ua tërheq vërejtjen të tjerëve në mënyrë që të mos bëhen viktimat e asaj historie të devijuar.

Shqiptarëve të gjorë, që kanë jetuar para nesh dhe kanë ushtruar detyra të ndryshme dhe atyre që jetojnë tani, pa marrë parasysh se çfarë rangu i përkasin *“...iu është helmuar shpirti dhe iu është ngatërruar mendja nga mashtrimet e teorive marksiste-leniniste-staliniste...”*³³

Historianët shqiptarë, që janë marrë me shkrimin e historisë sonë të “shenjtë”, që nga fillimi i gjysmës së dytë të shekullit të XX-të, kanë qenë vegla dhe instrumente të komunizmit, regjimit marksist –leninist dhe janë përgatitur nëpër kuzhinat e tyre. Vetë realiteti historik i regjimit në fjalë, që ishte i kalbur dhe që u kolapsua në po këtë shekull³⁴, na jep të kuptojmë se çfarë klase njerëzish paskëshin qenë ata dhe se çfarë historie

autorit anti-jugosllav Milovan Ajilas, që pohon se: “Shqiptarët janë populli më i lashtë i Ballkanit; ata janë më të lashtë se sllavët dhe grekët”, f. 1. Po ashtu shih: *Historia e popullit Shqiptar*, vëll. I (grup autorësh), f. 21-46. Po ashtu shih: *Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*, M. Pirraku, f. 33.

³²Justin Mc Carthy, *Death and Exile: The ethnic Cleansing of Ottoman Muslims 1821-1922*, (third printing 1999,USA), 3.

³³Tajar Zavalani, *Histori e Shqipnis*, (Londër,1957), f. 9-11

³⁴Autori Elez Biberaj thotë: “...Më 1989 qeveritë komuniste u kolapsuan në mënyrë dramatike në Poloni, Hungari, Gjermania Lindore, Çekosllovakia, Bullgari dhe Rumani dhe kjo shkaktoi shqetësim të thellë në shtetin e fundit komunist (Në Shqipëri, H. Hoxha) të Evropës..”, *Albania a Socialist Maverick*, 2

mbi baza të kalbura paskan shkruar ata: “...historia jonë kombëtare po rishkruhet në mënyrë që t’i përshtatet nevojave të komunizmit sovjetik dhe legjendave të pansllavizmit rus...”³⁵

S’ka aspak dyshim se, në shkrimin dhe hartimin e teksteve të historisë sonë ateiste, ka pasur ndikim dora e zezë ruse dhe bullgare. Kjo vërehet qartë edhe në parathënien e librit të Historisë së Shqipërisë ku thuhet: “...Redaksia falënderon shkencëtarët sovjetikë e bullgarë që me vërejtjet dhe këshillat e tyre dhanë një ndihmë të çmueshme për hartimin e tekstit...”³⁶

Sa i përket regjimit komunist dhe parimeve të tij regresive dhe shkatërruese, regjim nën të cilin kanë jetuar dhe janë edukuar historianët tanë, këta të fundit ndoshta kanë të drejtë të pjesshme të arsyetohen se kanë qenë nën presionin e tij. Por në këtë punim nuk po e shoh të udhës të diskutohet për ato parime komuniste. Këtu më intereson të them ca fjalë për metodën e materializmit dialektik që është adaptuar prej historianëve në shkrimin dhe hartimin e historisë sonë shqiptare.

Le të shohim se çfarë thonë historianët shqiptarë rreth materializmit dialektik:

1-Në librin: “Historia e Shqipërisë”, në hyrje të librit, redaksia ka theksuar mjaft qartë se: “Duke u nisur nga teza marksiste-leniniste, se proceset politike dhe kulturore nuk mund të kuptohen dhe të shpjegohen drejt në qoftë se nuk shihen në vartësi me proceset ekonomike dhe shoqërore të epokës së tyre,

³⁵Tajar Zavalani, *Histori e Shqipërisë*, f. 9.

³⁶*Historia e Shqipërisë*, (Universiteti shtetëror i Tiranës, 1959), 1

historiografia e re shqiptare i kushtoi qysh në fillim kujdesin e duhur këtij problemi themelor për shkencën historike...”³⁷

Sipas historianit Petrika Thëngjilli: “...*Historiografia tradicionale borgjeze e ndan historinë botërore në epoka në bazë të ngjarjeve politike, kurse historiografia marksiste në bazë të vendeve ekonomike-shoqërore: komuna primitive, historia e lashtë ose rendi skllavopronar, mesjeta ose feudalizmi; historia e re ose vendi kapitalist, historia bashkëkohore ose periudha e socializmit. Kësaj shkence i ishte përmbajtur periodizimi i historisë së Shqipërisë gjatë periudhës së diktaturës komuniste...”³⁸*

Sa i përket kritikës sonë ndaj metodologjisë së materializmit dialektik, në pika të shkurtra, mund të themi shumë dijetarë pohojnë se kjo metodologji nuk qëndron e bazuar fort shkencërisht, për arsye se zbulimet e ndryshme natyrore-shkencore që janë bërë deri tani tregojnë vetëm 7% të zbulimeve të ndryshme dhe se 93% e sekreteve natyrore janë ende të pazbuluara. Pra nëse teoria marksiste është themeluar mbi këtë bazë, ajo përfaqëson vetëm 7% të realiteteve, sekreteve dhe zbulimeve, ndërsa 93% janë ende të pazbuluara.³⁹ Po ashtu edhe teoria marksiste e kontrastit dhe mos përputhshmërisë së gjërave, nuk është e saktë nga aspekti shkencor, si në botën inorganike ashtu edhe në atë bimore, shtazore dhe njerëzore. Poli pozitiv dhe poli negativ p.sh. janë në esencë dy elementë plotësues të njëri-tjetrit. Ata e

³⁷ *Historia e Shqipërisë*, vëll. 2, (Akademia e R P S të Shqipërisë-Instituti i gjuhësisë, Tiranë, 1984), f. 19. Po ashtu edhe në librin: *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll-1, në hyrje të tij thuhet: “...Historia u bë shkencë në kuptimin e vërtetë të fjalës vetëm me lindjen e materializmit dialektit...” *Historia e Popullit Shqiptar*, (Universiteti Shtetëror i Tiranës-Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, vëll-1, 1967), f. 10.

³⁸ Petrika Thëngjilli, *Historia e Popullit Shqiptar 395-1875*, (Shtëpia botuese Toena-Tiranë, 2000), f. 9. (<http://www.teona.al.com>)

³⁹ Ali Xhurejsha, *Rrymat ideologjike bashkëkohore* (Darul Vefa-Almensure, botim i tretë, 1990), f. 162.

kompletojnë njëri-tjetrin dhe nuk ekziston kurrfarë kontrasti dialektik. Përjashtimet që rrjedhin nga kjo teori nuk e ndryshojnë ligjin e përgjithshëm të përputhshmërisë dhe të pajtimit të plusit dhe minusit. Mu këtu ideja e Marksit dështon dhe nuk pranohet shkencërisht.

Nga këndvështrimi religjioz i Kur'anit, ky realitet është i krijuar kështu në esencë. Allahu i Madhërishëm, në Kur'anin famëlartë, thotë: *“Edhe nga çdo gjë Ne kemi krijuar dy palë, me qëllim që ju të përkujtoni dhe të logjikoni.”* [El-Dharijat:49] Po ashtu i Lartmadhëruari, në suren Jasin, ajeti:36, thotë: *“Qoftë lavdëruar Ai që i ka krijuar të gjitha llojet (gjinitë) çift, e çka mbijnë prej tokës, dhe nga ata vetë (njerëzit) dhe nga ajo që ata nuk dinë”*. Prandaj çdo gjë që është themeluar dhe ndërtuar mbi themelet e materializmit-dialektik shembet për tokë. Prandaj edhe interpretimi i historisë me anë të kësaj metodologjie nuk pranohet fare dhe nuk qëndron i saktë shkencërisht. Këtë dështim e ka pohuar edhe vetë Marksi.

Dialektika e cila parasheh idenë e kontrastit (*luftës*) në pjesët përbërëse të materies ose të atomit, të pjesëve (*elementeve*) përbërëse të gjithësisë apo të kozmosit, nuk qëndron e saktë shkencërisht. Lidhja e ngushtë e pjesëve përbërëse të atomit, protoneve dhe neutroneve në bërthamë, dhe elektroneve, që sillen rreth e rrotull bërthamës, funksion në mënyrë harmonike pa kurrfarë problemi. Kjo lidhshmëri (harmoni) gjendet te të gjitha krijesat dhe ky është ai fenomen i (çifteve-dy gjinive) të lartpërmendura në ajetet kur'anore. Krijimi i çdo gjëje me karakteristika pozitive dhe negative apo çifte, nuk do të thotë fare se aty ka kontrast apo mospërputhshmëri.⁴⁰

⁴⁰Më gjerësisht shih: Ali Gjureshe, *El-itxhahatu El-fikrijetu El-dinijetu El-muasiretu*, 185-186.

Nuk ka dyshim se edhe metodat e studimit dhe të shkrimit të historisë të orientalistëve perëndimore kanë kontribuar shumë në këtë fushë. Orientalistët perëndimorë kanë qenë të ballafaquar dhe të influencuar me problemet e tyre shoqërore ekonomike dhe religjioze. Konflikti në mes kishës dhe shkencës, ndërmjet popujve dhe princërve të tyre, ndërmjet katolikëve dhe protestantëve etj., ka ndikuar në mënyrë direkte apo indirekte në shkrimin dhe hartimin e teksteve të historisë.⁴¹

Nuk është e pranuar shkencërisht ideja marksiste e cila mohon çdo gjë që ka të bëjë me etikën ose me anën shpirtërore të njeriut, me pretekst se ajo nuk shihet apo preket me dorë.⁴² Kriteret materialiste nuk mund t'i interpretojnë disa raste të historisë islame p.sh. kur luftëtarët (*muxhahidët*) kthehen prej luftërave dhe mërzen dhe qajnë përse nuk kanë rënë shehidë në luftë. Historia materialiste ekonomiste është e paaftë ta interpretojë këtë dukuri.⁴³ Prandaj të gjitha metodologjitë që janë shpikur për të kuptuarit dhe interpretuarit e historisë, si p.sh.: interpretimi gjeografik i historisë, apo ai biologjik, ekonomik, shoqëror, psikologjik, apo edhe ai politik i Hegelit etj., të gjitha këto metodologji interpretuese të historisë dështojnë dhe nuk na japin një kuptim gjithëpërfshirës absolut për të kuptuarit e drejtë të historisë. Nëse e kemi kuptuar këtë realitet, atëherë neve nuk na mbetet zgjidhje dhe metodologji tjetër për ta kuptuar historinë tonë përveç metodologjisë islame.

Koncepti islamik për historinë qëndron në faktin se ky koncept nuk mjaftohet vetëm me një faktor prej faktorëve të

⁴¹ Shih: Enver Elxhundi, *Tes'hih Ekberi Hatai fi El -Tarih El-Islami El-Sulltanu Abdyl Hamid El-Thani Ve-El-Hilafetu El-Islamijetu*, Kajro, bot.1, 1407, Darul Kutub As salafija, 7.

⁴² Po aty, f. 21.

⁴³ Po aty, f. 21.

lartpërmendur. Në radhë të parë, ky koncept ka parasysh vullnetin apo dëshirën dhe forcën absolute të Allahut Fuqiplotë dhe të kuptuarit e drejtë se ajo forcë është mbi çdo gjë dhe, në radhë të dytë, ky koncept konsiston në faktin se kjo botë ka lidhshmëri të fortë me botën e ardhshme (ahiretin) dhe, po ashtu, ka lidhshmëri të pandashme me vullnetin e njeriut, ndërsa si element apo faktor plotësues dhe kombinues ka parasysh faktorët e lartpërmendur.⁴⁴

Në fund mund të konkludojmë se: historia jonë shqiptare marksiste-leniniste-ateiste, që është shkruar po nga ata persona të të njëjtit regjim dhe me të njëjtën metodologji, për mendimin tim është e helmuar, e devijuar dhe jo e saktë.⁴⁵

Meqë në këtë studim nuk kam referenca të tjera të historisë shqiptare, deri në momentin që po shkruhen këto fjalë, kam qenë i obliguar t'i referohem asaj nga zori dhe jo me dëshirën time. Cila është zgjidhja dhe alternativa tjetër? Zgjidhja është se, nëse dëshirojmë që krimet dhe gabimet të falen dhe të harrohen, atëherë kjo histori e kulluar anti-islame duhet të rishkruhet përsëri prej studiuesve objektivë besimtarë islamë.

C- Metodologjia e korruptuar e historianëve shqiptarë

Gjatë studimit dhe hulumtimit tonë nëpër librat e historisë së shqiptarëve dhe të osmanlinjve kemi vërejtur një dukuri

⁴⁴Po aty, f. 38-39

⁴⁵Krahaso librat që janë shtypur në vitet 1954-1965-1984 me librat e historisë së popullit shqiptar apo historisë së shqipërisë që janë shtypur në vitin 1989-2000, po edhe ma vonë, ke për të vërejtur të njëjtin fenomen dhe të njëjtën metodologji marksiste-leniniste-ateiste në trajtimin e temave rreth përhapjes së fesë islame në trojet tona. Kjo urrejtje vërehet sidomos kur debatohen ngjarjet historike të perandorisë osmane. Kjo do të thotë se e njëjta histori e helmuar mësohet ende nëpër shkollat tona fillore, apo të mesme apo në fakultet.

negative dhe të korruptuar të metodologjisë së historianëve shqiptarë. Kjo dukuri ka qenë dhe është ende në funksion në Perëndim, te studiuesit dhe historianët perëndimorë. Profesori dhe historiani turk Mehmet Maksudoglu, në lidhje me këtë çështje, ka konkluduar se:

1-“...Referencat dhe bazat historike origjinale janë përdorur shumë rrallë prej studiuesve perëndimorë...”

2-“...Nëse janë përdorur ndonjëherë ajo ka qenë minimumi...”

3-“...Realiteti i osmanlinjve ka qenë në një luginë dhe se çka është shkruar për ta ka qenë realitet dhe çka flitet është tjetër...”

4-“...Historia e asnjë populli nuk mund të pranohet metodologjikisht nëse ajo është shkruar dhe hartuar prej këndvështrimeve të të tjerëve dhe nga autorë me profesione të ndryshme dhe tendencioze...”⁴⁶

Kjo metodologji e njëanshme, joobjektive dhe joshkencore është prezent edhe te historianët shqiptarë gjatë paraqitjes së historisë osmane.

5-Historianët shqiptarë nuk janë turpëruar të përdorin edhe shprehje dhe terma banalë gjatë studimeve të tyre. Kjo nuk pranohet metodologjikisht dhe shkencërisht. Ky fenomen negativ është bërë qëllimisht. Ata janë shtyrë nga metodologjia marksiste-leniniste-ateiste dhe kanë pasur si qëllim që t’u japin gjeneratave të reja një imazh të keq për osmanlinjtë dhe fenë islame. Prej këtyre shprehjeve mund të veçojmë këto:

‘Pushtuesi turk’, ‘Zgjedha turke’, ‘Barbarët turq’, ‘Vërshimi turk’, ‘Shtypja e elementit turk’ etj.⁴⁷ Po ashtu kemi hasur edhe shprehje më të rënda banale kundër Perandorisë Osmane si p.sh.: “I sëmuri i Bosforit...”, “...Si ta varrosin të sëmurin e

⁴⁶Shih Mehmet Maksudoglu, *Ottoman History based mainly on Ottoman sources*, International Islamic University-Malaysia, 1993, f. 4-9

⁴⁷Shih cilin libër të duash të historisë shqiptare nën kapitullin ‘Ardhja e turqve në trojet shqiptare’... dhe do t’i gjeshe këto shprehje.

Bosforit...”, „...I dhanë grushtin vdekjeprurës të sëmurit të *Bosforit...*”⁴⁸, „*aparati i kalbur shtetëror...*” Shqiptarët marksist-leninistë nuk janë turpëruar të përdorin edhe etiketime fyese ndaj disa sulltanëve të Perandorisë Osmane, si p.sh. si është rasti i B. Shehut, i cili përdor termin tallës dhe nënçmues:

“...*Dhëparaku Veziri i Madh, Mehmed Rashid Pasha, dëshironte që me mashtrime, ngatërresa dhe premtime të rrejshme...*”⁴⁹ Ose siç është edhe rasti me prof. Dr. Skënder Rizajn, i cili përdor për Sulltan Abdyl Hamidin terma tejet banale, të rënda dhe ofenduese si p.sh. *sulltani dinak, pro-rus, pro-sllav etj.*⁵⁰

Prandaj besoj bindshëm se, me rishkrimin e historisë sonë, këto pika të dobëta dhe të kundërta me shkencën dhe metodologjinë do të evitohen dhe se gjeneratat e ardhshme do të kenë mundësi të lexojnë një histori më të vërtetë, më reale dhe me faqe më të shndritura për fenë islame.⁵¹ Pa dyshim se për t’u realizuar kjo dëshirë duhet të bashkëpunojnë një grup institucionesh të ndryshme dhe kjo duhet të bëhet në mënyrë kolektive, siç është bërë më herët dhe këto institucione duhet të kenë përkrahjen e shtetit dhe të kenë një buxhet të caktuar për hulumtimet e ndryshme që do të kryejnë.

⁴⁸Bedrush Shehu, *Çështja Shqiptare në vitet 30 të shekullit XIX*, (Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1990), f. 35.

⁴⁹Po aty, f. 107.

⁵⁰Shih: Skënder Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1877-1885*. (Krusha e Madhe-Arta), f. 51-150.

⁵¹Për rishkrimin dhe ristudimin e historisë së kulturës shqiptare, qysh në vitet 1989, ka apeluar edhe historiani dhe shkencëtari prof. Dr. Muhamet Pirraku në librin e tij: *Kultura Kombëtare Shqiptare Deri në Lidhjen e Prizrenit*, (Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1989), f. 32.

D- Historianët shqiptarë dhe termat banale, jo edukativo-arsimoro-shkencore, kundër Perandorisë Osmane

Ajo çka është me rëndësi shkencore me studimin dhe analizën tonë është edhe një dukurie negative: ajo e përdorimit të disa shprehjeve jo objektive, jo shkencore, ofenduese, tendencioze, anti-islame etj., të përdorura në historiografinë shqiptare.

Gjatë studimit tim i kam vërejtur këto shprehje, të cilat më kanë shqetësuar shumë dhe thosha me vete: vallë, a me të vërtetë Perandoria Osmane ka qenë e atillë siç e etiketojnë të tjerët? Prej këtyre shprehjeve që kam hasur mund të veçojmë:

1-Pushtuesi turk, 2-Zgjedha turke, 3-Barbarët turq, 4-Vërshimi turk, 5-Përdhunimi osman, 6-Okupimi turk, 7-Islamizim i dhunshëm etj.

Këto terma, për mendimin tim, janë bërë qëllimisht prej historianëve në fjalë dhe nën presionin e diktaturës komuniste enveriste. Edhe pse regjimi enverist-komunist ra dhe mori një rrugë pa kthim, akoma intelektualët tanë i ruajnë këto shprehje nëpër faqet e historisë, për të dëshmuar ende më mirë dhe më qartë qëndrimet e tyre ndaj muslimanëve dhe fesë islame. Këto terma tregojnë joobjektivitetin e historianëve klasikë dhe modernë, tregojnë sekularizmin e tyre, kualitetin e tyre personal dhe profesional që ata janë përgatitur nëpër kuzhinat komuniste, ateiste, dhe anti-islame.

Për dëmet, masakrat, gjenocidin, etnocidin dhe kulturocidin, që kanë shkaktuar perandoritë e ndryshme të mëparshme, si ajo e bizantine, romake, serbe, mbi popullit tonë gjatë tërë historisë shekullore, gati rrallëherë njeriu has në këto terma banale, ndërsa kur vjen çështja e osmanlinjve dhe e fesë islame, që ka

qenë shpëtuesja e vetme për shqiptarët, si do ta shohim më poshtë, terma të tillë i gjen të përdorur me bollëk.

Feja e Allahut xh.sh., si thotë edhe studiuesi i njohur islamik Enver El-Xhundi: “...e ka nxjerrë (shpëtuar) botën në tërësi nga faza fëmijërore e papjekurisë, duke e udhëzuar dhe drejtuar në rrugën dhe fazën e pjekurisë njerëzore...”⁵² dhe se civilizimi i shtetit dhe Perandorisë Osmane ka treguar civilizimin dhe kulturën më të lartë njerëzore që ka ekzistuar ndonjëherë në histori.⁵³

Në lidhje me termat fyes dhe tendenciozë që u përmendën më lart, studiuesi Dr. Hysamedin Feraj analizon këtë hipotezë se (me depërtimin e Perandorisë Osmane në Ballkan dhe sundimin e saj në Shqipëri) kjo ka qenë e dëmshme dhe situata e shqiptarëve u keqësua. Si pasojë e kësaj, historiografia zyrtare në Shqipëri, mbas Luftës së Dytë Botërore, e ka mbajtur dhe e ka mbrojtur këtë hipotezë.⁵⁴

Për mendimin tim, historianët e periudhës së kohës moderne disi po hakmerren me këto shprehje ndaj Perandorisë Osmane.

Ndërsa hipoteza e dytë, nga themelimi i nacionalizmit shqiptar, thotë se situata etnike e shqiptarëve përgjithësisht u përmirësua.⁵⁵

Historiografia shqiptare dhe pjesa dërmuese e intelektualëve shqiptarë modern nuk shohin ndonjë të mirë që u ka sjellë atyre

⁵²Enver El-Xhundi, *Tes’hihu Ekberi Hatain Fit Tarihil Islamij, Esulltanu Abdulhamid Ethanij Vel Hilafetul Islamijetu*, (Korrektimi i gabimit më të madh në Historinë Islame, Sulltan Abdylhamidi i dytë dhe Hilafeti Islam), f. 210.

⁵³Shih Mehmed Maksudoglu, ‘*Ottoman History Based mainly on Ottoman Sources*’, f. 340; Po ashtu shih: Muhammad Asad, *The Road to Mecca*, (Islamic Trust Book, Kuala Lumpur, 1999), f. 5-7.

⁵⁴Hysamedin Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, f. 50.

⁵⁵Po aty, f. 50.

kjo Perandori me ardhjen e Islamit si fe e re për etnikumin shqiptar.

Tani të shohim disa fakte historike dhe shkencore rreth dobive dhe të mirave që ka sjellë Perandoria Osmane për shqiptarët. Sipas studiuesit Hysamedin Feraj, këto të mira mund t'i radhitim kështu si vijon:

*Së pari: "...Depërtimi i Perandorisë Osmane në Ballkan dhe pushtimi i Shqipërisë e gjeti pjesën më të madhe të shqiptarëve nën sundimin serb, bullgar, grek dhe bizantin..."*⁵⁶ dhe këta pushtues kanë qenë më të rrezikshëm për ekzistencën etnike të shqiptarëve se sa Perandoria Osmane, madje rreziku i tyre nuk mund të krahasohet me rrezikun e Perandorisë.

Së dyti: Shqiptarët në mijëvjeçarin e fundit u ndodhën nën perandorinë universaliste, multietnike, multikulturore dhe me organizim social bizantin dhe osman. Perandoria bizantine ishte më rrezikuese për ekzistencën etnike.⁵⁷

Së treti: Perandoria Osmane e frenoi procesin asimilues sllav, grek, bullgar dhe bizantin, duke e shkatërruar atë, dhe i dha fund presionit të saj asimilues etnik. Po ashtu e dobësoi mbretërinë serbe, bullgare, greke dhe e frenoi procesin e sllavizimit dhe të greqizimit të shqiptarëve.⁵⁸

Së katërti: Perandoria Osmane ishte shumë tolerante nga pikëpamja etnike. Ajo nuk ishte institucion vetëm i turqve, por e gjithë klasës sunduese që përbëhej nga popujt e tjerë jo turq,

⁵⁶ Po aty, f. 51.

⁵⁷ Shih po aty, f. 51

⁵⁸ Më gjerësisht, po aty, f. 51.

si arabë, shqiptarë, grekë, boshnjakë, serbë, kurdë, kroatë, hebrej, në duart e të cilëve ndodhej edhe pushteti ekonomik.⁵⁹

Së pesti: Perandoria Osmane nuk ka ushtruar kurrë dhunë sa i përket përhapjes së fesë islame. Ajo ka qenë shumë tolerante në krahasim me ortodoksizmin e shqiptarëve që bëhej me dhunë të egër fizike dhe ekonomike. Islamizmi pranohej vullnetarisht prej masave, në praninë e dy dëshmitarëve dhe gjykatësit. Në disa gjykata të Shqipërisë ende ruhen dokumentet e ceremonialit të konvertimit në Islam vullnetarisht. Islami nuk është përhapur me dhunë dhe me shpatë, siç flitet nëpër librat e historisë klasike dhe bashkëkohore dhe siç beson pjesë dërmuese e intelektualëve sekularistë shqiptarë.⁶⁰

Së gjashti: Shqiptarët, kur e pranuan Islamin, nuk do të thotë se u turqizuan apo u osmanizuan, siç flitet dhe besohet te masa dërmuese laike shqiptare. Ndërsa ortodoksizmi ishte njëkohësisht edhe sllavizim dhe greqizim, ashtu siç u bë në Perandorinë Bizantine. Gjuha sllave dhe greke ishte edhe gjuhë e kishës. Ndërsa me Islamin nuk ishte ashtu. Gjuha e fesë ishte gjuha arabe. Ajo nuk ishte gjuhë e sunduesit dhe nuk paraqiste rrezikun e asimilimit etnik..⁶¹

⁵⁹ Po aty, f. 52, marrë nga: Skënder Rizaj, *Kosova gjatë shekujve*, XV-XVI-XVII, 284. Po ashtu shih: Nexhip P.Alpan-Nesip Kaci, *Shqiptarët në Perandorinë Osmane*, (Monografi, Tiranë, Albin, 1997), f. 35,41,125; Po ashtu shih: Sami Frasheri, *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet*, f. 36.

⁶⁰ Hysamedin Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, f. 53; Po ashtu shih këtë artikull të helmuar në internet të studiuesit: Shefqet Dibrani me titull: *Feja në Shërbim të Kombit*, në: [www.http://yahoogroups.com/feja në shërbim të kombit](http://yahoogroups.com/feja_në_shërbim_të_kombit); Po ashtu shih: Ali M.Basha, *Islami në Shqipëri gjatë shekujve*, f. 19.

⁶¹ H. Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, f. 54.

Së shtati: Administrata civile dhe ushtarake në Shqipëri, gjatë sundimit të Perandorisë Osmane, ishte pothuajse tërësisht shqiptare, ndërsa gjatë pushtimit serb në shekujt e hershëm dhe së fundi në shek. e 20-të, para një dekade, postet administrative u jepeshin serbëve.

Së teti: Shqiptarët sekularistë anti-islamë dhe historianët e tillë, në veçanti duhet të turpërohen prej faqeve të ndritshme të Perandorisë Osmane. Ata, gjatë pesë shekujve, kurrë nuk kanë ushtruar apo organizuar shpërngulje masive të shqiptarëve, siç kanë bërë grekët dhe sllavët prej kohësh, si edhe para dy dekadave në Bosnjë dhe Hercegovinë, e po ashtu edhe viteve të fundit në Kosovë. Tani, para ca viteve edhe sllavët e Maqedonisë po ushtrojnë të njëjtën politike të miqve dhe stërgjyshërve të tyre mbi popullatën shqiptare civile muslimane të pambrojtur,⁶² siç do ta shohim më poshtë.

Së nënti: Perandoria Osmane nuk ka ndërmarrë asnjëherë ndonjë fushatë për ndërrimin e emërtimeve shqiptare, ndërsa pushtuesit serbë, gjatë sundimit bizantin, patën marrë një fushatë intensive të madhe në këtë drejtim, siç është rasti me Shqipërinë e Jugut.⁶³ Kjo traditë e tyre shekullore vërehet në

⁶²Po aty, f. 56; Po ashtu shih: *Muslim Identity and the Balkan State*, Hough Poullton&Suha Taji Farouki, editors, (Hurst&Company, London,1997), f. 168-169; Po ashtu shih artikujt: M. Suflay, *The Illyrians, the Albanians and the Slavs: problems of continuity and symbiosis*, f. 71, E. Pllana, *The Deportation of Albanians from the territory of Sandjak of Nish of Kosovo*, f. 73, Z. Shtylla, *The Deportation of Albanians in Yugoslavia after the Second World War(1950-1966)*, f. 222, Vaso Cubrilovic, *The Problem of Minorities in the new Yugoslavia*, f. 301 etj., në: *The Truth on Kosova*, (The Academy of Sciences of the Republic of Albania, Institute of History, Encyclopedia Publishing House, Tirana, 1993).

⁶³H. Feraj, Skicë e mendimit politik shqiptar, f. 57; “...Qeveria Osmane në Ballkan esencialisht ka qenë qeveri jo asimiluese e popujve të Ballkanit dhe ka qenë qeveri multinacionale në shpirt...” Më gjerësisht, *Muslim Identity and the Balkan State*, f. 15.

dekadat e fundit në Kosovë, ku qeveria sllave ortodokse serbe e serbizoi çdo emër fshati, rruge, qendre etj. Po ta kishte pasur atë synim Perandoria Osmane, për 500 vite, mund të na kishte shlyer edhe prej hartës ekzistuese dhe të kish humbur çdo gjurmë tonën.

Së dhjetë: Historikisht është dëshmuar nga historianët, priftërinjtë etj., se osmanlinjtë nuk ishin pushtues dhe grabitqarë. "...Historikisht është një fakt i dokumentueshëm që sulltanët e parë erdhën në këtë vend me ftesë të princave arbërorë, pra jo për të pushtuar Arbërinë, por për të shuar konfliktet dhe luftën civile ndërmjet principatave..."⁶⁴

Së fundi, mendoj se këto fakte janë mjaft bindëse për intelektualët shqiptarë dhe historianët laikë shqiptarë e perëndimorë, që ata të pendohen dhe të kërkojnë publikisht falje për gabimet e bëra qëllimisht. Ky pendim i tyre pranohet me kushtin që faqet e nxira dhe të devijuara, me shprehje fyese dhe jo shkencore, të largohen prej historisë sonë shqiptare njëherë e përgjithmonë, dhe në vend të atyre gabimeve të interpretohet e vërteta historike siç u tha më lart... Përndryshe atyre nuk ka për t'ua falur kurrë as Allahu xh.sh., as historia dhe as populli.

⁶⁴Gjergj Gashi, *Arbëria dhe Vatikani*, f. 9; Nicollas Costa, *Albania a European Enigma*,8; Stavro Skendi, *Zgjimi kombëtar shqiptar*, (Phoenix, Tiranë, 1967), f. 17.

KREU I DYTE

FAKTORI RELIGJIOZ DOMINUES I INJORUAR NË PERPILIMIN E HISTORISE SHQIPTARE DHE LUFTËRAVE BALLKANIKE.⁶⁵

A-Premisa kur'anore të shenjta dhe të vërtetuara në historinë shqiptare

Nëse shqiptarët do ta kishin pasur të qartë këtë premisë, këshillë dhe realitet kur'anor, gjatë shkrimit të historisë së tyre shekullore, mendoj se shumë çështje kishin për të dalë në shesh, kishin për t'u kuptuar në mënyrë më të drejtë dhe se ata kishin për ta kuptuar se kush ka qenë miku dhe armiku i tyre.

Allahu xh.sh. në Kur'anin famëlartë thotë:

“Kurrë, as çifutët dhe as të krishterët nuk do të jenë të kënaqur me ty (O Muhamed a.s.) derisa ti të ndjekësh fenë e tyre. Thuaju: “Vërtet që Udhëzimi i Allahut (Islami, Besimi i tillë në një Zot të Vetëm) është Udhëzimi i vetëm. Dhe nëse ti, o Muhamed (ose ju o besimtarë), do të ndiqje dëshirat e tyre mbasi që ti ke marrë nga Dija e Lartë (Kur'ani), atëherë nuk

⁶⁵Me këtë studim të thuktë të historisë sonë, assesi nuk pretendoj të shkruaj si historian dhe ekspert i historisë, por si studiues dhe kërkues i së vërtetës absolute historike, edhe pse me specializim jam Teolog Islam dhe ekspert i ekzgjekjes Kur'anore (*Tefsirit dhe shkencave kur'anore*). Do të përpiqem t'i paraqes faktet historike duke u konsultuar me literaturën tonë në gjuhën shqipe në radhë të parë e pastaj edhe literaturat e tjera përkatëse. Me këtë studim kemi synuar t'i bëjmë historiografisë sonë një vështrim të ri, që nuk ka ekzistuar deri tani. Duke i paraqitur faktet historike kemi tentuar të hedhim dritë me dimensionin religjioz-fetar kur'anor rreth zhvillimit të ngjarjeve historike dhe korrektësisë së premisave kur'anore. Kjo metodë e re kur'anore, për studimin dhe analizën e historisë sonë kombëtare shqiptare, kishte për të na dhënë rezultate të tjera ma pozitive që kish me kontribue maksimalisht në mirkuptimin dhe tolerancën reale në mes besimtarëve të besimit Islam me shumicë dhe pakicave tjera fetare në trojet shqiptare.

do të kishe përveç Allahut as Ruajtës as Ndihmues". [Suretul Bekare:120]

Përsëri Allahu i Lartmadhëruar, në Kur'anin Fisnik, thotë:

"Pa dyshim se feja (e vërtetë dhe e vetme dhe e pranuar) tek Allahu Fuqiplotë, është Islami". [Suretu Ali Imran:19].

Allahu, po ashtu, na urdhëron dhe na mëson kështu duke thënë:
"O ju të cilët keni besuar në Allahun xh.sh. mos i zini për miq (mos u miqësoni, mos u shoqëroni) me çifutët dhe me nasranite-të krishterët. Ata janë miq dhe shokë në mes vete dhe për njëri-tjetrit, e nëse ndonjëri prej jush i zë ata për shokë, atëherë nuk ka dyshim se ai është prej tyre, dhe me të vërtetë Allahu xh.sh. nuk e udhëzon atë popull që është keqbërës, mosbesimtar e i padrejtë". [Suretul Maide:51]

B-Kronologji historike e thukte te kryqezatave Ortodokse dhe Katolike

Shqiptarët, historikisht, e kishin pasur traditë të bashkëpunonin politikisht dhe ushtarakisht me popujt fqinjë, me serbët, malazezët, grekët, rusët etj. Ata, po ashtu, kanë bashkëpunuar me Austrinë, me Papatin, Spanjën etj. Këta shqiptarë janë nisur kryesisht nga motivi fetar dhe gjeografik, e jo etnik, për të kërkuar ndihmë dhe shpëtim prej tyre kundër Perandorisë osmane, edhe pse këto shtete, nga pikëpamja etnike, ishin faktor më asimilues se sa Perandoria osmane.⁶⁶

Me të vërtetë është për t'u habitur me këtë dukuri apo këtë traditë të shqiptarëve. Mirëpo përsëri nuk duhet habitur sepse Allahu na ka treguar qysh para katërmëdhjetë shekujve për këtë realitet. Prandaj, prej ajeteve të lartpërmendura, kuptohet

⁶⁶ Më gjerësisht shih: Hysamedin Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, f. 47.

se të gjitha tentimet, luftërat, masakrat, pushtimet e të krishterëve (ortodoksëve dhe katolikëve) dhe kolaboracionistëve të tyre (çifutëve), kanë pasur si qëllim primar dhe parimor që popujt dhe kombësitë e tjerë t'iu nënshtrohen atyre, e më pas të konvertohen në fenë e tyre të shtrembëruar. Historikisht, një tentativë e tillë ka ekzistuar gjatë shekujve deri në ardhjen e osmanlinjve në Ballkan, respektivisht në trojet shqiptare.

Kjo fushatë pansllaviste, ortodokse dhe katolike s'ka reshtur së pushuari me luftërat dhe gjenocidin edhe ndaj Perandorisë Osmane, sepse ata ishin reprezentues të fesë islame-muslimane dhe është duke vazhduar edhe në ditët tona, siç do ta shohim më poshtë kur do të bëjmë një kronologji të shkurtër të historisë sonë.

Viktima dhe vegla të të krishterëve ortodoksë dhe katolikë ka qenë edhe pjesa dërmuese e shqiptarëve, të nxitur nga të krishterët nën maskën e ruajtjes së kombit dhe identitetit shqiptar, me qëllim që edhe shqiptarët muslimanë, së bashku me shqiptarët ortodoksë dhe katolikë, të ngrihen në kryengritje të shpeshta dhe të panumërta kundër armikut të përgjithshëm të tyre, osmanëve.

Faktori fetar, që është injoruar nga studiuesit perëndimorë dhe shqiptarë në historinë e Ballkanit dhe disa vendeve të tjera, e ka preokupuar për së tepërmi edhe studiuesin Justin McCarthy, i cili e ka trajtuar këtë temë në monografinë e tij me vlerë të madhe historike. Rreth faktorit fetar apo realitetit të muslimanëve dhe injorimit të tyre në Ballkan dhe gjetiu, ai thotë:

“...Në vitin 1800, ekzistonte një tokë e gjerë e muslimanëve në Anadoll, në Ballkan dhe në Rusinë Jugore. Muslimanët e

Ballkanit janë zhdukur në mënyrë masive, ose kanë vdekur, ose janë obliguar të emigrojnë dhe të vendosen në grupe të vogla në Greqi, Bullgari dhe në Jugosllavi. Të njëjtin fat kanë pasur edhe muslimanët e Krimesë, Kaukazit Verior dhe Armeninë Ruse. Shkurt, të gjithë ata janë zhdukur. Miliona muslimanë, shumica prej tyre turq, kanë vdekur. Miliona të tjerë janë shpërngulur prej Turqisë. Ndërmjet vitit 1821-1922, mbi pesë milionë muslimanë janë deportuar prej tokave të tyre për në vende të ndryshme. Disa prej tyre janë mbytur nëpër luftëra, të tjerët kanë vdekur nga uria apo sëmundjet e ndryshme si refugjatë. Historia e Ballkanit, Anadollit dhe Kaukazit nuk mund të studiohet dhe të kuptohet në mënyrë të drejtë duke mos i marrë në konsideratë refugjatët muslimanë dhe muslimanët që kanë vdekur... Humbja masive e muslimanëve është çështje shumë e rëndësishme në historinë e turqve (dhe të shqiptarëve, H. Hoxha). Ata muslimanë kanë qenë viktimë të nacionalizmit dhe të imperializmit... Megjithatë në historinë e Perëndimit (dhe të shqiptarëve, H. Hoxha) nuk është shkruar kurrë për mundimet dhe persekutimet e muslimanëve të Ballkanit, të Anadollit dhe të Kaukazit. Historia e këtyre vendeve është shkruar pa u përmendur faktori kryesor i kësaj historie, popullata muslimane...”⁶⁷

Tani le të kthehemi pak prapa në historinë tonë, për të zbuluar dhe kuptuar se çfarë roli ka luajtur faktori fetar në historinë tonë të lashtë dhe atë moderne.

Faktori fetar ka tërhequr kureshtjen e historianit të famshëm shqiptar kosovar, Muhamet Pirrakut dhe, sipas tij, ai ka luajtur një rol të madh në kulturën tonë shqiptare.

⁶⁷Justin McCarthy, *Death and Exile-The ethnic Cleansing of Ottoman Muslims, 1821-1922*, (Third printing, USA, 1999), 1-10.

Ai përmend se në trojet ilire ka ekzistuar feja e krishterë dhe kultura latine romake dhe, në fillim të shek. VI-të, feja e krishterë definitivisht sundoi mbi popullsinë ilire, kur mbreti Justinian i mbyti dhe i eliminoi edhe paganët e fundit në Dardani (Kosovë).⁶⁸

Kur filloi depërtimi i helmit sllav nëpër viset ilire, gjatë shek. VI-VII-të⁶⁹, një pjesë e konsiderueshme e shqiptarëve u konvertuan në fenë ortodokse, ndërsa një pjesë tjetër e madhe, nga frika se mos asimiloheshin, u drejtuan nga viset malore, ku ishte vështirë të kontaktohej me ta, në mënyrë që ta ruanin identitetin e tyre kombëtar e fetar (katolik), sepse historikisht sllavët dhe grekët kanë paraqitur rrezikun më të madh për shqiptarët.⁷⁰

Kjo valë e krishterimit që ishte tek shqiptarët, siç dihet historikisht, kishte kaluar për herë të parë në tokat shqiptare nëpërmjet apostullit Paul, i cili pas zhvendosjeve të tij nëpër viset ilire shkroi: “...Unë e kam predikuar plotësisht misionin-shpalljen e Krishtit.”⁷¹

Për urrejtjen e Kishës Ortodokse greke ndaj shqiptarëve, historia na flet tepër qartë. Në shek. e VIII-të⁷² kishte filluar përçarja mes kishës katolike dhe asaj ortodokse dhe kur mori fund kjo përçarje, më 1054, u formuan dy kisha: ajo katolike,

⁶⁸ Muhamet Pirraku, *Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*, f. 35-36.

⁶⁹ Po aty, f. 36

⁷⁰ J.Swire, *Albania-The Rise of a Kingdom*, 11; dhe shih Elez Biberaj, *Albania a Socialist Maverick*, (USA, 1990), 1; shih dhe Hysamedin Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, f. 108.

⁷¹ Shih *Albania – The Rise of a Kingdom*, f. 7.

⁷² *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. 1, f. 164.

me në krye Papën me seli në Romë, dhe ajo ortodokse me seli në Kostandinopojë. Si pasojë e kësaj, numri më i madh i kishave bizantine mbeti në trojet shqiptare dhe, për këtë arsye, Greqia Ortodokse bëri luftë të rreptë kundër shqiptarëve që ishin katolikë,⁷³ me qëllim që të konvertoheshin në ortodoksizëm.

Ndikimin e faktorit fetar mund ta shohin edhe në rastin e kryqëzatave të para, më 1096, që u nxitën nga Papët e Romës për të çliruar vendet e shenjta të krishterëve, Palestinën, prej turqve selxhukë. Motivi fetar, në ndërmarrjen e aksioneve të njëpasnjëshme kundër muslimanëve, vërehet qartë dhe premisa kur'anore e sipërshtënuar kristalizohet edhe më mirë. Po ashtu, edhe Kisha Ortodokse e Bizantit u përpoq që t'i përdorte kryqtarët kundër selxhukëve.⁷⁴

Në lidhje me dëmet e kryqtarëve ndaj shqiptarëve, historia na flet se një pjesë e këtyre kryqtarëve kaluan nëpër tokat shqiptare, me ç'rast dogjën, plaçkitën, shkatërruan, mjeruan dhe masakruan popullin shqiptar.⁷⁵

Edhe ky rast na jep të kuptojmë më mirë dhe më qartë ajetin e sipërshtënuar kur'anor.

Faktori fetar ka qenë motivi më kryesor në kryqëzatat e normanëve të bekuar nga Papa, në luftë kundër bizantinëve më 1107.⁷⁶ Normanëve u dolën në ndihmë kundër bizantinëve edhe shqiptarët arbëreshë dhe kjo ndihmë u kushtoi shumë

⁷³ Shih Muhamet Pirraku, *Zhvillimi i Kulturës Kombëtare Shqiptare*, 38; dhe: *Albania-The Rise of a Kingdom*, f. 7.

⁷⁴ Shih 'Historia e Popullit Shqiptar', vëll.1, f. 167.

⁷⁵ Po aty, 168; po ashtu shih 'Historia e Popullit Shqiptar', vëll. 4, f. 33.

⁷⁶ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. 4, f. 33.

arbëreshëve, me ç'rast këta e humbën luftën kundër bizantinëve ortodoksë.⁷⁷

Në zhvillimin e ngjarjeve historike vërehet se faktori fetar ka qenë një ndër motivet më kryesore të luftërave. Sipas historianit dhe dijetarit M. Pirraku “...qarqet e larta politike dhe fetare të kishave romake, bizantino-greke, nemanidase-serbe e të samoilit-maqedone, zbatuan luftë permanente e inkuizicion ndaj kulturës shqiptare për të shkatërruar çdo gjurmë të saj dhe më e rrepta kundër kulturës shqiptare mesjetare ishte administrata shtetërore e kishtarë serbe...”⁷⁸

Nuk mund ta marr me mend se si mund të injorohet faktori fetar, nga disa historianë, në nxitjen e popujve dhe të popullit shqiptar për në kryengritje, për luftë, për pushtime të trojeve të popujve të tjerë, kur dihet mirëfilli se kisha serbe ka luajtur gjithmonë rolin më kryesor dhe më të madh në krijimin dhe integrimin etnokulturor dhe gjeo-politik serb, në mënyrë sistematike. Për këtë dëshmojnë objektet kishtarë serbe, ndërtimi i manastireve, siç ishte rasti me ndërtimin e manastirit të parë në Banjske të Ibrit, më 1314. Që nga ajo kohë, por edhe më herët siç u theksua më lart, ata filluan për t'i ndjekur dhe për ta ndaluar rreptësisht ushtrimin e fesë katolike për popullsinë autoktone shqiptare.⁷⁹

Këtë që u tha më lart e konfirmon edhe kjo dëshmi e prof. Hysamedin Ferajt: “...Arritjet e derisotme historiografike kanë provuar se trazirat antiosmane në Shqipëri ishin lokale, kryesisht të motivuara fetarisht dhe ose janë nxitur nga shtetet e vogla evropiane e ballkanike, ose kanë pasur kryesisht

⁷⁷ Më gjerësisht shih ‘Historia e Popullit Shqiptar’, vëll.1, f. 168.

⁷⁸ M. Pirraku, *Kultura kombëtare shqiptare*, f. 42.

⁷⁹ Po aty, f. 43.

*karakter ekonomik, si kundërshtim i rritjes së taksave apo mospagimi të tyre... Ndërsa tendenca separatiste u paraqitën vetëm nga fundi i shek. XVIII-të dhe fillimi i shek. XIX-të...”*⁸⁰

Me këto ngjarje historike kristalizohen akoma më mirë premiset e lartpërmendura kur'anore. Ose të bëhemi sikur ata, ta ndërrojmë fenë, gjuhën, kombin dhe të asimilohemi tërësisht, ose përndryshe na pret lufta, inkuizicioni e likuidimi. Kur'ani na mëson se ata nuk duhet të pasohen në asnjë mënyrë, edhe nëse janë të krishterë, apo të ndonjë sektit tjetër.

Nuk pajtohem me studiuesin Dr. Bedrush Shehun, i cili thotë: *“...Lufta e popullit shqiptar ishte e drejtuar kundër okupatoreve në mbrojtje të interesave ekonomike, politike, shoqërore... Që në fillim po e cekim se krijimi i vetëdijes së popullit shqiptar si komb u bë në bazë të luftës çlirimtare, gjë që s'ka të bëjë me luftën klasore apo fetare...”*⁸¹

Nëse shkojmë nga ai drejtim, që luftën e shqiptarëve ta interpretojmë vetëm për interesa ekonomike, politike etj., atëherë si mund të arsyetohen dhe të interpretohen gjestet dhe veprat ndëshkuese antinjerëzore në kohën e Car Dushanit, më 1349, kur dihet shumë mirë se në kodin e tij civil, që e kishte përpiluar me ndihmën e priftërinjve të kishës ortodokse, ishte shkruar që të mbyteshin të gjithë ata katolikë apo latinë që nuk konvertoheshin në ortodoksizëm,⁸² ose që ata të damkoseshin me hekur të skuqur dhe të zjarrtë në fytyrë. Po ashtu, asnjë martese nuk mund të kryhej sipas rregullave dhe parimeve të fesë katolike, përveçse me praninë e popit serb dhe sipas normave të fesë ortodokse. Në atë kanun (kod):

⁸⁰ Hysamedin Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, f. 46.

⁸¹ Bedrush Shehu, *Çështja Kombëtare Shqiptare në vitet 30 të shek. XIX*, (Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1990), f. 5.

⁸² J. Swire, *Albania-The Rise of a Kingdom*, f. 12.

“... shqiptarëve u caktohej një status i ulët shoqëror dhe ekonomik...Ai filloi edhe sllavizimin e emërtimeve të vendeve, rrënoi një pjesë të madhe të qyteteve dhe të kulturës...”⁸³ Po ashtu, katolikët nuk guxonin t’i pagëzonin fëmijët e tyre dhe as ta kryenin varrimin e të vdekurve sipas normave fetare katolike,⁸⁴ se përndryshe ajo paguhej me jetë. I tërë ai etnocid, gjenocid, kulturocid bëhej nga kodi i Car Dushanit, që ishte hartuar dhe përgatitur nga kisha, që kishte karakter fetar dhe bëhej në emër të fesë, me pretekst të mbrojtjes së ortodoksizmit dhe, në të njëjtën kohë, edhe të luftës së shenjtë ortodokse.

Për realizimin e ëndrrave dhe planeve ortodokse-serbe dhe katoliko-romake, motivi fetar ortodoks-katolik kishte marrë përmasa të mëdha dhe dimensione historiko-kulturore. Kishës katolike i kishte hyrë frika në palcë prej ekspansionit serb. Ajo filloi me ngritjen dhe ndërtimin e peshkopatave nëpër vise të Shqipërisë me qëllim që ta dëshmonte lashtësinë e saj në këto troje. Po ashtu, kisha ortodokse serbe filloi ekspansionin e saj, duke përdorur të njëjtin plan dhe të njëjtën politikë, me ngritjen e monumenteve dhe manastireve në trojet e pushtuara shqiptare, që nga shek. i VIII-XIV-të, e sidomos gjatë dinastisë së mbretit Milutin, 1281-1321. Kështu pra, në Gracanice-Kosovë, më 1321, u ngrit kisha e parë, në vitet 1328-1335 ajo e Deçanit dhe më 1348 Kisha e Shën-Engjëllit (Sv.Arangel).⁸⁵

Ajo çka është me rëndësi për t’u theksuar këtu rreth manipulimit të Kishës, është se të gjitha monumentet dhe manastiret serbe u ngritën mbi themelet e manastireve ekzistuese parasllave dhe u ndërtuan me materialet e atyre

⁸³ Hysamedin Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, f. 42

⁸⁴ Shih Muhamet Pirraku, *Kultura Kombëtare Shqiptare*, f. 47.

⁸⁵ Po aty, f. 43; dhe J.Swire, *Albania-The Rise of a Kingdom*, f. 12.

objekteve parasllave,⁸⁶ me synimin që këto objekte të dëshmonin për lashtësinë dhe autoktoninë e popullit serbo-sllav në trojet shqiptare!

Si u pa gjer më tani, tek ata ka dominuar parulla: *‘Qëllimi (pa marrë parasysh mirë a keq) e arsyeton mjetin dhe metodën e përdorur’*. Qëllimi, sipas tyre, ishte qëllim i shenjtë fetar, ortodoks apo katolik, prandaj nuk ishte me rëndësi se në çfarë mënyre realizohej ai qëllim: me gjenocid, me etnocid, me kulturocid, me manipulim, me pushtim etj. Subhanalla, i Lartë është Allahu që ia shpalli librin e Tij, Kur’anin, robët të Tij, Muhamedit, që të na tërheqë vërejtjen dhe të na bëjë me dije se kush janë të krishterët fanatikë, ortodoksë apo katolikë apo protestantë, në ato premisa të sipërshënuara. Prandaj fjala e Muhamedit a.s., se populli e ndjek fenë e mbretërve të tij, u dëshmua gjatë dinastisë serbe,⁸⁷ ku të gjithë popujt e tjerë detyroheshin të ndiqnin fenë e mbretit të tyre, se përndryshe iu pritej koka, damkoseshin ose i priste vdekja!!

Mrekullia e premisë së tretë kur’anore del në shesh edhe në një rast tjetër historik. Siç dihet historikisht, shqiptarët e vjetër (ilirët) ishin të ndarë në principata⁸⁸ me fe të ndryshme katolike, greke skizmatike dhe “...krahinarët dhe princat shqiptarë të kësaj kohe, herë pas here, formalisht dhe praktikisht e pranonin ortodoksizmin, dhe thuajse të gjithë ishin në lidhje krushqie me dinastitë serbe, greke, vllahe dhe bullgare...”.⁸⁹

⁸⁶ Muhamet Pirraku, *Kultura kombëtare shqiptare*, f. 43, marrë nga: *Istorijsa Naroda Jugosllavije*, (Beograd, 1953), vëll. 1, f. 480-492.

⁸⁷ Për urrejtjen serbe ndaj muslimanëve shih: Justin McCarthy, *Death and Exile-The Ethnic Cleansing of Muslims...*, f. 150.

⁸⁸ H. Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar* (Logos-A, Shkup, 1999), f. 39.

⁸⁹ M. Pirraku, *Kultura kombëtare shqiptare*, f. 49.

Miq, shokë, ndihmëtarë dhe aleatë të njëri-tjetrit... një ide, një besim, të krishterë, katolikë dhe ortodoksë, mu ashtu si na ka treguar Allahu xh.sh. në Kur'anin Famëlartë.

Premisën e lartpërmendur kur'anore, nr. 3, e vërteton edhe kjo ndodhi historike. Disa shqiptarë⁹⁰ katolikë të krahinës së Mirditës e treguan urrejtjen dhe hidhërimin e tyre ndaj shqiptarëve që pranuan fenë islame. Kjo urrejtje nuk mjaftoi me kaq, por ata shkuan aq larg sa që e konsideronin më të afërt një serb, një malazias të fesë ortodokse, se sa një musliman shqiptar!⁹¹ Deri dje, sa ishin katolikë, ishin miq dhe shokë dhe të dashur. Kur e ndërruan fenë, të njëjtët shqiptarë, - nga i njëjti rajon, të njëjtën gjuhë, - u bënë armi..! Ata shqiptarë që e pranuan fenë islame u shndërruan në armiq për shkak se u bënë heretikë, kaluan në fenë islame, në fenë e drejtë të Allahut të xh.sh. dhe në fenë e shpëtimit.

Nga rasti i lartpërmendur mund të konkludojmë edhe për një fenomen tjetër të rëndësishëm historik të shqiptarëve. Ky fenomen ka të bëjë me pyetjen se: A ka ekzistuar tolerancë fetare në mes shqiptarëve, gjatë historisë?

Për këtë çështje ekzistojnë dy mendime të historianëve.

1-Njëri mendim mbron me këmbëngulje dhe bindshëm se në mes shqiptarëve, historikisht, ka ekzistuar kompromisi dhe toleranca fetare dhe se:⁹² “...*Motoja e shqiptarit të Shqipërisë*

⁹⁰Këtu është me rëndësi shkencore të ceket se, përkundër ateizmit dhe laicizmit të disa historianëve shqiptarë, kur bëhet fjalë për fatin e kishës së krishterë në Shqipëri, ata vajojnë se kisha nuk ka mundur të japë kontributin e saj dhe, të emocionuar për krishterimin, shkojnë aq larg sa që nuk ta rrok mendja, si edhe paraqiten si autorë religjiozë, rapsodikë etj. Shih: Tajar Zavalani, *Histori e Shqipnis*, (Tiranë, Phoenix, Fondacioni Soros i Mendimit Shqiptar, Bot. i dytë, 1998), f. 167.

⁹¹M. Pirraku, f. 80.

⁹²Elez Biberaj, *Albannia a Socialist Maverick*, f. 10.

moderne është: *‘Feja e shqiptarit është shqiptaria’, dhe se tradicionalisht në Shqipëri ka pasur një shkallë të lartë të tolerancës fetare dhe se divergjenca fetare nuk ka shkaktuar fare përçarje nacional-kombëtare...*” Apo siç pretendon edhe studiuesi J.Swire se: *“...Konfliktet fetare religjioze në Shqipëri kanë qenë fenomen i injoruar...”*⁹³.

2-Ndërsa mendimi tjetër është se kjo tolerancë fetare ka qenë vetëm formalisht, se kinse ata kanë qenë bashkë kundër armikut të përbashkët–turqve, ndërsa në realitet ata e kanë ruajtur në zemrat e tyre urrejtjen fetare dhe në disa raste, siç u pa më lart, ata e kanë demonstruar edhe publikisht atë urrejtje.

Për mendimin tim; mendimi i grupit të dytë, qëndron më i saktë logjikisht dhe historikisht.

Studiuesi J. Swire, me këtë pohim të tij, tregon në një aspekt edhe dyfytërsinë apo hipokrizinë e disa shqiptarëve të cilët e përqaftuan fenë islame. Sipas disa priftërinjve bashkëkohorë shqiptarë, ata janë quajtur *‘laramanë’* ose *‘kriptokatolikë’*. J. Swire thotë: *“...Pjesa dërmuese e atyre shqiptarëve që u bënë muslimanë janë bërë vetëm me emër (formalisht), ndërsa fshehurazi ata akoma vazhdonin ta admironin fenë e tyre të mëparshme. Fisi i Frashërve p.sh. ka qëndruar i krishterë fshehurazi dhe i ka festuar disa festa të fesë së krishterë gjenerata me radhë...”*⁹⁴

⁹³J.Swire, *Albania-The Rise of a Kingdom*, f. 38,39,40; Po ashtu shih: Mehdi Polisi, *Sami Frashëri, vepra 9, Personalitete shqiptare në Kamus al A’lam*, (Shkup, Logos-A,1994), f. 33.

⁹⁴J, Swire, *Albania-The Rise of a Kingdom*,38; Stavro Skendi, *Zgjimi Kombëtar Shqiptar*, (Tiranë, Phoenix, 2000), f. 23,148; Gjergj Gashi, *Arbëria dhe Vatikani*, (Tiranë, 1998), f. 12

Për urrejtjen dhe armiqësinë e fshehtë fetare, që ka ekzistuar në mes shqiptarëve gjatë historisë shqiptare, dëshmon edhe pohimi i studiuesit Georges Castellan, i cili thotë:

“...Vlen të përmendet se feja islame sunnite kundërbalancohej këtu nga bektashizmi ⁹⁵ dhe nga kriptokristianët (katolikë dhe ortodoksë), që mbanin dy emra, ⁹⁶ të krishterë dhe muslimanë, në fshat përballë administratës osmane. Këto forma të tolerancës dhe të kompromisit nuk mjaftonin për t’i zhdukur rivalitetet dhe urrejtjet mbi bazën e fesë, të cilat shpesh nxiteshin nga klerikë të lidhur me shtetet protektore përkatëse, Greqia për ortodokset, Austria dhe Italia për katolikët..” ⁹⁷

Së fundi, mund të konkludojmë se pjesëmarrja e disa katolikëve në luftëra dhe kryengritje, së bashku me shqiptarët muslimanë kundër turqve, për mendimin tim, ka qenë formale, e përkohshme, me karakter krishtero-katolik, për interesat e tyre personale dhe fetare dhe është nxitur nga shtetet katolike: si Austria, Italia etj. Prandaj ne shqiptarët muslimanë nuk duhet të mashtrohemi nga disa pjesëmarrje të tyre nëpër luftëra, që t’u japim atyre diçka më tepër se sa e meritojnë, ose t’i zëmë për miq dhe aleatë të ngushtë kur dihet historikisht se: *“...Kisha (katolike) dhe kleri ortodoks, në përgjithësi, luajti rol*

⁹⁵Bektashizmi është një sekt musliman shiit i devijuar nga Sunneti profetit Muhamed alejhi salam dhe Kur’ani i Madhëruar. Qendra shpirtërore pas Anadollit është Shqipëria. Më gjerësisht shih edhe punimin e autorit të këtyre rreshtave me titull: *The Bektashi Order of Dervishes-History and Doctrins*.

⁹⁶Shih, *Historia e Shqipërisë*, vëll. 2, 366-368; Mehdi Frasheri, *Historia e Lashtë e Shqipërisë*, (Tiranë, Phoenix, bot. i dytë, 2000), f. 35, ku edhe pohon një hipotezë shumë të çuditshme dhe anti-islame për mendimin tim, ku thotë: *“...se katolicizmi dhe bektashizmi kanë qenë në të mirën e kombit shqiptar, ndërsa sunnizmi dhe ortodoksizmi ka qenë për të kundërtën...”*, f. 48.

⁹⁷Georges Castellan, *Historia e Ballkanit, shek XIV-XX*, (Çabëj, Libra për një shoqëri të hapur, 1991), f. 128.

*negativ kundrejt interesave të popullit shqiptar. Kështu shqiptarët gegë ortodoksë, kuptohet ata që kanë mbetur pa u islamizuar, apo shqiptarët katolikë të ortodoksizuar, u serbizuan dhe u malazezuan, ndërsa shqiptarët toskë ortodoksë u greqizuan dhe u maqedonizuan në një masë të konsiderueshme...”*⁹⁸

Populli shqiptar në përgjithësi, e sidomos intelektualët bashkëkohorë, e përkrahin shumë mendimin e parë të historianëve se kinse toleranca fetare ka qenë prezent me shekuj në mes shqiptarëve muslimanë dhe atyre katolike, dhe e ekzagjerojnë tepër këtë çështje duke u bazuar në disa studime tendencioze të studiuesve perëndimorë, si edhe duke u bazuar në praktikën e rretheve të ngushta familjare, p.sh. burrë-grua, prind-fëmijë, siç është rasti edhe me studiuesin Ali. M. Basha, i cili pohon se harmonia dhe toleranca fetare ka arritur në atë shkallë saqë në një tepsi piqej byreku i gatuar gjysmë me mish derri e gjysmë me mish deleje apo qengji, ku grua ja hante me një rën anë dhe burri në anën tjetër!⁹⁹

E them këtë për arsye se kjo nuk mund të merret për bazë definitive dhe të përgjithshme për tërë historinë shqiptare dhe shqiptarët. E dyta është fakti se jo tërë shqiptarët kanë qenë të martuar me gra katolike, që byreku të bëhej edhe me mish derri edhe me mish qengji. Këto janë raste të rralla dhe përjashtohen nga gjendja e përgjithshme e shqiptarëve, prandaj një gjë e tillë nuk mund të merret si bazë historike.

Edhe lufta e fundit në Kosovë dëshmon për inferioritetin e katolikëve ndaj muslimanëve. Numri i katolikëve që kanë vdekur në luftën e fundit nuk e kalon dhjetëshin dhe objektet

⁹⁸Hysamedin Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, f. 41, marrë nga: Skender Rizaj, *Kosova gjatë shekujve XV-XVII*, (Prishtinë, 1982), f. 470-471.

⁹⁹Më gjerësisht, Ali M. Basha ‘Islami në Shqipëri gjatë shekujve, (Tiranë, 2000), f. 95.

fetare të katolikëve (kishat) nuk janë prekur nga paramilitarët serbë. Ndërsa sa u përket xhamive, shtrohet pyetja se sa prej pesëqind xhamive të Kosovës kanë ngelur pa u bombarduar, pa u djegur dhe pa iu këputur minarja?!!

KREU I TRETE

ÇËSHTJA LINDORE

A-Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në luftërat ballkanike

Gjatë studimit dhe leximit të historisë së Ballkanit në përgjithësi dhe të shqiptarëve në veçanti, kemi hasur mendime të ndryshme të studiuesve të ndryshëm të historisë. Ata kanë përmendur disa faktorë që kanë ndikuar në këto luftëra. Ne do ti cekim këta faktorë, duke mos u thelluar në analiza të hollësishme. Këta faktorë, në mënyrë të përgjithshme, mund të radhiten si vijojnë:

1. Konflikti mes Austro-Hungarisë dhe Rusisë se cila prej tyre është më superiore dhe se cila prej tyre meriton të jetë udhëheqëse në Ballkan.
2. Dobësimi dhe shkatërrimi i Perandorisë Osmane.
3. Ringjallja e çështjes nacionale turke në Evropë për vetëqeverisje, si rezultat i Revolucionit Francez, sidomos nacionalizmi i të krishterëve që ishin në Perandorinë Osmane, kur ata filluan të ndiejnë superioritet mbi të tjerët.
4. Ekspansioni imperialist i Rusisë, dhe Pansllavizmi i saj..
5. Për mendimin tim, konkluzionet e konferencës së Berlinit dhe të Londrës, Marrëveshja e Shën Stefanit etj., kanë qenë prej faktorëve më kryesorë në shpërthimin e luftërave shqiptare në Ballkan kundër Perandorisë Osmane, gjë që i revolttoi ata dhe shkaktoi indinjatë të thellë tek ata.

6. "...Krijimi i shteteve të pavarura fqinje: Serbisë, Greqisë, Malit të Zi, Bullgarisë, dhe rreziku i copëtimit territorial të territoreve etnike shqiptare ndërmjet këtyre shteteve fqinje..."¹⁰⁰
7. Reformat administrative centralizuese – Tanzimati (1839), kundërshtimi i tyre nga masat e privileguara shqiptare dhe ardhja e zyrtarëve të huaj nga Porta e Lartë në këto vende shqiptare, shkaktoi revoltën dhe kryengritjen e tyre.¹⁰¹

Prandaj, nga ato që u thanë më lart, për definicionin e çështjes lindore mund të konkludojmë se:

*"...Ngjarjet ballkanike, qëllimet pushtuese të fuqive të mëdha evropiane ndaj popujve të Ballkanit, përpjekjet e tyre për ndarjen e tokave të Ballkanit, marrëveshjet diplomatike mbi Turqinë dhe me Turqinë, pretendimet e pavarura të çështjeve dhe të pozitave të popujve të robëruar, pranimi apo mospranimi i lëvizjeve të tyre çlirimtare dhe gjithçka që ndodh në Ballkan dhe në lidhje me të, u pagëzua si Çështje Lindore..."*¹⁰²

B-Motivi i ardhjes së osmanlinjve në Ballkan

Sa i përket motivit të ardhjes së osmanlinjve në Evropë (në Ballkan), mund të thuhet se ai ka qenë thjesht për qëllime fetare, për të përhapur Islamin, mesazhin Kur'anor dhe atë profetik në këto troje të krishtera, në mes të të cilave ka qenë edhe trualli i Shqipërisë.

¹⁰⁰ Hysamedin Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, f. 38.

¹⁰¹ Po aty, f. 38. Më gjerësisht shih edhe Skënder Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1877-1885*, (Krushë e Madhe, Prizren, 1998), f. 8.

¹⁰² Bedrush Shehu, *Çështja shqiptare në vitet e 30 të shek. XIX-XX*, f. 15.

Ky motiv mund të kuptohet edhe nga një rast historik kur Sulltan Sulejman Kanunin (e madhërishtë) e vizitoi ambasadori i Hungarisë, më 1526, me rast Sulltani i tha atij:

*“...Kryqëzatat evropiane kishin vendosur t’i kërcënonin të parët e mi përgjithmonë. Ato kishin akumuluar retë e krishterimit, mirëpo ato re nuk e prunë shiun (teksti ne origjinal). Po të mos ishin të krishterët (kryqëzatat) shkaktarë të kësaj lufte (fitorja e Moha’s) nuk kishte për t’u derdhur kaq shumë gjak në këtë luftë.”*¹⁰³

Nga kjo deklaratë e Sulltan Sulejman Kanunit, mund të kuptojmë se qëllimi i ardhjes së tyre në Ballkan (Evropë) ka qenë mbrojtja dhe protektorati i muslimanëve të Ballkanit prej kryqëzatave, që ata të mos konvertoheshin në krishterizëm. Për mendimin tim, ky ka qenë motivi kryesor dhe primar. Ky motiv nënkupton edhe ekspansionin politik dhe gjeografik të Perandorisë Osmane, krahas atij Islam, pasi që nuk ekziston kurrfarë antagonizmi mes ekspansionit fetar dhe atij politik.

Sa i përket ardhjes së osmanlinjve në trojet shqiptare, ajo ishte pikërisht me ftesë të disa principatave shqiptare të Shqipërisë, për t’i ndihmuar kundër vëllezërve të tyre shqiptar, siç do ta shohim më poshtë.

¹⁰³ Mehmet Maksudoglu, *Ottoman History Based Mainly on Ottoman Sources*, (Malaysia, 1993), f. 13.

C-Faktorët më kryesorë që kanë ndikuar në dekadencën dhe kolapsin e Perandorisë Osmane

Rëndësia e këtij nënkapitulli në punimin tonë qëndron në faktin se çështja e shqiptarëve, siç kemi thënë edhe më herët, ka qenë e lidhur ngushtë me Perandorinë Osmane. Historikisht dihet se një numër i madh i figurave të shquara shqiptare kanë mbajtur poste të sadriazemave dhe vezirëve të mëdhenj në qeverinë e Perandorisë Osmane. Prandaj forcimi i qeverisë osmane ka qenë edhe përforcim për ta, po edhe dobësia e qeverisë osmane ka qenë *de facto*, dobësim për ta, në të gjitha aspektet, qoftë ai politik, ekonomik apo shoqëror.

Ky nënkapitull, është i rëndësishëm për arsye se rezistencat dhe rebelimet e shqiptarëve, me në krye disa klerikë fetarë, kanë marrë hov të madh në këtë periudhë të dobësisë së Perandorisë Osmane para shteteve të mëdha evropiane. Gjendja, ekzistenca dhe identiteti etnik i shqiptarëve gjithmonë shkonte drejt rrezikut më të madh dhe drejt asimilimit të tyre. Shtetet fqinje, me ndihmën e shteteve të mëdha, luftonin secila për identitetin e tyre dhe për lirinë nacionale të tyre. Po ashtu, kjo periudhë ishte edhe periudhë e revolucioneve të ndryshme evropiane. Prandaj edhe vlera e këtij nënkapitulli qëndron në faktin se ai ofron mundësi për t'i kuptuar reagimet e shqiptarëve ndaj marrëveshjeve të shumta të shteteve fqinje me shtetet e mëdha, të cilat gjithmonë shkonin në dëm të shqiptarëve dhe mbi kurrizin e tyre, që t'i zhduknin gjeografikisht, politikisht, etnikisht, dhe po ashtu së fundi t'i asimilonin nga pikëpamja religjioze, si vulë përfundimtare.

Faktorët që kanë ndikuar në shembjen dhe zhdukjen e kësaj perandorie të madhe, kësaj superfuqie islamike, janë të shumtë.

Çdo studiues i historikut të Perandorisë Osmane ka nxjerrë një varg faktorësh, që sipas mendimit të tij, kanë ndikuar në mënyrë direkte apo indirekte në dekadencën dhe kolapsin e kësaj superfuqie islamike.

Këta faktorë mund të radhiten si vijon:

- 1- Disa studiues mendojnë se pjesëmarrja marginale e Perandorisë Osmane në fushën e shkencës, të industrisë dhe avancimit ushtarak, ka qenë një prej faktorëve më kryesore të dobësisë dhe zhdukjes së saj.¹⁰⁴
- 2- Nacionalizmi dhe rebelimi i popujve të ndryshëm të krishterë, të cilët filluan të ndiejnë një lloj superioriteti mbi qeveritarët muslimanë, dukuri kjo që filloi me revolucionin grek më 1821.¹⁰⁵
- 3- Ekspansioni militar, politik dhe fetar rus, apo lëvizja pansllaviste ruso-ortodokse, për t'i shpëtuar të krishterët e Ballkanit dhe ata që ishin nën sundimin e osmanlinjve.¹⁰⁶
- 4- Përhapja dhe përdorimi në përmasa të mëdha i ryshfetit dhe korrupsioni i valinjve-gubernatorëve lokalë.¹⁰⁷
- 5- Humbja e moralit islam dhe mospraktikimi i ligjeve të Allahut xh.sh. nga sulltanët e vonshëm. Dihet se vetëm 10 sulltanët e parë të Perandorisë Osmane ishin

¹⁰⁴Justin McCarthy, *Death and Exile*, f. 5-6; Hough Poullton, *Muslim Identity and the Balkan State*, f. 15.

¹⁰⁵Po aty.

¹⁰⁶Po aty, f. 13-18

¹⁰⁷J. Swire, *Albania the Rise of a Kingdom*, f.17; Elez Biberaj, *Albania a Socialist Maverick*, f. 13.

burra shteti me kuptimin e plotë të fjalës, dhe kishin gjithmonë synim xhihadin islam.¹⁰⁸

- 6- Luftërat e njëpasnjëshme dhe zgjerimi i Perandorisë Osmane në tri kontinente: Evropë, Azi, Afrikë i kushtoi shumë asaj në çdo aspekt: militar, ekonomik dhe politik. Dihet prej historikut të saj pesëshekullor se vetëm 28 vite nuk ka pasur luftëra.¹⁰⁹
- 7- Pjesëmarrja e grave të sulltanëve në qeveri (parlament) dhe ky faktor sipas disave ka qenë më i rrezikshmi që ka ndikuar në shkatërrimin e Perandorisë, për arsye se ato tentonin ta siguronin fronin e sulltanit për fëmijët e tyre, pa marrë parasysh se a e meritonin atë apo jo.¹¹⁰
- 8- Imitimi i çoroditur i stilit të jetës perëndimore nga disa sulltanë në jetën e tyre të përditshme, në ndërtimin e pallateve etj., gjë që e zhyti Perandorinë Osmane në borxhe të rënda. Kështu Perandoria u detyrua të shpallte falimentimin ekonomik gjatë sundimit të sulltan Abdylmexhidit.¹¹¹
- 9- Po ashtu, edhe vdekja e sulltan Sulejman Kanunit (të Madhërishëm), më 1566, është konsideruar nga disa studiues si fillimi i rënies së Perandorisë Osmane.¹¹²
- 10- Neglizhenca e xhihadit dhe angazhimi i sulltanëve me aktivitete të tjera personale dëfryese, si: me gjueti, kaligrafi, pikturë, poezi, kalorësi etj., po ashtu

¹⁰⁸Mehmet Maksudoglu, *Ottoman History based mainly on Ottoman sources*, f. 340-346.

¹⁰⁹Hysamedin Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, f. 68-77.

¹¹⁰Po aty, f. 341-342.

¹¹¹Po aty.

¹¹²Georges Castellan, *Histori e Ballkanit, shek. XIV-XX*, f. 176.

parazitizmi në administratë, parazitizmi në rrethin dhe korpusin e ulemave islamë etj.¹¹³

11- Për mendimin tim edhe reformat administrative (Tanzimati), për të cilat do të flasim gjerësisht më poshtë, ku Perandoria Osmane filloi ta imitojë Perëndimin dhe stilin evropian, ka qenë një ndër shkaqet kryesore të shembjes së saj. Me këto reforma filloi edhe keqësimi i marrëdhënieve në mes shqiptarëve dhe Portës së Lartë.¹¹⁴

12- Poashtu edhe aspiratat e mëdha të Perandorisë Osmane për ekspansionin e saj politik, gjeografik, ekonomik dhe fetar, kanë qenë prej faktorëve kryesorë që ajo ta humbasë kontrollin e saj mbi të tjerët. Është dashur që ajo të pushojë pak, t'i studiojë gjerë e gjatë rrethanat politike, shoqërore dhe gjeografike të atyre shteteve apo viseve, e pastaj t'ia mësynte për çlirimin e atyre vendeve për ta pëhapur mesazhin Kur'anor dhe atë profetik, por mjerisht dhe për fat të keq kjo si po shihet nuk ndodhi. Dhashtë Allahu Fuqiplotë që Perandoria Islame në krye me liderë të denjë dhe të sinqertë (pa marë parasysh se kush do ta ket fatin) të riaktivizohet sërisht për ta shpëtuar njerëzinë nga këto mjerimet dhe vuajtjet politike, ekonomike, sociale dhe edukativo-arsimore.

Këta ishin disa nga faktorët më kryesorë që kemi hasur gjatë studimit dhe analizës sonë. Pa dyshim, ekzistojnë edhe faktorë të tjerë, mirëpo natyra këtij studimi nuk lejon që të thellohemi më shumë.

¹¹³Po aty, f. 217-218; Po ashtu shih: Nexhip P.Alpan-Nesim Kaci, *Shqiptarët në Perandorinë Osmane*, f. 22-23.

¹¹⁴H. Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, f. 68-77.

KREU I KATERT

KRONOLOGJI E SHKURTËR HISTORIKE KU VËREHET NATYRA REZISTUESE E SHQIPTARIT, E NXITUR KRYESISHT PREJ SHTETEVE SLLAVE DHE KATOLIKE NDAJ PUSHTUESEVE TË HUAJ DHE NDAJ (OSMANLINJVE)

Historia e shqiptarëve klasike ka qenë një histori e mbushur plot me okupime të perandorive të ndryshme, ata janë detyruar të rezistojnë me të gjitha mjetet që kanë pasur në disponim për të drejtën e tyre, për të jetuar të lirë. Është me rëndësi të dimë se historia na njofton se këto rezistenca kryesisht kanë qenë të nxitura nga shtetet sllave, katolike apo nga kleri fetar dhe se ato kanë pasur edhe karakter fetar. Ky faktor, që është injoruar qëllimisht prej historianëve, na jep të kuptojnë se në historikun e shqiptarëve është zhvilluar një luftë e rreptë fetare. Kjo rezistencë e trashëgueshme e shqiptarit e ka bërë atë që të mos bëjë dallimin ndërmjet pushtuesve dhe çliruesve, kështu që edhe Perandorinë Osmane, shumë prej tyre, e kanë konsideruar dhe ende disa e konsiderojnë si pushtuese dhe okupuese, duke mos vërejtur asnjë të mirë të saj!

Siç u pa edhe prej trajtave të emrit shqiptar dhe origjinës së tyre ilire që në fillim të këtij punimi, ky popull, siç dihet historikisht, ka luftuar që të jetë i lirë, edhe nëse është detyruar të jetojë nëpër male e shkëmbinj dhe ka dëshiruar të vdesë i lirë. Mirëpo fati i tyre historikisht ka qenë i zi. Ata gjithmonë kanë qenë nën sundim e të tjerëve dhe kanë pësuar mbi shpinën e tyre deportime masive, spastrime etnike, tentativa asimiluese etj, për shfarosjen e tyre. Mu për këtë shqiptari gjithmonë e ka urryer sundimin dhe mbizotërimin e tjetërkujt në çfarëdo

mënyre. Kjo e ka detyruar që të jetë gjithmonë me pushkë¹¹⁵ në dorë për t'u ruajtur nga armiq të huaj. Për këtë ideal ka dhënë edhe jetën dhe pasurinë e tij dhe ka qenë krenar.

Besoj bindshëm se synimi për ta realizuar një ideal të tillë është e drejtë natyrore e çdo populli, në çdo vend e në çdo kohë, dhe kjo përputhet edhe me fjalët e kalifit të tretë Islam Omerit r.a.(*Allahu qoftë i kënaqur me të*) i cili ka thënë: *'Kur i është dhënë e drejta dikujt për ta robëruar dikë tjetër, kur dihet fare mirë se nënat e tyre i kanë lindur ata të lirë !'*

Prandaj, nëse e kemi të qartë këtë realitet, këtë premisë të psikologjisë së një populli, atëherë është e lehtë ta analizojmë natyrën rezistuese të tij, për çdokënd, pa dallim gjuhe, kombi apo ideali, për të mirën apo për të keqen e tij, si ka qenë p.sh. rasti me ardhjen e Perandorisë Osmane në këto troje, me një ideal dhe fe të re, e cila i ka shpëtuar totalisht dhe në mënyrë imediate prej asimilimit sllavo-ortodoks, serbo-grek.

Pa dyshim, për mendimin tim, ka qenë dhe është një dobësi intelektuale e shqiptarëve, gjatë shekujve deri në ditët tona, për të mos e bërë dallimin e të mirës ndaj të keqes, ndërmjet armikut pushtues e gjakpirës dhe superfuqisë çlirimtare dhe shpëtuese prej grabitqarëve sllavë, ortodoksë dhe grekë, të cilët bënë çmos për ta zhdukur popullin shqiptar nga ekzistenca e kësaj jete, njëherë e përgjithmonë. Pa dyshim rezistenca e tyre ndaj këtyre sundimtarëve me fe të re ka treguar nivelin më të ulët intelektual të një populli. Mirëpo krahas kësaj, unë besoj bindshëm se pas kësaj rezistence, sidomos ndaj osmanlinjve, pas kësaj urrejtjeje të pakufishme dhe ekstreme kanë qëndruar duart e zeza të sllavëve ortodoksë dhe katolikëve fanatikë, siç

¹¹⁵ Shih Mehdi Frasheri, *Historia e Lashtë e Shqipërisë dhe e Shqiptarëve*, f. 16.

do ta shohim më vonë. Historikisht, këta kanë qenë faktori më kryesor në mbjelljen e armiqësisë dhe urrejtjes në zemrat e këtyre shqiptarëve të gjorë ndaj osmanlinjve, muslimanëve.¹¹⁶

Për mendimin tim, ashtu si kam thënë edhe më herët, faktori fetar, i fshehtë, i injoruar dhe i marginalizuar prej historianëve shqiptarë ateistë, joobjektivë dhe të njëanshëm qëllimisht, ka qenë gjeneratori më kryesor për nxitjen dhe ndezjen e luftërave dhe kryengritjeve shekullore të shqiptarëve ndaj osmanlinjve.

Unë nuk po i mbroj osmanlinjtë tërësisht dhe nga çdo aspekt. Pa dyshim se perandoria e madhe, qindra vejeçare duke pasur nën sundimin dhe kontrollin e saj miliona njerëz multietnikë, multireligjiozë, duhet të ketë pasur marrëdhënie dhe sjellje anti-islame e ndoshta jo njerëzore të ndonjë valiu - guvernatori apo mytesarifi të saj me shqiptarët apo me të tjerët, Por kjo assesi nuk do të thotë që i tërë sistemi politik-ekonomik e fetar e perandorisë ka qenë i tillë. Kjo nuk është e drejtë dhe e saktë as historikisht, as juridikisht. Prandaj të krahasosh civilizimin, tolerancën fetare, frenimin e procesit të ortodoksizmit¹¹⁷ të dhunshëm, frenimin e procesit asimilues nga sllavizmi dhe greqizmi, pranimin e të drejtës dhe zakoneve si rregullatorë juridikë të shumicës së sferave të jetës shoqërore shqiptare, përmbajtjen e administratës, ushtarake e civile pothuajse tërësisht shqiptare...¹¹⁸ përmirësimin e statusit të shtresave të

¹¹⁶Për krimet dhe manipulimet e kishës dhe të klerit me pronat e popullit, shih: *'Historia e Shqipërisë'* (Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë, 1959) vëll. 1, f. 158; po ashtu shih *'Shqipëria e popullit shqiptar'* vëll. 1, f. 157, 175.

¹¹⁷Më gjerësisht, Hysamedin Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, f. 62.

¹¹⁸Për aktivitetin e dioqezave ortodokse greke në trevat shqiptare që nga 1478 e deri në pavarësinë e Shqipërisë më 1912; Shih edhe *Shqipëria dhe Sh.B.A në Arkivat e Washingtonit*, Haris Saljxhiq, sht. bot. Dituria, 1999

ulëta...etj¹¹⁹, pra t'i krahasosh këto të mira me sundimin shkatërrues e asimilues të romakëve dhe të bizantinëve është marrëzi dhe papjekuri e strukturës intelektuale shqiptare, që nga koha e komunizmit e deri në ditët tona kur po shënohen këto rreshta. Të gjithë ata historianë që kanë vdekur dhe që janë ende gjallë duhen gjykuar në gjykatën supreme islame, e cila nuk njeh diskriminim, nuk merr ryshfet dhe i gjykon drejt të gjithë, pa dallim feje, race a kombi, për këtë histori të shtrembëruar dhe të gabuar, ferrat dhe gjembat e të cilëve ne jemi duke i vjelë tani. Atë që kanë mbjellë ata, po e korrim ne tani. Ata kanë mbjellë urrejtje dhe armiqësi në mesin tonë duke i falsifikuar faktet historike nëpër tekste shkollore dhe atë univerzitare.

Historiani Mehdi Frashëri thotë: *“...prej dy mijë e disa qindra vjet, Shqipëria, me një ndërmjetësi kohore prej katër ose pesëqind vjetësh, ka pësuar katër invazione: 1) invazioni i parë erdhi nga perëndimi me pushtimin roman, 2) invazioni i dytë erdhi nga veriu mbas prishjes së perandorisë romane dhe dobësisë së perandorisë bizantine prej popujve barbarë, si gotët, hunët dhe pastaj sllavët (serbë ose bullgarë), 3) invazioni i tretë erdhi prej orientit me pushtimin turk, i cili si qytetërim ishte turan-semitik për shkak të islamizmës, 4) invazioni i Ballkanit nga tri anët: veri, lindje dhe jug. Ndikimi i Greqisë në Shqipëri, që nga kohërat e vjetra, ka qenë vetëm me kulturë dhe me fe, që nga koha e ortodoksisë e këndej. Invazioni i romakëve nuk ka qenë shfarosës, përkundrazi ka sjellë një qetësi relative dhe një qytetërim (relativ, H. Hoxha). Invazioni turk, në periudhën e parë, ka qenë rrënues, por në periudhën e transformimit të fesë ka qenë përkrahës i racës shqiptare në atë shkallë sa që shqiptarët filluan të rifitonin edhe vendet që*

ribotim, f. 30...përkthyer nga Xhelal Fejza: titulli i origjinalit në boshnjakisht: *Albania i S.A.D. Kroz Arhive Washingtona*

¹¹⁹ Po aty, f. 62.

*kishin humbur për shkak të shfarosjes së popullsisë shqiptare prej sllavëve. Shqiptarët që ranë në duart e Jugosllavisë rrezikonin ekzistencën e tyre...*¹²⁰

Historia na flet se gjatë shekullit të tetë, si rezultat i dyndjeve të sllavëve në tokat shqiptare dhe masakrat sllave për t'i konvertuar shqiptarët me dhunë në ortodoksizëm¹²¹, pastaj si rezultat i shtrirjes së bullgarëve në tokat e Maqedonisë dhe të Fushë Kosovës gjatë viteve 637-847, që për disa krahina zgjati 150 vjet, shqiptarët u detyruan që t'i bëjnë ballë dhe qëndresë kësaj fushate religjioze shfaruese sllave, gjë që dëshmon për rezistencën dhe urrejtjen e tyre ndaj të huajve...¹²²

Pas shembjes së shtetit bullgar, mbi shqiptarët u rivendos përsëri sundimi bizantin. Shqiptarët u çuan përsëri në kryengritje për shkak të keqësimit së tyre ekonomik, më 1040-1041. Po ashtu, edhe ky rast na jep të kuptojmë natyrën e tyre rrezikuese.¹²³

Më vonë, gjatë ekspansionit serb në tokat shqiptare, që për mendimin tim kishte karakter fetar kishtar, asimilues në radhë të parë e pastaj politik për dikë tjetër,¹²⁴ shqiptarët përsëri rezistuan.

Natyra e rezistuese e shqiptarit gjatë historisë vërehet edhe gjatë kryqëzatave të para, më 1096 dhe me ardhjen e normanëve në Itali si mercenarë. Më pas këta normanë, me në

¹²⁰ Mehdi Frasheri, *Historia e lashtë e Shqipërisë dhe e shqiptarëve*, (Tiranë, bot. i dytë, Phoenix, 2000), f. 240-241

¹²¹ Më gjerësisht shih: Sami Frashëri, *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet*, (Prishtinë, shtëpia botuese, Dijsa, Bot. i dytë, 2001), f. 26-27.

¹²² Më gjerësisht shih: Petrika Thëngjilli, *Historia e Popullit Shqiptar*, (Tiranë, botime Toena, 2000), f. 77-79; J. Swire, *Albania The Rise of the kingdom*, f. 11; Elez Biberaj, *Albania a Socialist Maverick*, f. 11; Gjergj Gashi, *Arbëria dhe Vatikani*, f. 9.

¹²³ P. Thëngjilli, *Historia e popullit Shqiptar*, 80

¹²⁴ Shih John.V.A. Fine, JR. *The Late Medieval Balkans*, f. 7-8; Petrika Thëngjilli, *Historia e Popullit Shqiptar*, f. 83.

krye Bulmundin, mbasi ky mori bekimin nga Papa, i pushtuan qytetet e Shqipërisë, më 1107 dhe e plaçkitën dhe e dogjën atë. Shqiptarët përsëri u ngritën në kryengritje sepse nuk ishin të kënaqur me detyrimet e tyre ndaj të huajve.¹²⁵

Si pasojë e kryqëzatës së katërt ishte edhe pushtimi i Kostandinopojës nga despoti bizantin, më 1204-1219, me në krye Mihailin I dhe Teodorin I, më 1219-1230. Në vitin 1261 disa treva shqiptare ndodheshin nën sundimin bizantin të Serbisë, kurse disa krahina ndodheshin ende nën sundimin bizantin. Këtu shqiptarët bënë rezistencë të madhe ndaj bizantinëve.¹²⁶

Edhe anzhuinët, që erdhën më 1266 nga Franca, të mbështetur, të përkrahur e të ftuar nga papa, bënë masakra mbi popullatën shqiptare, grabitën pasuritë e tyre, i ngarkuan shqiptarët me taksa të rënda, aq sa që prej gjendjes së keqe ekonomike populli shqiptar filloi të shitet si skllavër për borxhet që kishin fisnikët shqiptarë të përjashtuar nga administrata etj. Si rrjedhojë e kësaj gjendje, shqiptarët u çuan përsëri në kryengritje dhe i sulmuan anzhuinët¹²⁷ më 1277.

Më vonë, më 1296, ata përsëri u detyruan të bëjnë rezistencë kundër mbretit serb, Uroshit II Milutini.¹²⁸ Në vitin 1335, kryengritjet e malësorëve të Shqipërisë së mesme kundër perandorit bizantin, Andraniku III Paleologu, për shkak të taksave të rënda, arritën kulmin. Për t'i shuar këto kryengritje, ky perandor dërgoi ekspedita speciale turke dhe të stërvitura nëpër male, të cilët bënë përsëri kërdi. Shumë gra e fëmijë u

¹²⁵ Shih: *Historia e popullit të Shqipërisë* (Universiteti Shtetëror i Tiranës ,1959), vëll. 1, f. 178

¹²⁶ Më gjerësisht John V.A. Fine. JR. *The Late Medieval Balkans*, f. 60

¹²⁷ P. Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar*, f. 89.

¹²⁸ Po aty, f. 90-91.

dërguan për t'u shitur si skllevër. Një pjesë tjetër u detyruan të emigrojnë në mënyrë masive në Itali, Greqi etj.,¹²⁹ për t'i ikur masakrave dhe gjenocidit bizantin. Kjo rezistencë shqiptare tani hyri në një fazë më të rëndë. Shqiptarët i bënë ballë edhe pushtimit serb të tokave shqiptare, me në krye Car Stefan Dushanin 1331-1355. Ky sundues zullumqar serb, i motivuar nga priftërinjtë ortodoksë serbë, i motivuar nga synime kishtare të shenjta, bëri masakra, ushtroi gjenocid, etnocid, kulturocid mbi shqiptarët, sipas kodit civil që e kishte shpikur vetë. Ky kod parashihte dënimin me vdekje, damkosjen me hekur të skuqur në fytyrë dhe konfiskimin e pasurisë dhe të pronave të të gjithëve atyre latinëve apo katolikëve shqiptarë të cilët nuk konvertoheshin në ortodoksizëm...¹³⁰

Mbas dëbimit të bizantinëve, anzhuinëve dhe, së fundi, të serbëve më 1355, shqiptarët përsëri ishin të shqetësuar. Natyra rezistuese e tyre tani u paraqit me krijimin dhe paraqitjen e principatave si klasë sunduese, nga familjet bujare shqiptare...¹³¹ Këtu mund të përmendim formimin e disa principatave të mëdha, si ajo e Karl Topias në Durrës, e Gjergj Balshajt në Veri të Shqipërisë etj.¹³²

Siç kemi thënë më herët, grindjet dhe luftërat e këtyre principatave mes vete, ishin shkaqe për ardhjen e osmanlinjve

¹²⁹Po aty, f. 91.

¹³⁰Më gjerësisht shih: J. Swire, *Albania The Rise of a Kingdom*, f. 12, P. Thëngjilli, *Historia e Popullit Shqiptar*, 93; John.V.A. Fine, JR, *The Late Medieval Balkans*, 314-317; Mehdi Frashëri, *Historia e Lashtë e Shqiptarëve dhe e Shqipërisë*, f. 34; Muhamed Pirraku, *Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*, f. 43 e tutje

¹³¹Më gjerësisht: *Historia e popullit shqiptar*, vëll. 1, f. 204; Sami Frashëri, *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet*, f. 29-30.

¹³²Më gjerësisht shih: Petrika Thëngjilli. *Historia e popullit shqiptar*, f. 107-108.

në trojet shqiptare, pasi këta kërkuan ndihmën e turqve kundër palës tjetër...¹³³

Po ashtu, shqiptarët, që për nga natyra e tyre ishin rezistues, të nxitur edhe nga të tjerët, katolikë dhe ortodoksë, bënë koalicion¹³⁴ me princërit serbë, bullgarë, rumunë etj., dhe kjo faktikisht ishte luftë e kryqëzatave të shteteve të Evropës Lindore kundër Perandorisë Osmane Islame. Kështu, më 15 qershor të vitit 1389¹³⁵ u zhvillua beteja e madhe e Kosovës, në të cilën osmanlinjtë fituan kundër kryqtarëve. Sulltan Murati I ra shehid në këtë betejë nga duart e një shqiptari ortodoks të krishterë.¹³⁶ Thuhet se ky katil ka qenë serb.

Pas betejës së përgjakshme të koalicionit të krishterë katoliko-ortodoks dhe humbjes së tyre, luftërat, kryengritjet dhe rezistencat shqiptare nuk patën të ndalur.

Motivet fetare nxitëse të të krishterëve, katolikë dhe ortodoksë, historikisht nuk kanë pushuar gjatë tërë historisë njerëzore, po edhe asaj shqiptare. Edhe tani nuk janë ndalur dhe nuk kanë për të pushuar as në të ardhmen.

Historia na flet se Papa, si aleat i Hungarisë, i nxiti shqiptarët për një kryengritje (rebelim) të përgjithshëm kundër osmanlinjve, mirëpo tani me veglën dhe instrumentin e

¹³³ Historia e popullit shqiptar. vëll. 1, f. 208-209; Gjergj Gashi, *Vatikani dhe Arbëria*, f. 9; *Historia e popullit shqiptar*, (Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, ribotim, 2000, e hartuar nga grup historianësh), vëll. 4, f. 29-48.

¹³⁴ Në gjuhën e disa studiuesve të njohur bashkëkohorë, ky koalicion dhe bashkëpunim me grekun, serbin etj...ka qenë traditë e gjatë e bashkëpunimit ... me traditë shqiptare, sidomos e atyre të Jugut ... Shih: *Hysamedin Feraj, Skicë e mendimit politik shqiptar*, f. 39-78.

¹³⁵ Për këtë shih edhe punimin tim me titull: *Mitet serbe dhe justifikimi i masakrave dhe gjenocidit ndaj të tjerëve*.

¹³⁶ *Historia e popullit shqiptar*, vëll. 1, f. 222; dhe po ashtu, shih Petrika Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar*, f. 120; *Historia e popullit shqiptar*, vëll. 4, f. 54.

krishterimit dhe të të krishterëve. Ai ishte trimi, patrioti dhe atdhetari që u rrit, u edukua dhe u zhvillua në pallatin mbretëror të sulltanit. Ai ishte musliman dhe njihej me emrin: Skënderbeu.¹³⁷ Mirëpo ky trim, më vonë, u paraqit si tradhtar ndaj sulltanit në një ekspeditë ushtarake dhe e ndërroi fenë islame me atë të krishterë, d.m.th. kaloi në krishterizëm publikisht dhe u shndërrua në një prej kundërshtarëve më të mëdhenj të fesë islame dhe të muslimanëve, plot 25 vite luftë dhe rezistencë kundër osmanlinjve...Krim, vepër penale, tradhti ndaj sulltanit dhe krim ndaj Zotit xh.sh.

Burimet historike, siç kemi theksuar në disa vende të këtij studimi, na flasin edhe për shkakun e kësaj natyre rezistuese të shqiptarëve ndaj të huajve, sidomos ndaj osmanlinjve. Përveç faktit se shqiptarët nuk i kanë dashur të huajt, kjo dukuri ka qenë e nxitur dhe e shtyrë edhe nga motivet fetare të krishtera¹³⁸ (katoliko-ortodoks).¹³⁹

Këto nxitje u kanë kushtuar shumë shqiptarëve në çdo fushë dhe në çdo aspekt, në atë ekonomik, ushtarak, politik dhe ideal.

¹³⁷ Për tradhtinë dhe për konvertimin e tij publikisht në krishterizëm dhe për të qenët e tij si mbrojtës i Evropës së krishterë flasin edhe këto baza historiografike shqiptare. Më gjerësisht shih: Stavro Skëndi, *Zgjimi kombëtar shqiptar*, f. 17; *Historia e popullit shqiptar*, vëll. 4, f. 60, 66, 77; *Albania The Rise of a Kingdom*, J. Swire, f. 14; *Historia e popullit shqiptar*, vëll. 1, f. 271; Petrika Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar*, f. 183.

¹³⁸ Ata kërkonin ndihmë materiale dhe shpirtërore prej Papatit dhe merrnin projektet e luftimeve prej tij... Në krye të këtyre kryengritjeve ka qenë kleri fetar i krishterë, peshkopët ortodoksë dhe priftërinjtë katolikë... Më gjerësisht, P. Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar*, f. 184; *Historia e popullit shqiptar*, 4, f. 86-87. Por edhe në disa raste të tjera, e sidomos kur u formua Lidhja Shqiptare e Prizrenit, më 1877, si revolucion i gjithëmbarshtëm shqiptar anti-osman, si do ta shohim më vonë, në krye të kësaj kryengritjeje ka qenë edhe kleri fetar musliman. Shih më gjerësisht: Skënder Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit, 1877-1885*, Prizren- Krushë e Madhe – sht. Bot. Drita, 1998), f. 19- 292

¹³⁹ *Historia e popullit shqiptar* (grup autorësh), vëll. 4, f. 86.

Sa i përket fushës ekonomike, shqiptarët pothuajse nuk kanë mundur të bëjnë asgjë të mirë. Në aspektin ushtarak, humbjet në njerëz kanë qenë të panumërta, ndërsa në aspektin politik nuk kanë mundur të ndryshojnë asgjë, me ca përjashtime të vogla. Perandoria osmane ka vazhduar përsëri politikën ekspansioniste multietnike, multireligjioze. Së fundi, në aspektin ideal, shqiptarët nuk u realizuan kurrë tërësisht, me përjashtim të asaj që u realizua në fillim të shekullit të 20-të, kur më 1912 u shpall pavarësia e Shqipërisë.

Një dukuri që vërehet prej kryengritjeve dhe rezistencave shqiptare është se ata gjithmonë kanë humbur dhe kanë dështuar, pa i realizuar synimet e tyre, gjë që tregon edhe papjekurinë e tyre mentalisht, për fat të keq, sepse kanë qenë vegla të tjetërkujt!¹⁴⁰

Më vonë, në vitin 1757, me paraqitjen e pashallëqeve në Shqipëri, Porta e Lartë e njohu Mehmet Bushatin për qeveritar të Sanxhakut të Shkodrës. Më 1771 Porta e Lartë i dha atij gradën e vezirit. Pas vdekjes së të atit, në pushtet erdhi i biri. Me bindjen dhe me krenarinë se ishte pasardhës i Skënderbeut, ai i premtoi popullit që do t'i lironte nga taksat për 20 vite. Historia na flet që edhe kjo rezistencë e tij ndaj qeverise osmane që e nxitur nga faktorët e jashtëm me motive fetare.¹⁴¹

¹⁴⁰ P. Thëngjilli, Historia e popullit shqiptar, f. 269.

¹⁴¹ Edhe studiuesi Dr. Husamedin Feraj, në lidhje me temën në fjalë, për qëndresën dhe rezistencën anti-osmane të shqiptarëve thotë: “...Arritjet e derisotme historiografike kanë pranuar se trazirat anti-osmane ishin lokale, kryesisht të motivuara fetarisht dhe ose janë nxitur nga shtetet e vogla evropiane e ballkanike, ose kanë pasur kryesisht karakter ekonomik, si kundërshtim i rritjes së taksave apo mospajtimit të tyre... Ndërsa tendencat separatiste u paraqitën vetëm nga fundi i shekullit të 18-të dhe fillimi i shekullit të 19-të...”. Nuk pajtohem me profesor Ferajn, kur thotë se këto rezistenca dhe tradita të shqiptarëve, si për nga sasia dhe cilësia, nuk ishin përfaqësuese për tërë popullin shqiptar, se kishin një shtrirje gjeografike shumë të vogël dhe ishin lokale, se përfshinin pjesën më të pakët të popullit dhe të territoreve më të prapambetura...etj, për arsye se në vendet ku paraqitej rezistenca gjendeshin masa më të mëdha të popullit, ndërsa

Ai kërkoi ndihmë prej Rusisë për shqiptarët ortodoksë dhe prej Austrisë për shqiptarët katolikë kundër Sulltanit. Mirëpo, së fundi, edhe ky Kara Muhamed Pasha u rrëzua, mbasi që zhvilloi dy luftëra me osmanlinjtë, por përsëri pa sukses dhe me dështime.¹⁴²

Kjo rrymë rezistuese dhe këto shenja dhe prirje të pavarësisë u paraqitën edhe në familjet e njohura dhe bujare në Kosovë, në Prizren në familjen e Rotullajve, në Pejë në familjen e Begollajve etj.¹⁴³

Me rënien e pashallëkut të Shkodrës dhe ngritjen e pashallëkut të Janinës, me në krye Ali Pashë Tepelenën, më 1784, përsëri doli në skenë natyra rezistuese e shqiptarit e dirigjuar nga të tjerët, me synimin e bashkimit të tokave shqiptare nën një pashallëk.¹⁴⁴ Normal se ky plan nuk mund të realizohej vetë. Atëherë ai çka bëri? Iu drejtua grekut të krishterë ortodoks kundër Perandorisë Osmane, që edhe në fakt ishte nën Perandorinë Islame.

Ajo çka është me rëndësi të vihet këtu në pah është se këto rebelime, kryengritje, rezistenca të pashallëqeve shqiptare, nga fundi i shek. të XVIII-të, fillojnë të mbrohen dhe të arsyetohen me arsyetime fetare, me qëllimin e justifikimit të sjelljeve të tyre. Ali Pasha dallohej për aftësinë, energjinë, dinakërinë dhe

vendeve të tjera nuk u interesonte fort se çka po ndodhte në këtë rajon. Prandaj ajo rezistencë, në një aspekt ishte lokale, por përfaqësuese për të tërë shqiptarët, sepse të tjerët nuk kundërshtonin... *Shih Husamedin Feraj, Skicë e mendimit politik, f. 46-49*

¹⁴² Më gjerësisht, *Historia e popullit shqiptar*, 4, 90; Petrika Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar*, f. 270-278; *Historia e popullit shqiptar*, 1—398-410. Po ashtu, më detajisht shih disertacionin e doktoratës të Bedrush Shehut, *Çështja shqiptare në vitet 30, të shekullit 19* (Instituti Albanologjik I Prishtinës, Prishtinë 1990), f.111-163.

¹⁴³ Abib Ahmeti, *Theranda-Prizreni ndër Shekuj*, (Prizren, Orient, 1996), f. 118; *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. 4, f. 93.

¹⁴⁴ P. Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar*, f. 286.

dhunën e tij. Kjo vërehet më së miri në një fjalim të tijin, kur ai i nxiste ushtarët e tij për luftë kundër një fisi tjetër shqiptar në Shqipëri. Në mes të tjerash, ai ka thënë:

*”...Le t’ia nisim prandaj t’i ç’rrënjoshim të pafetë nga mesi, farën e keqe të suljotëve, dhe le t’i presim me vendosmëri të pafetë... Kështu, o vëllezër të mi, ju që jeni muslimanë të vendosur, bashkohuni me mua dhe të betohemi në emër të Allahut e të Profetit të Tij, që ose ta shtiem në dorë Sulin ose të vdesim...”*¹⁴⁵

Po ashtu kjo dinakëri e shtyri atë që, më 1820, t’i ftojë të gjithë priftërinjtë dhe hoxhallarët, shqiptarët dhe grekët, dhe pasi që u foli për të mirat ekonomike, arsimore dhe kulturore që janë arritur gjatë periudhës së tij, ai kërkoi nga ata përkrahje për fushatën e tij dhe mobilizimin e tyre në luftë kundër Sulltanit.¹⁴⁶

Si zakonisht, edhe ky pasha, me këtë rebelim kundër perandorisë osmane, nuk pati sukses ashtu si shokët e tij. Së fundi, ai dështoi dhe u vra nga ushtria turke e sulltanit dhe koka e tij u ekspozua në Stamboll.¹⁴⁷

Besoj bindshëm se këto raste historike të lartëpërmedura na mjaftojnë për të dëshmuar korrektësinë e teorisë sonë; se historia shqiptare ka shumë kapituj të haruar qëllimisht për ta injoruar faktorin fetar qoftë ai Krishter apo Islam, gjë që nuk pranohet dhe refuzohet kjo historik e shkruar dhe e helmuar për qështje objektive dhe metodologjike.

¹⁴⁵ *Historia e popullit shqiptar*, vëll. 4, f. 95.

¹⁴⁶ *Historia e popullit shqiptar*, vëll. 1, f. 442, për më gjerësisht shih: Bedrush Shehu, *Çështja shqiptare në vitet 30 të shek. XIX*, f. 61-128

¹⁴⁷ *Historia e popullit shqiptar*, vëll. 4, f. 93-98; Petrika Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar*, f. 281-288; *Historia e popullit shqiptar*, vëll. 1, f. 425-435.

KREU I PESTE

Tanzimati dhe pasojat negative të tij mbi popullin shqiptar dhe Perandorinë Osmane

1-Përse Tanziamti?

Perandoria Osmane, sipas studiuesit Tajar Zavalanit, për të shpëtuar nga shkatërrimi i plotë: “...u mundua të zbatonte në Shqipëri reformat e Tanzimatit me anë të forcës së verbët, pa marrë parasysh strukturën gjeografike të vendit, ndarjen e popullit në vise dhe tradita lokale. Reforma që shkaktoi rezistencën më të fortë në Shqipëri ishte shërbimi ushtarak i detyrueshëm i shoqëruar nga taksat e rënda për të mbajtur në këmbë ushtrinë e re...”¹⁴⁸

Kjo ide kishte lindur nga osmanlinjtë e arsimuar dhe të edukuar në frymën e Perëndimit, për arsye se ata nuk ishin të kënaqur me gjendjen e Perandorisë. Ata ishin të mendimit se po që se Perandoria do të administrohej me kushtetutë punët do të shkonin më mirë. Kështu, këta të arsimuar filluan përpilimin e kushtetutës në parlamentin e deputetëve, ku do të merrnin pjesë edhe deputetë të krishterë.¹⁴⁹

Kështu pra, si po shihet më lart, këto reforma kishin për qëllim daljen nga kriza që kishte filluar të përjetonte Perandoria Osmane. Si të dilej nga kriza? Nëse pyeten ata që janë infektuar me mendimet e Perëndimit, përgjigjja është lehtë dhe definitive. Ata kishin për t’u përgjigjur se rruga e vetme e shpëtimit është që ta imitonin Perëndimin në çdo aspekt dhe në çdo fushë. Dhe kështu u bë. Mirëpo, si do ta shohim më poshtë,

¹⁴⁸Tajar Zavalani, *Histori e Shqipnis*, (Tiranë, Phoenix, Fondacioni Soros, Mendimi Shqiptar), f. 170.

¹⁴⁹Më gjerësisht shih: S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 51; Georges Castellan, *Histori e Ballkanit*, 219; Mehmet Maksudoglu, *Ottoman History based mainly on Ottoman sources*, f. 328-329.

ndodhi e kundërta. Në vend se Perandoria të dilte nga kriza, ajo shkoi drejt një krize dhe humnere më të madhe përfundimtare. Shkuarje pa kthim mjerisht. Vetëm nëse do Allahu xh.sh. të dalë ndonjë perandori tjetër islam, atëherë muslimanëve në tërë globin tokësor do t'u rikthehet nderi, forca, vlera dhe pushteti. Këtë ne nuk dimë. Ajo është në diturinë e Allahut xh.sh, por kjo nuk do të thotë që ne të rimë duarkryq dhe të mos angazhohemi për rikthimin e Perandorisë Islame në mënyrë paqësore, me sjellje të mira, me punë dhe angazhim intensiv, me reforma pozitive radikale në mendimet, veprat, dhe mardhënjet tona sociale, politike dhe ekonomike. Poashtu mos të harrojmë reformat pozitive në aspektin shkollor, univerzitar, fetar të medreseve dhe fakulteteve fetare.

2-Natyra e Tanzimatit

Sipas studiuesit Dr. Ismail Bardhi: “...Kuptimi i reformës në Perandorinë Osmane më tepër ka ngjyra të reformave politike se sa të modernizimit religjioz, të cilat kanë filluar qysh më herët brenda saj, saqë aso kohe vërehet një shprehje shumë e rëndësishme, **din ve devle**, e cila është shpjeguar në mënyra të ndryshme...”¹⁵⁰

Ky pohim nuk mund të pranohet tërësisht, sepse siç kemi thënë më lart, në Perandorinë Osmane janë bërë edhe reforma ekonomike, sociale, militare dhe administrative. Kjo që thamë shihet edhe prej fjalëve të studiuesit H. Feraj se:

*“Thelbi i këtyre reformave qëndronte nga pikëpamja politike në centralizimin e pushtetit dhe nga pikëpamja ekonomike në industrializimin e Perandorisë...”*¹⁵¹

¹⁵⁰ Ismail Bardhi, *Hafiz Ibrahim Dalliu dhe ekzegjeza e tij kur'anore*, (Logos-A, Shkup, 1998), fusnota 169, f. 92.

¹⁵¹ H. Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, f. 68; S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 95; *Muslim Identity and the Balkan State*, f. 15.

Mund të shtojmë edhe këtë realitet tjetër: thelbi i këtyre reformave qëndronte nga pikëpamja politiko-sociale në evropianizimin e Perandorisë Osmane dhe komunitetit musliman gradualisht, dhe kjo ndodhi për fat të keq, me ardhjen e Ataturkit dhe sistemit laik sekular të Turqisë. Sa i përket reformave religjioze, në këtë moment, nuk mund të flasim për shkak të natyrës së punimit që kemi për objekt studimi.

3- Pasojat e Tanzimatit për shqiptarët dhe prishja e marrëdhënieve shqiptare me Perandorinë Osmane

Sipas studiuesit H. Feraj, prishja e marrëdhënieve shqiptare daton që nga proklamimi i Tanzimatit më 1839. Marrëdhëniet shqiptaro-osmane, nga aspekti i përgjithshëm, ishin të mira, edhe përkundër kryengritjeve dhe rezistencave të disa grupacioneve të vogla. Ato filluan të prishen nga fundi i shek. të XVIII-të dhe fillimi i shek. të XIX-të. Në këtë periudhë, Perandoria planifikonte centralizimin e pushtetit, ndërsa shtresa drejtuese e shqiptarëve synonte dhe planifikonte decentralizimin dhe autonominë e saj.¹⁵²

Historianët potencojnë se ato reforma-Tanzimati “... *cenonin në radhë të parë statutin dhe rolin e shtresës drejtuese shqiptare. Kësaj shtrese i rrezikohej ekzistenca si shtresë, e madje i kërcënohej edhe ekzistenca fizike...*”¹⁵³

Me pranimin e fesë islame në mënyrë masive¹⁵⁴ nga ana e shqiptarëve, ata arritën të bëhen pashallarë, zaimë, timariotë

¹⁵² H. Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, f. 68.

¹⁵³ Po aty, f. 69.

¹⁵⁴ Për këtë çështje të rëndësishme do të bëjmë fjalë më vonë gjerësisht shih: Skënder Rizaj, *Kosova gjatë shekujve, XV-XVI-XVII, Administrimi, ekonomia, shoqëria dhe lëvizja popullore*, (Prishtinë, Rilindja, 1982), f. 460-477.

dhe të qeverisnin ushtritë e tyre. Perandoria ishte më e dobët në Shqipëri në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit dhe ata ua kishin frikën shqiptarëve në një aspekt.

*“...reformat bënë centralizimin e pushtetit dhe e zvogëlonin ose e asgjësonin këtë autonomi. Kështu, së pari, deri në reformat e Tanzimatit, pashallarët, çifligarët, kapedanët etj. në Shqipëri kishin ushtritë e tyre shqiptare, gati personale, mercenarë (me pagesë)...”*¹⁵⁵

Prej pasojave të tjera të Tanzimatit ishte edhe ajo se: *“...Administrata civile dhe ushtarake, që deri atëherë ishte pothuajse tërësisht shqiptare, me reformat filloi të zëvendësohej secilën herë e më shumë me nëpunës të dërguar nga qendra prej viseve të tjera të Perandorisë Osmane dhe me kombësi joshqiptare...”*¹⁵⁶

Ana tjetër ishte se: *“...Nga reformat u keqësua edhe gjendja e shtresës së ulët të shoqërisë shqiptare, qoftë në fshat, qoftë në qytet. Sistemi nizam parashikonte një shërbim ushtarak pa pagesë, ndërsa deri atëherë shërbimi ushtarak paguhej... Shërbimi ushtarak zbatohej vetëm përkohësisht, sa zgjasnin luftërat, ndërsa sipas reformave shërbimi i rregullt ushtarak ishte i detyrueshëm dhe zgjaste prej 7-12 vjet...”*¹⁵⁷

4-Si e përjetuan dhe si e interpretuan shqiptarët Tanzimatin? -Lindja e idesë së kombit për bashkim kundër armikut

¹⁵⁵ Më gjerësisht, H. Feraj, f. 68-77.

¹⁵⁶ Po aty.

¹⁵⁷ Po aty, f. 68-77.

Këto reforma zgjuan një revoltë mbarëshqiptare dhe ato u interpretuan në mënyra të ndryshme, siç do ta shohim me poshtë. Sipas studiuesit H. Feraj:

“...Vetë reformat e Tanzimatit mund të kuptoheshin dhe të interpretoheshin si sulm ndaj bashkësisë etnike dhe kështu e bënë tërheqëse thirrjen për t’u bashkuar mbi këtë bazë (të kombit, H. Hoxha)...dhe ato cenonin të drejtat zakonore shqiptare të cila deri atëherë kishin shërbyer si bazë e rëndësishme e zgjidhjes së konflikteve në vend... Përjetimi i reformave si sulm mbi baza etnike i osmanëve ndaj shqiptarëve...e bënë të nevojshme dhe të pranueshme idenë e kombit si ide përbashkuese e tyre kundër armikut të tyre të njëjtë...Kombi e kryente më së miri funksionin integrues social dhe politik shqiptar, i tejkalonte dallimet sociale ende të mbetura...Ideja e kombit kryente funksion barazues... Interesat politike, pothuajse të të gjitha shtresave shoqërore, dukej se mund të realizoheshin duke u bashkuar mbi bazën elementare të kulturës së përbashkët, të gjuhës, prejardhjes, historisë etj. Me këtë u realizua afrimi dhe bashkimi i politikës me kulturën dhe lindja e nacionalizmit shqiptar...”¹⁵⁸

Kështu, pra, shqiptarët e kuptuan dhe e interpretuan Tanzimatin si kërcënim dhe vërejtje alarmuese për ekzistencën e tyre etnike, politike, kombëtare, ekonomike dhe socio-religjioze. Pa dyshim këtë reformë në Perandorinë Osmane e shfrytëzuan masat intelektuale shqiptare të krishtera, shqiptarët e jugut-ortodoksë, që ishin në mërgim, në Amerikë, Egjipt, Stamboll, Rumani, Itali etj., për ta ringjallur idenë e kombit, si bosht rreth të cilit mund të mblidheshin shqiptarët për të formuar një fuqi të përbashkët kundër Perandorisë Osmane dhe kjo u realizua me të vërtetë, prandaj edhe pasojat ishin serioze.

¹⁵⁸ Po aty, f. 68-77. Po ashtu shih: Stavro Skëndi, *Zgjidhje kombëtar shqiptar*.

Prej pasojave të Tanzimatit ishte edhe themelimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Me këtë Lidhje, organizim dhe revolucion të gjithëmbarshtëm, shqiptarët u deklaruan publikisht, para opinionit të gjerë botëror, kundër qeverisë osmane dhe kundër vendimeve të Portës së Lartë. Rëndësia e këtij kapitulli është tejet e madhe. Kjo ngjarje historike shqiptare është një ndër ngjarjet më të rëndësishme në çështjen e Krizës Lindore, për të cilën e kemi edhe fjalën. Ajo është shumë e rëndësishme për Perandorinë Osmane dhe, po ashtu, është shumë e rëndësishme për historikun e shqiptarëve. Prandaj, si kemi thënë më lart dhe siç e kemi treguar në mënyrë kronologjike historike natyrën rezistuese, kryengritëse të shqiptarëve gjatë shekujve, Lidhja Shqiptare e Prizrenit është hallkë vazhduese e atij fenomeni rezistues shqiptar, mirëpo në këtë rast ndryshojnë rrethanat politiko-shoqërore dhe këtë radhë është nxitur prej klerikëve fetarë dhe intelektualëve shqiptarë muslimanë kryesisht. Historia e shqiptarëve nuk mund të kuptohet në mënyrë të drejtë pa studimin dhe analizimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, për të cilën do të bëjmë fjalë në kapitullin vijues, in sha'Allahu Teala.

KREU I GJASHTË

A- Rrethanat politiko-ndërkombëtare dhe lëvizja pansllaviste ruse

Kur u bë bashkimi i Gjermanisë më 1870-1871, Austro-Hungaria, duke hequr dorë nga ndikimi në tokat gjermane, e orientoi politikën e vet të jashtme në drejtim të Ballkanit dhe synonte të pushtonte Bosnjën¹⁵⁹ dhe Hercegovinën, e më pas Shqipërinë dhe Selanikun. Për ta realizuar këtë qëllim, Austro-Hungaria bëri çmos për ta fituar përkrahjen e Gjermanisë që të depërtonte nga Lindja. Kështu, në mbledhjen e Berlinit, më 1872, tre ministrat e jashtëm të tre shteteve kryesore u mblodhën për të formuar aleancën e tyre: Bismarku i Gjermanisë, Gorcakovi i Rusisë dhe Andrashi i Austro-Hungarisë. Ata u deklaruan me shkrim se në radhë të parë ishte ruajtja dhe mbrojtja e paqes, si edhe ruajtja dhe mbrojtja e idesë së krishterimit nën emrin apo maskën e pansllavizmit ballkanik.¹⁶⁰

B-Pansllavizmi rus – historiku i tij

Sa i përket idesë pansllaviste ruse dhe termit pansllavizëm, historianët na flasin se ky term u përdor për herë të parë, më 1826, nga një shkrimtar sllovak. Kjo rrymë në fillim planifikonte të çlironte sllavët nga okupimi austriak dhe osman. Ndërkaq në Rusi, qysh nga viti 1820, ishte formuar “Shoqata e

¹⁵⁹ Më gjerësisht shih: Fikret Karcic, *The Bosniaks and the Challenges of Modernity-Late Ottoman and Hapsburg Times*, (Sarajevo, El-kalem, 1999).

¹⁶⁰ S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 39.

Sllavëve të Njësuar”, sipas parimeve të së cilës: rusët, polakët, çekët, serbët, kroatët, bullgarët dhe sllovenët ishin një komb, dhe se Deti i Ngrirë në Veri (i Siberisë), Deti Mesdhe në Jug, Deti i Zi në Lindje dhe deti Adriatikut në Perëndim, ishin dete sllave.¹⁶¹

E kemi thënë më lart, dhe po e përsërisim këtu, se faktori fetar ka qenë mbi të gjithë faktorët e tjerë që kanë ndikuar dhe ende ndikon në zhvillimin e historisë njerëzore në përgjithësi dhe asaj ballkanike në veçanti. Premisat e lartpërmendura kur’anore po dalin në shesh dita-ditës, pas çdo ngjarjeje edhe më të vogël. Kjo vërehet qartë dhe pastër edhe me çështjen pansllaviste ruse.

Para luftës së Krimesë, që u zhvillua më 1841, pansllavistët rusë u tubuan rreth revistës “*Moskovitjanin*”, të historianit rus Mihail Petroviç Pogodin. Sipas tyre, Evropa Perëndimore ishte infektuar nga një sëmundje infektuese, ishte kalbur dhe e kishte vdekjen afër. Pas saj do të lindte një Perandori e madhe sllave, në kryeqytetin e Turqisë. Me të vërtetë, kur shpërtheu lufta ruso-osmane, më 1853-1856, ata menduan se erdhi koha e pansllavizmit rus dhe e imperializmit të saj.¹⁶²

Për t’i bërë ballë kësaj sfide religjioze dhe kësaj stuhie shkatërruese ideologjike dhe morale, qeveria osmane filloi të ndërmerre masat e duhura kundër lëvizjes pansllaviste ruse, duke caktuar personalitete si Mit’hat Pashën, Ymer Pashën etj., në disa valillëqe dhe disa ejalet të Prizrenit, të Nishit etj.¹⁶³

¹⁶¹Po aty, f. 40; shih dhe Mehdi Frasheri, *Historia e lashtë e Shqipërisë dhe e shqiptarëve*, f. 34-35.

¹⁶²S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 40.

¹⁶³Po aty, f. 41.

Si zakonisht për armiq të, edhe Rusia filloi të ndërmarrë hapa serioze për realizimin e qëllimeve të saj, duke caktuar persona të ushtruar dhe të aftë për mashtrime dhe persona të korruptuar. Ata caktuan në zyrën e tyre - konsullatën aziatike në Stamboll, Nikollaj Pavliviç Ignatiev (1832-1908) dhe ky person u bë bajraktar i pansllavizmit në diplomacinë ruse. Ky njeri, sipas disa burimeve historike, arriti të lidhte marrëdhënie të forta dhe të përfitonte nënën e Sulltan Abdylazizit II (1861-1876), dhe ndërmjet saj e përfitoi edhe Sulltanin personalisht, sa që thuhet se u bë pjesëtar i haremit të grave të tij. Kështu, dalëngadalë, ai e zgjeroi rrjetin e tij destruktiv edhe në kanale të tjera të qeverisë osmane dhe ndikoi në largimin e vezirit të madh, Mit'hat Pashës, si dhe ndikoi negativisht në politikën dhe ekonominë e Perandorisë Osmane. Po ashtu, ai filloi ta nxjerrë në diskutim çështjen e Bosnjës, Hercegovinës, Serbisë, Malit të Zi dhe të Bullgarisë, për shkak se ishte në pyetje popullata sllave.¹⁶⁴

Edhe këtu shihet qartë mrekullia kur'anore, se jobesimtarët (*çifutët dhe të krishterët ortodoksë dhe katolikë janë miq dhe i ndihmojnë njëri-tjetrit*).¹⁶⁵

Historiografia shqiptare na flet se bashkimi i Gjermanisë, më 1871, i zgjoi ndjenjat e rusëve më shumë ndaj pansllavizmit. Kjo vërehet qartë në deklaratën e njërit prej ithtarëve të saj, Nikollaj Jakovleviç Danilevskij, në librin e tij: '*Rusia dhe Evropa*', ku ai e paraqet Çështjen Lindore në shek. e XIX-të, si vazhdim të luftës dymijë vjeçare ndërmjet Romës dhe Greqisë.

¹⁶⁴ Po aty, f. 42; po ashtu shih, Gazmend Shpuza, *Kuvendime për historinë kombëtare*, (Shtëpia bot. Dituria, Tiranë, 2000), f. 81-104.

¹⁶⁵ Suretu El- Enfal:73

Gjermania tani e zuri vendin e romakëve, ndërsa Rusia vendin e bizantinëve...¹⁶⁶

Plane dhe aspirata këto të tmerrshme për njerëzimin në përgjithësi dhe për muslimanët, në veçanti po të ishin realizuar... Mirëpo Allahu, me forcën dhe madhërinë e Tij, ua zmbrapsi ato plane dhe ata dështuan. Falënderimi I takon vetëm Atij, subhanehu ve teala.

C-Shpërthimi i Krizës Llindore

Mbasi që Evropa mbeti nën ndikimin e tri perandorive të mëdha: të Rusisë, të Austrisë dhe të Gjermanisë, këto filluan të planifikonin planet e tyre të mëtejshme, duke u mbledhur në Berlin, Vjenë dhe Petrograd.¹⁶⁷

Ata diskutonin Çështjen e Lindjes dhe ndikonin në komunitetet sllave që ishin në Bosnjë, Hercegovinë, Mal të Zi, Serbi dhe Bullgari, duke i përkrahur ata materialisht dhe moralisht, me qëllim që të ngriheshin kundër Perandorisë Osmane¹⁶⁸ dhe kështu u bë. Hercegovasit u ngritën në Vësinjë, më 1875. Disa prej tyre u bashkuan me serbët dhe kërkuan krijimin e një Serbie të madhe. Kjo kryengritje u zgjerua edhe në Bosnjë, ku boshnjakët kërkuan lirinë e fesë, barazi, mbrojtje nga zulumet e xhandarëve, anulim të angarës, të taksave (të dhjetat) etj. Si pasojë e kësaj kryengritjeje dhe kërkesë të Bosnjës, shtetet e mëdha intervenuan dhe kërkuan reforma për Bosnjën dhe Hercegovinën. Porta e Lartë u premtoi, dhe më 12.12.1875, u lëshua fermani mbi reformat në gjithë Perandorinë...¹⁶⁹

¹⁶⁶ S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 43.

¹⁶⁷ Po aty, f. 44; shih dhe Georges Castellan, *Historia e Ballkanit*, f. 342.

¹⁶⁸ Mehmet Maksudoglu, *Ottoman History based mainly on Ottoman sources*, f. 293; shih dhe Justin McCarthy, *Death and Exile*, f. 6, 10, 12

¹⁶⁹ S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare*, f. 44; Më gjerësisht shih Fikret Karcic, *The Bosniaks and the Challenges of Modernity...* Po ashtu shih artikullin në:

Pas kryengritjes së Bosnjës dhe shpalljes së reformave pasuan edhe ngjarje të tjera, sepse të tjerët filluan ta shfrytëzonin dobësinë e Perandorisë Osmane dhe morën zemër për kryengritje. Kështu shpërtheu kryengritja bullgare në Plovdiv, ku u bënë masakra mbi popullatën muslimane. Gjendja ekonomike e Perandorisë filloi të dobësohej. Borxhet ishin të mëdha, mbi 200.000.000 (dyqind milionë lira). Për çdo vit Perandoria i jepte kamatë Evropës 14.000.000 (katërmëdhjetë milionë lira) etj., dhe kështu u shpall falimentimi i Perandorisë.¹⁷⁰

Pas këtyre ngjarjeve është me rëndësi të përkujtohet edhe një ngjarje në Selanik të Greqisë. Historianët na flasin se një vajzë bullgare kishte shkuar në Selanik për të kaluar në fenë islame. Mirëpo kjo vajzë u rrëmbye nga ana e konsullit amerikan. Popullata muslimane e Selanikut reagoi ashpër kundër këtij rasti jonjerëzor, me ç'rast u vra konsulli francez dhe konsulli i Gjermanisë. Për këtë ndodhi shtetet evropiane reaguesh ashpër, me ç'rast Rusia, Austria, Gjermania i dërguan Perandorisë Osmane një memorandum që quhet: 'Memorandumi i Berlinit', me kushte shumë të rënda kundër Perandorisë, ku kërkoheshin më shumë të drejta dhe privilegje për krishterët.¹⁷¹

Ata të cilët nuk e besojnë Islamin (armiqtë e fesë islame) janë miq dhe shokë ndërmjet vete dhe i ndihmojnë njëri-tjetrit. Ky është një realitet kur'anor i vërtetuar historikisht. Kjo nuk do të thotë se ne jemi ekstremistë, apo se jemi fanatikë...Kurrë... Kjo zbërthen fshehtësinë që ekziston në zemrat e atyre të cilëve

Journal of Islamic Studies, vol.5, no:2, (Jul.1994, Oxford University Press), Dr.Muhamet Mufaku Alarnaut, Islam and Muslims in Bosnia 1878-1918, *Two Hijras and two Fatwas*, f. 242-253.

¹⁷⁰ S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 44; Justin McCaerthy, *Death and Exile*, 5: Georges Castellan, *Histori e Ballkanit*, f. 176.

¹⁷¹ S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 45.

nuk e besojnë Islamin si fe të fundit dhe si anuluese për fetë e tjera para saj. Këtë fshehtësi na e ka zbuluar Allahu xh.sh., krijuesi i gjithësisë dhe i mbarë njerëzimit. Është me rëndësi të dihet se një prej kërkesave të këtij memorandumi ishte që krishterëve t'u lejohej bartja e armëve, derisa të sendërtoheshin reformat dhe se këto reforma të zbatoheshin nën mbikëqyrjen e konsujve të shteteve të Evropës!!¹⁷²

Pas kësaj ngjarjeje, Serbia dhe Mali i Zi, të nxitur nga pansllavizmi rus, i shpallën luftë Perandorisë Osmane, më 1 korrik 1876, të nxitur nga Ignatievi, me qëllimin e bashkimit të sllavëve dhe të bullgarëve.¹⁷³

Kësaj propagande pansllaviste tani iu zbulua realiteti i saj, kështu që ajo mori formën: *muslimanizmi apo krishterizmi? europeizmi apo aziatizmi?* Rusia tani ishte e gatshme t'i ndërpriste marrëdhëniet diplomatike me qeverinë osmane. Po ashtu, edhe Anglia deklaroi se ishte e gatshme për luftë.¹⁷⁴

Planet anti-islame të jobesimtarëve dolën në shesh me ardhjen në pushtet të Carit të Rusisë Aleksandri II, i cili u konsiderua si shpëtimtar i të gjithë sllavëve të Ballkanit. Populli sllav ishte i gatshëm të hynte me të në luftë të shenjtë¹⁷⁵!!!

“...dhe se Rusia në kokën e saj – sipas disave – kishte për qëllim krijimin e një shteti të madh bullgar sllav në Ballkan, pa asnjë musliman dhe që Ballkani të ishte mburojë e interesave ruse...”¹⁷⁶

Pas këtyre ngjarjeve, si zgjidhje dhe manipulim tjetër prej shteteve të Evropës, për realizimin e qëllimeve dhe planeve të

¹⁷²Po aty, f. 45.

¹⁷³Po aty, f. 46.

¹⁷⁴Po aty, f. 48.

¹⁷⁵Po aty, f. 49.

¹⁷⁶Justin McCarthy, *Death and Exile*, f. 138-139.

krishtera (ortodokse apo katolike), ministri i Anglisë, Lordi Derby, sugjeroi mbajtjen e një konference në Stamboll që do të shqyrtonte Çështjen Lindore.

D-Konferenca e Stambollit (23 dhjetor, 1876-20 janar,1877)

Qëllimi i kësaj konference ishte rishikimi i çështjeve administrative të Perandorisë Osmane, arritja e një paqeje me Perandorinë Osmane, rikthimi i gjendjes së moçme në Serbi, Mal të Zi dhe njohja e autonomisë së Bosnjës dhe Hercegovinës. Po ashtu, Cari i Rosisë, Aleksandri II, do të kërkonte personalisht nga Perandoria Osmane garanci për sllavët e Ballkanit. Ignatievi kishte përgatitur një listë me kërkesa të rënda, të cilën ua bëri me dije shteteve të Evropës atë listë. Në atë listë vërehej haptazi dhe qartë armiqësia dhe urrejtja ndaj muslimanëve, në përgjithësi dhe Perandorisë Osmane në veçanti. Në atë listë ishin shkruar këto kërkesa, që duhej të përmbusheshin në këtë konferencë:

- 1- Çarmatimi i muslimanëve të Bosnjës, Hercegovinës dhe të Bullgarisë.
- 2- Largimi i nëpunësve osmane nga këto vende.
- 3- Formimi i policisë nga të krishterët vendas.
- 4- Ushtria osmane duhej të mbetej vetëm nëpër fortifikata.
- 5- Anulimi i yshrit(fjalë arabe që dmth:tatimi i 1/10) dhe vjelja e tatimeve nga vendasit.
- 6- Përdorimi i gjuhës së vendit në gjyq dhe në administratë.
- 7- Vendosja e valinjve të krishterë, siç ishte rasti në Liban, për pesë vjet.
- 8- Dënimi i rëndë për ata muslimanë që kishin marrë pjesë në krimet kundër të krishterëve. Të krishterëve t'u paguheshin dëmet e bëra nga populli musliman.

Këto kërkesa të palogjikshme nuk i kundërshtoi as Anglia, as Austria dhe as shtetet e tjera të mëdha të Evropës.¹⁷⁷

Pra, në këtë konferencë të gjatë, çështja shqiptare as që u përmend nga Ignatievi dhe diplomatët e tjerë.¹⁷⁸

Sipas prof. Skënder Rizajt, marrëdhëniet ndërkombëtare ishin shumë të disfavorshme për shqiptarët. Ata nuk mund të mbështeteshin as në Portën e Lartë, as në qeveritë monarkiste të shteteve fqinje, e as në shtetet imperialiste të Evropës, interesat e të cilave konfrontoheshin mu në tokat dhe pasuritë e shqiptarëve, sepse këto toka kishin rëndësi gjeostrategjike.¹⁷⁹

E-Lufta ruso-osmane dhe pasojat e saj mbi shqiptarët (24 prill, 1877-1878)

Mbasi që në këtë konferencë nuk u arrit ndonjë marrëveshje dhe mbasi që Perandoria Osmane i refuzoi kërkesat e shteteve evropiane dhe protokollin e Londrës, Rusia vendosi që ta zgjidhte vetë Çështjen Lindore duke i shpallur luftë Portës së Lartë dhe duke bërë mobilizimin e përgjithshëm të popullit. Kështu, më 26-27 qershor 1877, ajo u fut në tokat e Perandorisë Osmane. Në këto momente të vështira të luftës, kur Rusia i shkaktoi dëme të mëdha Perandorisë Osmane, Serbia

¹⁷⁷ Më gjerësisht S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 48-49; po ashtu shih Nexhip P. Alpan-Nesim Kaci, *Shqiptarët në Perandorinë Osmane*, f. 34.

¹⁷⁸ S. Rizaj, f. 55.

¹⁷⁹ Po aty, f. 60.

dhe Mali i Zi e shfrytëzuan rastin. Kështu edhe ato i shpallën luftë Perandorisë Osmane.¹⁸⁰

Kur rusët hynë në Edrene, më 31 janar 1878, aty u nënshkrua një marrëveshje për armëpushim. Sipas një paragrafi të asaj marrëveshjeje u pranua okupimi i territoreve deri në dyert e Stambollit. Më 24 shkurt, gjenerali Grunduk Nikolla e pushtoi Shën Stefanin-Yeshil Koy, paralagje e Stambollit. Në këtë vend, më 3 mars 1878, u arrit përsëri marrëveshja për paqe mes Perandorisë Osmane dhe asaj ruse, dhe kjo paqe kishte 29 nene të dëmshme për shqiptarët dhe ardhmërinë gjeografiko-etniko-kulturore të tyre.¹⁸¹

Prej neneve ishte edhe njohja e pavarësisë së Malit të Zi, zgjerimi i territoreve të saj, njohja e pavarësisë së Serbisë dhe ndryshimeve të kufijve të saj, që shkonte në dëm të shqiptarëve dhe të muslimanëve, dhe se “...Muslimanët (shqiptarët, turqit, boshnjakët, çerkezët) të cilët donin të banonin jashtë principatës së Malit të Zi, mund t’i ruanin trojet e veta në territoret e aneksuara Serbisë, duke ia ngarkuar punën tjetër kujt, ose duke i lënë ato të drejtoheshin nga të tjerët...”¹⁸²

Historianët potencojnë pasojat e luftës ruso-osmane “... pra, si rezultat i luftës ruso-osmane, më saktë i vendimeve të paqes së Shën Stefanit, Perandoria Osmane u copëtua...Me paqen e Shën Stefanit u cenuan më së shumti interesat e turmave popullore (boshnjakëve, çerkezëve, shqiptarëve) të Perandorisë Osmane, e në mënyrë të qartë interesat e shqiptarëve, sepse

¹⁸⁰Po aty, f. 67. Po ashtu shih Justin McCarthy, *Death and Exile*, f. 109-116; Po ashtu shih ditarin e princes Aishe Osman Oglu, e bija e Sultan Abdul Hamit 2 në arabisht: *Validi Es Sultan Abdul Hamdid el Thani*, 56-11.

¹⁸¹S. Rizaj, f. 69-70.

¹⁸²Po aty, f. 70. Për nenet dhe vendimet e Paqes në fjalë shih edhe faqet 69-73, po aty.

vendimet e paqes në fjalë do të sillnin shtypje më të egër politike, kombëtare, fetare, kulturore, ekonomike dhe sociale. Bile për shqiptarët, turqit, boshnjakët dhe çerkezët do të sillnin edhe gjenocid. Mu për këtë arsye, popullsia shqiptare u tmerrua nga fatkeqësia që i ra në krye. Prandaj shqiptarëve nuk u mbeti tjetër pos të rezistonin në çdo mënyrë kundër paqes së Shën Stefanit...”¹⁸³

E Tërë ajo që u cek me lartë mjafton për të deshmuar në korrektësinë e teorisë sonë, se faktori fetar të luftërat gjithmonë ka ekzistue dhe akoma ekziston në planet e perandorive, popujve dhe shteteve të ndryshme. Prandaj nuk është e saktë logjikisht dhe jo de-facto historikisht se kinse vetëm Perandoria Osmane kishte për qëllim ekspansionimin e fesë Islame, a ndërsa të tjerët jo!!

Një prej çështjeve të rëndësishme që ka të bëjë me Çështjen Lindore dhe shqiptare është edhe çështja e ikësve – muhaxhirëve. Prandaj le të hedhim pakëz dritë mbi këtë çështje, për rëndësinë që ajo ka dhe për faktin se është objekt diskutimi në këtë punim.

¹⁸³ Po aty, f. 74.

KREU I SHTATE

Çështja e të shpërngulurve – muhaxhirëve (1877-1885)

A-Shkaqet e ikjes (emigrimit)

Historiani dhe dijetari prof. Skënder Rizaj pohon se për këtë çështje ekzistojnë mendime të llojllojshme. Kjo dukuri, sipas tij, ishte një prej shkaqeve më kryesore të formimit dhe aktivitetit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Për këtë gjendje të rëndë në Vilajetin e Kosovës, dëshmoi edhe deputeti i Kosovës në Perandorinë Osmane, Mustafa Efendiu, kur tha:

*“...Qytezat Pirot, Leskovc dhe Prokuple të Kosovës i pushtoi Serbia... Atje ka shumë shqiptarë, por ata nuk kanë armë. I gjithë Vilajeti i Kosovës llogaritet si Shqipëri. Në të vërtetë aty është shpirti i Shqipërisë...”*¹⁸⁴

Një prej shkaqeve të shpërnguljes ishte edhe asqerllëku, sepse kjo popullsi nuk dëshironte të shërbente në ushtritë e shteteve të krishtera dhe të vishte uniformën e tyre.¹⁸⁵

Po ashtu, shkak ishte edhe presioni, zullumi dhe vrasjet nga ushtarët rusë, serbë, malazezë, bullgarë dhe grekë. Këto shtete ndiqnin politikën pansllaviste ruse, kështu që ata bënë çmos për t'i realizuar ato qëllime. Ata bënë edhe përdhunimin e femrave muslimane, vidhnin dhe rrëmbenin pasurinë. Po ashtu shkak ishte edhe uria e madhe, sëmundjet, djegia e tyre nëpër xhami, nëpër shitore, nëpër kafe etj.¹⁸⁶

Shkak tjetër ishte edhe frika e shqiptarëve muslimanë nga çkombëtarizimi dhe kalimi i tyre në kombësinë serbe,

¹⁸⁴S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 77-78.

¹⁸⁵Po aty, f. 79.

¹⁸⁶Po aty; shih dhe Justin McCarthy, *Death and Exile*, f. 138-141.

malazeze, greke etj.¹⁸⁷ Po ashtu shkak tjetër ishte edhe frika e muslimanëve të Ballkanit se mos po konvertoheshin në krishterizëm, siç ishte rasti me muslimanët e Bullgarisë, sepse ata që konvertoheshin nuk masakroheshin prej ortodoksëve serbë apo bullgarë.¹⁸⁸

Sipas disa studiuesve të tjerë, ekzistojnë edhe shkaqe të tjera (si ai ekonomik), që i kanë detyruar shqiptarët të shpërngulen. Ky faktor nuk mund të përgjithësohet për të tërë shqiptarët, sic mendon edhe studiuesi Georges Castellan në librin e tij: ‘Histori e Ballkanit’. Sa për ilustrim po shënojmë këtë pohim të tij: “...Zhvillimi ekonomik shoqëror në shek. e XIX-të pati provokuar një sërë valësh të emigrimit për në Stamboll, kryeqytetin e Perandorisë, që më 1850 ishte qyteti më i madh që ishte mbushur me koloni shqiptare, me një numër prej 60 mijë emigrantësh. Një drejtim tjetër emigrimi ishte Greqia, Egjipti, principatat rumune, Rusia e Jugut dhe më vonë Amerika, madje edhe Australia. Duke rënë në kontakt me nacionalizma të tjerë, këto koloni shqiptare, së bashku me shpërnguljet e moçme të arbëreshëve të Italisë së Jugut, luajtën një rol të madh në formimin e ndërgjegjes kombëtare...”¹⁸⁹

Po siç pohojnë edhe studiues të tjerë, ata që kanë emigruar nga Shqipëria për shkaqe ekonomike ishin shqiptarët ortodoksë të Jugut, që shkuan në Amerikë, në Egjipt, në Rumuni, Stamboll, Greqi etj.¹⁹⁰

¹⁸⁷ Po aty, f. 79; shih dhe J.McCarthy, *Death and Exile*, 1, 19, 59, 94.

¹⁸⁸ J.McCarthy, *Death and Exile*, f. 152-153.

¹⁸⁹ Georges Castellan, *Histori e Ballkanit*, f. 379-380.

¹⁹⁰ Më gjerësisht shih Petrika Thengjilli, *Historia e Shqipërisë*, 27; Muhamet Mufaku, *Shqiptarët në botën arabe*, f. 97-130; Haris Silajxhic, *Shqipëria dhe SHBA në Arkivat e Washingtonit*, përkthyer nga Xhelal Fejza, (Tiranë, Dituria, 1999), f. 25-42.

B-Qëndrimi i klerit fetar(hoxhallarëve) përballë kësaj dukurie shkatërruese

Sa i përket rolit të klerit fetar musliman, ai nuk qëndroi duar kryq dhe i habitur përballë kësaj dukurie. Ndonëse për momentin nuk mund të vërejmë ndonjë qëndrim kolektiv¹⁹¹ të hoxhallarëve rreth emigrimit dhe pasojave të tij për trojet shqiptare dhe shqiptarët, megjithatë kemi raste të shkëlqyera të qëndrimit të tyre kundër valës së emigrimit dhe zbrazjes së trojeve etnike shqiptare. Disa prej tyre janë futur në rrjedhat e ngjarjeve politike dhe ushtarake. Kjo shihet edhe në rastin e deputetit tjetër kosovar në Perandorinë Osmane, që ishte edhe myfti i Prishtinës, Zejnel Abidin Efendiut. Në Vilajetin e Kosovës ishte krijuar një gjendje e mjerueshme për shkak të veprimtarisë së pansllavizmit ruso-serb. Ky myfti i zgjuar dhe patriot besimtar, për mendimin tim, tha para Qeverisë Osmane: *“...Zotëri tani u lexua letra e marrë nga Kosova. Ajo u kuptua. Të shkojmë atje e të luftojmë. Të biem në luftë si dëshmorë ose të gjejmë shtegdalje për sigurimin e ardhmërisë së atdheut...”*¹⁹²

Sipas studiuesve fanatikë dhe gjakpirës serbë, si p.sh. Vaso ÇubriloVIC, kinse ikja e shqiptarëve nga disa vende ishte bërë vullnetarisht e jo nga dhuna, si kishte ndodhur me të ikurit nga zullumet ruse dhe bullgare. Sipas këtij kriminel:

“...banorët muslimanë shqiptarë, turq dhe çerkezë të qyteteve Nish, Ak-pallanka, Pirot, Leskovc dhe Vranje, i lëshojnë vendbanimet e tyre me rastin e tërheqjes së ushtrisë osmane.

¹⁹¹ Normal raste individuale ka shumë, si p.sh. Mulla Idris Gjilani, Hoxhë Kadri Prishtina, etj, më detalisht referojnë punimeve të prof. Muhamet Pirrakut për këto çështje të levizjes kombëtare dhe kacake të hoxhallarëve në Kosovë. Dhe kontributin e tyre kombëtar dhe fetar.

¹⁹² S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 78, marrë nga: *(Bashbakanlik Arsivi, Istanbul. Meclisi Meb’usan, ikinci cild, 13 Aralık 1877, 16 Subat 1878 in’ikadlar, Istanbul, 1954, f. 77-78).*

*Këta u vendosën kryesisht në “Serbinë e Vjetër” [Vilajetin e Kosovës]...”*¹⁹³

C-Mënyrat dhe metodat ruse dhe bullgare gjatë dëbimit të popullatës muslimane

Rusët dhe bullgarët i dogjën shtëpitë e muslimanëve duke i goditur fshatrat dhe shtëpitë me topa të rëndë artilerie. Kjo u bë në prill të vitit 1877.¹⁹⁴

Ushtria ruse i armatosi bullgarët dhe i nxiti ata, në frymën e shenjtë pansllaviste, që të bënin masakra mbi popullatën muslimane¹⁹⁵. Nga ana tjetër, në vendet e pushtuara nga Mali i Zi, u kërkua që popullsia muslimane të mobilizohej dhe të luftonte krah për krah me ushtrinë malazeze, kështu që ata muslimanë (shqiptarë-boshnjakë) u detyruan të shpërngulen, dhe refuzuan luftën krah për krah me malazezë...¹⁹⁶

¹⁹³ S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 79.

¹⁹⁴ Disa tentativa në Ballkan dhe në vendet e tjera për të krijuar një shtet homogjen monokulturor, monoetnik, dhe monoreligjioz kanë dështuar dhe kësaj fushate i ka ardhur fundi njëherë e përgjithmonë d.m.th: ka qenë e pasuksesshme në të kaluarën por edhe tani kush mundohet për ta bërë një gjë të tillë, si Millosheviqi në Bosnjë dhe në Kosovë...s’ka për të pasur sukses... Më gjerësisht: *Muslim Identity and Ballkan State...*26-31

¹⁹⁵ Prof. S. Rizaj thotë (dhe me këtë deklaratë ai pajtohet me metodën tonë në studimin historisë njerëzore dhe asaj shqiptare) se faktori fetar ka qenë faktori dominues dhe nxitës numër një për arsyetimin e masakrave të shteteve imperialiste, prandaj, me fjalë të tjera, nëse shkojmë nga metoda e islamizimit të historisë, kuptohen shumë lehtë problemet, motivet dhe shkaqet e kryengritjeve dhe të luftërave. Prof. S. Rizaj thotë: “Ç’është e vërteta, siç na bën me dije ambasadori i Anglisë në Stamboll, Layard, ushtria ruse dhe bullgare kishte për qëllim që t’i dëbonte me dhunë të gjithë pjesëtarët e besimit musliman nga Rumelia (Ballkani) dhe atyre t’ua konfiskonte pronat...”, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 81, ***Muslim Identity***, f. 19-20.

¹⁹⁶ Më gjerësisht shih S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 79. Po ashtu për më gjerësisht shih edhe statistikat e muhaxhirëve në: *Deth and Exile*, f. 88-91,159,161,162,163,164,

Si pasojë e shpërthimit të krizës lindore, muslimanët në përgjithësi, e shqiptarët në veçanti filluan të merrnin në mënyrë masive rrugën drejt vilajeteve të ndryshme. Kështu, siç u theksua më lart, shqiptarët e Nishit dhe rrethinës së tij, u vendosën në vilajetin e Kosovës, pastaj gradualisht, për shkak të kushteve shumë të rënda, të mbetur pa shtëpi, pa kafshë, pa pasuri, pa tokë, morën rrugën e Stambollit. Sipas disa statistikave, vetëm gjatë viteve 1877-1879, nga viset e ndryshme të Ballkanit ishin shpërngulur mbi 1.000.000 banorë (muslimanë).¹⁹⁷

Kështu ishte edhe gjendja e shqiptarëve të shpërngulur, po ashtu edhe e boshnjakëve, të cilët erdhën nga Serbia për në Kosovë e pastaj për në Stamboll me tren, e më pas për në Anadoll me anijet e qeverisë osmane, të cilat ajo i kishte marrë me qira nga Anglia, Franca, Austria, Egjipti dhe nga Rusia. Perandoria Osmane hiqte shpenzimet e transportit dhe kishte caktuar një komision të muhaxhirëve special për këtë çështje ‘*lexhnetu iskanul-muhaxhirin*’.¹⁹⁸ Qendrat stacionuse të të shpërngulurve ishin: Edirne, Stambolli, Çanakkalaja, Samsuni dhe Izmiri.¹⁹⁹

Kështu pra, fluksi i shqiptarëve e sidomos i grave së Toplicës dhe grave të krishtera të ikura nga Shqipëria veriore (trojet e Sanxhakut të Nishit dhe të Piratit), që arritën në Prizren, arriti shifrën²⁰⁰ 10.000, të cilët kërkonin lëmoshë për të ekzistuar..

¹⁹⁷ S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 80.

¹⁹⁸ Siç pohojnë edhe studiues të tjerë, qindra muhaxhirë vdiqën si pasojë e sëmundjeve të ndryshme, pasi nuk ekzistonin as kushtet minimale për jetesë dhe për shkak të dimrit të ftohtë etj... Shih më gjerësisht: S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare*, f. 81, Justin McCarthy, *Death and Exile*, f. 36-37.

¹⁹⁹ S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare*, f. 80-81. Po ashtu shih, *Muslim Identity and the Balkan State*, f. 146-147, f. 168-169.

²⁰⁰ Shih më gjerësisht: S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 81.

Gjendje e muhaxhirëve, siç thamë më lart, ishte tejet e rëndë²⁰¹. Kështu për ta rregulluar gjendjen e tyre, në mënyrë më sistematike dhe më efikase, u formuan komisione speciale për t'u kujdesur për ta dhe për të distribuuar artikujt ushqimorë. Kështu pra, në Stamboll u formua komisioni për ndihmën e muhaxhirëve '*lexhnetu ianetul muhaxhirine*'.

Edhe në Prishtinë, si qendër e vilajetit të Kosovës, u formua i njëjti komision. Po ashtu, në Prishtinë ishte edhe ripunësimi për vendosjen e muhaxhirëve. Ndërkohë, në intervalin kohor 21 qershor deri më 11 korrik 1878, përfaqësuesit e muslimanëve (të shqiptarëve, turqve, boshnjakëve dhe çerkezëve) i kanë dërguar Kongresit të Berlinit 145 (peticione) ku protestonin kundër copëtimit të trojeve dhe viseve të Janinës, Manastirit, Tivarit, Nishit, Prokuplas, Kurshulias, Dibrës, Prishtinës, Jeni Pazarit, Bosnjës, Podgoricës etj..., nga ana e Fuqive të Mëdha. Mirëpo ato peticione nuk patën efekt, madje Fuqitë e Mëdha ishin të kënaqura me këtë gjendje të mjerueshme të muslimanëve.²⁰² Muhaxhirët e Gadishullit Ballkanik (shqiptarët, turqit, boshnjakët, çerkezët dhe tartarët) u vendosën në vise të ndryshme të Anadollit, më pas një pjesë shkoi në Siri²⁰³, në Qipro, në Arabi, Haleb, Damask, Diyarbakir dhe një

²⁰¹ Sa që në prill të vitit 1878, vdisnin 300-500 muhaxhirë në ditë ...S.

Rizaj, f. 83

²⁰² Po aty, 83.

²⁰³ Në këtë periudhë, vala e emigrimit i përfshiu edhe shqiptarët e Shqipërisë së Jugut. Kështu, sipas burimeve, i pari shqiptar që vuri këmbën në truallin amerikan, më 1876, ishte një shqiptar nga Korça. Shkaku i emigrimit të këtyre shqiptarëve në shekullin e kaluar ishte varfëria e madhe dhe dëshira për përmirësimin e gjendjes ekonomike. Po ashtu një ndër shkaqet ishte edhe analfabetizmi. Numri i tyre ishte në rritje e sipër, sa që arriti me dhjetëra mijëra shqiptarë, kryesisht (gati të gjithë) ortodoksë. Çka është me rëndësi të ceket këtu është se këta emigrantë shqiptarë në Amerikë (intelektualët) bënë të pamundurën dhe u treguan shumë aktivë në formimin dhe themelimin e

numër i madh i tyre u vendosën në vilajetin e Kosovës, të Shkodrës, Janinës, Manastirit, të Selanikut etj.²⁰⁴

Po ashtu, sipas Prof. Skënder Rizajt: “Në Vilajetin e Kosovës u vendosën edhe disa muhaxhirë të krahinave të pushtuara nga Mali i Zi...Në vilajetin e Kosovës, në atë kohë, kishte përafërsisht 200.000²⁰⁵ muhaxhirë të shpërngulur nga kriza e Nishit, Kurshumlisë, Leskovcit, Vranjës...Sipas raportit të konsullit anglez në Beograd, në rrethinën e Kumanovës ishin 5.000 muhaxhirë muslimanë, prej territorit të vilajetit të Danubit - Bullgarisë...Shumë muhaxhirë iu drejtuan konsullit anglez në Prizren që të intervenonte, në mënyrë që t’u mundësohej që t’i shitnin pasuritë e tyre të patundshme, të cilat iu kishin mbetur në Nish...sepse shumicës së muhaxhirëve muslimanë serbët ua kishin marrë pasurinë 99% më lirë se sa kushtonte vetë malli..²⁰⁶ Në një deklaratë të konsullit anglez Alvarez, më 10 maj 1880, thuhej se myftiu i Kosovës, Hajredin

shoqatave atdhetare të ndryshme me karakter kulturor, arsimor, kombëtar, fetar dhe militar. Ata ndikuan dukshëm në publikun amerikan dhe atë evropian në çështjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe ruajtjen e integritetit të saj, që të mos copëtohej prej Fuqive të Mëdha (mes Italisë dhe Greqisë). Kështu ata kërkuan dhe gjetën pjesërisht ndihmën amerikane...Më gjerësisht shih: *Shqipëria dhe SH.B.A. në arkivat e Washingtonit*, Haric Salajxhic, f. 25-43. Po ashtu shqiptarët e jugut u shpërngulën në Egjipt, sepse atje ende ishte dinastia e shqiptarëve... *Muhamed Mufaku, Shqiptarët në botën arabe*, Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 97-129.

²⁰⁴Po aty, f. 83-84. Shih dhe: *Death and Exile*, f. 36, 37, 65, 89. Po ashtu, për gjendjen dhe emigrimin e muslimanëve të Bullgarisë, romakëve, shih: Hugh Poulton and Saha Taji-Forouki editors: *Muslim identity and the Balkan State*, the article: *Strategies for sustaining a Valuerable Identity - Case of Bulgarian Romaks*, Yuhon Konstatinor, (U. Kingdom, 1997), f. 33-53.

²⁰⁵Ky numër është afër numrit të muhaxhirëve të Bosnjës, që ishte rreth 150.000 gjatë sundimit të Austro-Hungarisë, 1878-1918. Më gjerësisht: *Journal of Islamic Studies*, 5:2, 1994, July, M. Mufaku, f. 243. Po ashtu shih edhe: *The Bosniaks and the Challenges of Modernity...* Fikret Karci, *Bosniaks and the challenges of modernity*, f.50-70

²⁰⁶Skënder Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 85-86,

Beu, i kishte thënë atij se numri i muhaxhirëve ishte 70.000... Kurse në territorin e vilajetit të Shkodrës ishin kryesisht muhaxhirët muslimanë të Malit të Zi. Sipas kriminelit, prof. Vasa Qubirloviqit, dëbimi i muslimanëve nga krahina e Malit të Zi kishte rëndësi ekonomike dhe politike për popullsinë serb dhe dëshirat shekullore të malësorëve malazezë ishin për arat pjellore dhe kullosat e Nikshiqit, të Zetës etj... Këtë realitet e kishte pasur parasysh edhe Rusia, kur kishin lidhur Marrëveshjen e Paqes së Shën Stefanit, me ç'rast e kishin nxitur Malin e Zi disa herë. Disa nga shqiptarët e krishterë u shpërngulën në Dalmaci.²⁰⁷

Për mua nuk është e qartë diçka në këtë aspekt. Ajo është se Perandoria Osmane kishte ndërmarrë një politikë që t'i ndalonte muhaxhirët muslimanë që të riatdhesheshin (riktheheshin) në vendet dhe pronat që kishin lënë, sa që në disa raste muhaxhirët i kishin vrarë disa zyrtarë të Perandorisë Osmane për shkak se i ndalonin ata.²⁰⁸ Për mendimin tim u desh që atyre t'u lejohej të ktheheshin në pasuritë dhe shtëpitë e tyre, kolektivisht ose individualisht. Nëse ushtria serbe dhe malazeze i kish luftuar ata që të dilnin prej shtëpive të tyre, atëherë ata është dashur të vetëmbroheshin dhe të vdisnin si shehidë, duke i mbrojtur familjet e veta, mu ashtu si ka thënë Muhamedi a.s. në një hadith se: *“Ai, i cili vdes duke e mbrojtur nga armiku nderin e familjes së vet, pasurinë dhe fenë e tij, vdes si shehid.”*²⁰⁹

²⁰⁷ Po aty , f. 87-88.

²⁰⁸ Më gjerësisht shih: Skënder Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 87-88.

²⁰⁹ Imam Shejh Nasiruddin el Albani thot se këtë hadith e transmeton Imam Ebu Davudi ne Sunenin e tij, vell, 2, 275, Imam Nesaiu dhe Tirmidhiu në Sunenin e tyre, vell. 2, 316 me sened-zinxhir të saktë dhe të vërtetë. Refereoju websajtit: <http://www.ahlalhdeth.com/vb/showthread.php?t=211117>

Nga një rast tjetër historik shihet se veziri i madh i Perandorisë Osmane, Safvet Pasha, i kishte shkruar mbretit të Malit të Zi, kral Nikolës, që muhaxhirëve t'u kthehej pasuria dhe t'u sigurohej jeta,²¹⁰ prandaj rasti i mëparshëm mund të komentohet se në Perandorinë Osmane, për shkak të dobësisë së saj të kohëve të fundit, nuk kishte status të qartë dhe të prerë për çështjen e muhaxhirëve që të ktheheshin, apo të qëndronin, apo të shpërndaheshin nëpër botë.

Për muslimanët e Malit të Zi ishte një sprovë dhe sfidë e rëndë...ose të shërbenin në ushtrinë malazeze jomuslimane ose t'i lëshonin vatrat dhe shtëpitë e tyre. Gjatë historisë sonë nuk kemi hasur ndonjë rast që muslimanët t'i kenë shërbyer ushtrisë serbe apo malazeze. Ata janë treguar shumë të besueshëm dhe të përqendruar në fenë e tyre islame. Rastet e konvertimit me dhunë në ortodoksizëm janë shumë pak në krahasim me zullumin dhe presionin e ushtruar mbi ta nga qeveria serbe, malazeze, ruse, bullgare etj. Dukuria e qëndresës së tyre heroike, patriotike e islame meriton një analizë dhe studim të posaçëm.

Po ashtu, edhe muhaxhirët që ishin vendosur nëpër disa vende të okupuara të Greqisë, sipas burimeve osmane, frënge, angleze etj., kërkonin që të ktheheshin në vatrat dhe vendet e tyre.²¹¹

Një prej pasojave negative që iu bënë popullsisë muslimane shqiptare ishte se qytetet më të mira të Shqipërisë Jugore iu falën Greqisë, dhe u ndryshuan kufijtë në favor të shteteve të huaja.²¹² Spastrimi etnik që u bë ndaj muslimanëve të

²¹⁰ *Lidhja Shqiptare e Prizrenit* f. 86. Krahaso: Muhamed Mufaku, **Journal of Islamic Studies**, 5:2, 1994, artikullin: *Islam and Muslims in Bosnia, 1878-1918*, po ashtu artikullin: **Two hijras and two fatwas**, f. 242-253,

²¹¹ S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 89.

²¹² S. Rizaj, 89, për më gjerësisht shih: Daut Hoxha, *Viset kombëtare shqiptare në shtetin grek*, f. 85, 99, 139, 170, 224, 233.

Ballkanit, e sidomos shqiptarëve dhe boshnjakëve, një dëm ky antihuman dhe antireligjioz, u bë me qëllimin e shfarosjes dhe zhdukjes së muslimanëve, nëpërmjet sëmundjeve, epidemive të ndryshme, varfërisë, vdekjes, ndarjes në grupe të vogla, në mënyrë që ata të humbnin dhe asimiloheshin më lehtë...

I lartë është Allahu xh. sh. që na ka paralajmëruar, qysh para katërmëdhjetë shekujve, se çfarë dëshirojnë armiqtë (të krishterët dhe çifutët) prej muslimanëve: ose të bëhemi si ata, ose përndryshe vrasje, varfëri, poshtërsi, masakra, gjenocid, sëmundje, epidemi etj...²¹³

Me të vërtetë, këto kanë qenë sfida të rënda për muslimanët e Ballkanit, e sidomos për shqiptarët gjatë historisë dhe muslimanëve të kohës sodit.

D-Pasojat e emigrimit

Sipas historianit prof. S. Rizajt, pasojat ishin politike, demografike, ekonomike dhe sociale...por unë nuk i përjashtoj edhe dëmet fetare. Në radhë të parë, ata që përfitonin në aspektin politik, ekonomik dhe social ishin serbët. Në lidhje këtë, asambleja kombëtare serbe, më 3 janar 1880, miratoi

²¹³ Edhe lufta aktuale në Siri që hyri në vitin e tretë tani, dhe numri i viktimave që kaloi: 100.000.00, (njëqind mijëshin), dhe që numri i të dëbuarve, azilëve, kaloi: 9.000.000 (nëntë milionshin), e që numri i të plagosurve, të dhunuarve, foshnjeve, grave, pleqëve të masakruar, të prerë, të djegur...etj, vetëm një Allah i lartëmadheruar e din numrin e saktë!!! A ndërsa komuniteti ndërkombëtar, Nato-ja, Kuvendi i Kombeve të Bashkuara, shtetet fuqiptotë rine duar kryqë! A ndërsa aleatët e Sirisë, Rusia, Kina, Irani, Hizbullahu, ata e përkrahin regjimin gjakpirrës të Asadit!! Turp Rusisë! Turp Kinës! Turp Iranit dhe Shiave të Iranit dhe të Hizbullahut!! dhe turp botës Perëndimore dhe asaj Lindore për zhgënjimin e tyre ndaj vëllezërve të tyre në Siri. Ndërsa muslimnët anëmbanë botës mjerisht i përsjellin lajmet e BBC-së, CNN-it, Al Jazeera-së, Al Arabiya, Press TV, France 24, etj..., e tërë kjo dëshmon për korektësinë e ajeteve Kur'anore dhe realitetin faktik të teorisë sonë, se kur është në pyetje Islami dhe Muslimanët ndërrojnë të gjitha rregullat matematikore të njerëzisë dhe të gjitha barazimet kimike dhe fizike dalin keq!?!?. Allahu ju ndihmoftë atyre në Siri. Amin

ligjin për popullzimin e vendeve të reja të “çliruara”. Është me vlerë historike dhe fetare të përmendet këtu edhe deklarata e kriminelit, fanatikut serb, Vaso Çubriloviq, i cili ka thënë:

“... Procesi i dëbimit të turqve [të turqve, shqiptarëve, boshnjakëve, çerkezëve] të mbetur pa u dëbuar nga qytetet dhe popullzimi i fshatrave shqiptare të shkatërruara u bë më shpejt se sa mendohej. Nga Metohija (Dukagjini) nga Kosova dhe nga Sanxhaku, Jeni Pazari, shumë serbë kaluan në Serbi pas vitit 1878, të brengosur pse vendlindja e tyre (Kosova) nuk u “çlirua” (pushtua). Këta serbë të shtypur nga “zullumet” e shqiptarëve²¹⁴ u vendosën në Toplicë. Edhe fshatarët serbë zbritën nga fshatrat malore. Gradualisht erdhën edhe malazezët. Kështu fshatrat lindën si nga toka. U hapën pyjet dhe u punuan tokat ”²¹⁵

Humbja e Serbisë në aspektin ekonomik dhe politik shihet edhe nga deklarata e një serbi, Milan V. Smilamiqit. Ai ua kishte tërhequr vërejtjen serbëve disa herë se nëse shqiptarët, boshnjakët, turqit dhe çerkezët do të shpërnguleshin nga këto vise të banuara shqiptare, dëmet do të ishin më të mëdha²¹⁶.

Sipas Prof. S. Rizajt, humbjet financiare ishin të mëdha për Serbinë, sepse ajo vilte nga popullsia muslimane të ardhurat e tyre ekonomike, në të gjitha degët e ekonomisë, prej bujqësisë, blegtorisë, zejtarisë dhe tregtive të ndryshme intensive. Nga

²¹⁴ Skënder Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 91.

²¹⁵ S. Rizaj thotë: “..Zullumet e shqiptarëve mbi serbët e vendit, të vilajetit të Kosovës, nuk mund të pranohen si fakt historik. Është shpifje flagrante. Përkundrazi, Lidhja Shqiptare i ka marrë serbët nën mbrojtje...Në të vërtetë, në këto vise kur nuk ka pasur serb në pikëpamje etnike. Serbët e Kosovës ishin natyrisht shqiptarët dhe vllahët ortodoksë që i takonin kishës serbe, më saktë që e dëgjonin meshën në gjuhën kishtare sllave...” S. Rizaj, f. 97-98. Shih edhe: ‘Feja në shërbim të kombit’, Shefqet Dibrani: www.yahoo.groups.com

²¹⁶ S. Rizaj, f. 93.

aspekti politik, pasojat po ashtu ishin të mëdha, sepse u krijua urrejtja dhe mosbesimi. Deri dje ata ishin si vëllezër, kurse tani miqësia ndërmjet shqiptarëve ortodoksë dhe serbëve u prish. E njëjta gjë ndodhi edhe me shqiptarët e Malit të Zi, ndërmjet shqiptarëve ortodoksë-shkizmatik dhe malazezëve, ndërmjet shqiptarëve dhe grekëve, shqiptarëve dhe bullgarëve dhe kështu u krijua përçarja kombëtare dhe fetare që nuk u shua deri në ditët e sotme.²¹⁷

Sa i përket dëmeve sociale në njerëz dhe dëmeve materiale nëpër shtëpi dhe në infrastrukturë,²¹⁸ prof. S. Rizaj përmend edhe një statistikë që përputhet edhe me studimet e disa serbëve. Rrethina e Leskovcit kishte 87 fshatra, 2.445 shtëpi, 16.327 banorë. Prokupla kishte: 72 fshatra, 1.785 shtëpi dhe 13.239 banorë. Gjithsej 227 fshatra, 5.793 shtëpi dhe 42.300 banorë.²¹⁹

Vilajeti i Kosovës ishte bërë qendër për stacionimin e muhaxhirëve, kështu që numri shtohet dita-ditës, por, në të njëjtën kohë, edhe zvogëlohet dita-ditës sepse prej Kosovës muhaxhirët merrnin rrugën e Azisë, Arabisë etj. Ajo çka është e vlefshme të ceket këtu, është se, gjatë kohës së shpërnguljeve në Kosovë dhe prej Kosovës, numri i çifutëve (i jahudive), më

²¹⁷ Shih, Skënder Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 93.

²¹⁸ Sa i përket dëmeve apo humbjeve ekonomike të qeverisë osmane, është me rëndësi të përmendet se Perandoria Osmane ka humbur ekonomikisht duke treguar kujdes për muhaxhirët, për stacionimet e tyre, sëmundjet, udhëtimet, ushqimet etj., mirëpo, në anën tjetër, Perandoria Osmane ka përparuar në aspektin ekonomik dhe bujqësor me ardhjen e muhaxhirëve. Atyre u jepeshin tokat e shtetit për t'i punuar, dhe si rrjedhin prodhimet bujqësore u shtuan dhe ekonomia blegtore kaloi në përparim të dukshëm... Më gjerësisht shih: S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 90-91, 95.

²¹⁹ Po aty, f. 94.

1878, ishte vetëm 50 në Prishtinë, ndërsa në Prizren asnjë, elhamdulillah...²²⁰

KREU I TETE

Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe rëndësia e saj historike (1877-1885)

A- Themelimi dhe formimi i Lidhjes

Si pasojë e Krizës Lindore, Fuqitë e Mëdha evropiane, që tentonin të siguronin pavarësinë e shteteve sllave që ishin fqinje me shqiptarët si p.sh. Malit të Zi, Serbisë, Bullgarisë, Maqedonisë etj., kishin planifikuar Kongresin e Berlinit²²¹ dhe Marrëveshjen e Paqes së Shën Stefanit,²²² ku ato i kishin vulosur kërkesat e serbëve dhe malazezëve që tokat shqiptare të copëtoheshin dhe t'u dhuroheshin atyre principatave sllave, duke i realizuar kështu synimet e tyre shekullore për okupimin e këtyre vendeve dhe për asimilimin etno-kulturor dhe religjioz të shqiptarëve. Prandaj situata ishte aq e vështirë sa që u vu në pikëpyetje nëse shqiptarët të ekzistonin apo të zhdukeshin nëpërmjet metodave edhe mjeteve që ishin në disponim.

Kur t'i kemi në konsideratë këto rrethana politike dhe ndërkombëtare dhe rrezikun etnik, fetar,²²³ gjeografik dhe

²²⁰ Po aty, f. 95.

²²¹ Këtë e vërteton edhe studiuesi serb Branislav Nushiç, i cili thotë: “Më 1878, me rastin e përfundimit të marrëveshjes së Berlinit, shqiptarët ngritën krye sepse në atë marrëveshje ishte dashur të zvogëlohej toka e tyre: një pjesë Serbisë, një pjesë Malit të Zi, një tjetër Greqisë...” S. Rizaj, f. 109.

²²² Rreth themelimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe Traktatit të Shën Stefanit shih edhe: *Historia e Shqipërisë*, vëll. 2, f. 197-209.

²²³ Frika nga sllavizmi dhe serbizmi që u kanosej shqiptarëve me besimin musliman dhe katolik. S. Rizaj, f. 108.

politik të shqiptarëve, atëherë mundemi ta kuptojmë më mirë rëndësinë e këtij revolucioni të gjithëmbarshtëm shqiptar, rëndësinë²²⁴ e kësaj Lidhjeje Shqiptare, vlerën e kësaj rezistence dhe të rebelimit të shqiptarëve ndaj Perandorisë Osmane.

Kjo rezistencë, edhe pse dështoi në realizimin e synimeve të saj dhe u shua nga ushtria e Perandorisë Osmane me metoda dhe mënyra të ndryshme, qofshin ato militare, propaganduese, diskredituese, ideale etj., megjithatë e pati efektin e saj deri-diku dhe, për mendimin tim, nuk ishte e nxitur prej shteteve katolike apo ortodokse si ato rezistencat e mëparshme gjatë shekujve. Po ashtu, kjo Lidhje apo rezistencë kishte deri-diku edhe karakter fetar. Më poshtë do të njihemi me themeluesit kryesorë të kësaj Lidhjeje, me synimet, kërkesat dhe aktivitetet e tyre në pika të shkurtra.

Për historikun e kësaj Lidhjeje, kryesisht do t'i referohem historianit dhe dijetarit shqiptar, Prof. Dr. Skënder Rizajt. Sipas tij dhe sipas disa studiuesve anglezë që ka përmendur ai:

“Në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit ka shumë të krishterë si edhe muslimanë. Ata janë si vëllezër dhe se nuk ka kurrfarë dallimi në mes tyre. Ata, në radhë të parë, janë shqiptarë e pastaj gegë e toskë.”²²⁵

Për ta arsyetuar disi ekzistencën e elementit të krishterë në themelimin e Lidhjes, prof. Skënderi përmend edhe studiuesin e krishterë libanez, Georges G., Corn, i cili në disertacionin e

²²⁴Rreth lojërave të shteteve të mëdha evropiane dhe tregtisë së tyre me tokat shqiptare në Kongresin e Berlinit, shih edhe: Tajar Zavalani, *Historia e Shqipërisë*, (Phoenix, Tiranë, botimi i 2-te, Soros- Mendimi Shqiptar), f. 170.

²²⁵S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 20; T. Zavalani, *Historia e Shqipërisë*, f. 175

doktoratës së tij, të mbrojtur në universitetin e Sorbonës në Paris, me titull: “*Bashkësitë multikonfesionale - Multikonfesionalne zajednice*,” ka thënë se: “...Lëvizja kombëtare filloi në vitin 1878, e udhëhequr nga personalitetet islame [nga haxhi sheh myderriz Ymer Prizreni] dhe Lidhja e Kuvendit të Shkodrës, e udhëhequr nga personalitete të krishtera [Prek Bibë Doda]. Ata e shpallën origjinën e vet të përbashkët etnike, me ç’rast ndryshimi fetar ishte i parëndësishëm. Ky zgjim kryesisht shpjegohet me renesancën kulturore dhe gjuhësore, të trimëruar nga veprat e shqiptarëve në diasporë [të SHBA-së, Italisë, e veçanërisht të Egjiptit]. Në atë zgjim, në masë të barabartë, morën pjesë edhe të krishterët edhe muslimanët, të cilët duke i kapërcyer rrethanat e veta fetare e gjetën përsëri përkatësinë të përbashkët etnike...”²²⁶

Megjithatë, për mendimin tim, ky arsyetim apo argumentim nuk qëndron i fortë për disa shkaqe. Në rend të parë, numri i të krishterëve, në krahasim me atë të muslimanëve, ka qenë shumë i vogël. Kjo është e dëshmuar edhe historikisht. Në rend të dytë, ky informacion u ka shkuar dhe u shkon për shtat historianëve marksist-leninistë dhe historianëve ateistë, qofshin ata nga perëndimi, sikurse ata anglezë, apo nga Libani, sikurse ai studiuesi i krishterë.

Sipas prof. S. Rizajt, elementi i krishterë ka qenë i paevitueshëm në Lidhje, me qëllim që të formohej një forcë më e madhe rezistuese. Edhe kjo dëshmi e kronistit turk Mehmet Ali Ayni, që përmend prof. S. Rizaj, tregon shkaku e lindjes së Lidhjes Shqiptare:

“Si pasojë e luftës ruse-osmane (1877), shtetet ballkanike do të zgjeroheshin në dëm të Shqipërisë. Kjo situatë i shtyri shqiptarët të mendojnë për ardhmërinë e vet. Nëse do të

²²⁶S. Rizaj, f. 24

rrënohej Perandoria Osmane, cila do të ishte gjendja e tyre? Si do ta pranonin robërinë e grekëve dhe të sllavëve? Prandaj ata formuan Lidhjen Shqiptare, me qëllim që në Shqipëri të formonin qeverinë kombëtare shqiptare dhe ta shkëputnin Shqipërinë nga qeverisja osmane.”²²⁷

Pra, si po shihet deri tani, dhe ashtu siç kemi treguar edhe më lart, gjendja e shqiptarëve në përgjithësi rrezikohej prej shteteve fqinje sllave në çdo aspekt. Mirëpo përkundër ekzistimit të elementit të krishterë, duhet të kihet parasysh fakti se numri i atyre personave mund të numërohej me gishta. Prandaj elementi i krishterë duhet të merret në një dimension shumë të ngushtë, sepse vetë historia e së kaluarës së tyre dëshmon për këtë bashkëpunim të vogël dhe të ngushtë me shqiptarët muslimanë.

Po ashtu, ai përmend edhe raportin e konsullit anglez në Prizren, St. Johan, në të cilin thuhet: “Komiteti i Lidhjes Shqiptare, i përbërë nga 36 anëtarë, prej të cilëve 2/3 janë klerikë muslimanë (myderrizë, myftilerë, kadilerë), dje mbajtën mbledhjen ku përpiluan petitionin për Sulltanin në lidhje me formimin e republikës shqiptare... Në këtë republikë, të gjithë banorët, pavarësisht nga përkatësia e tyre fetare, do të jenë të barabartë dhe nuk do të lejohet që t’u bëhet asnjë zullum të krishterëve...”²²⁸

Për rëndësinë historike që ka peticioni i shqiptarëve, jam i mendimit që ai të shënohet më poshtë. Aty thuhet:

“Populli shqiptar, në memorandumit e vet, në mars të vitit 1878, ndër të tjera, ka nënvizuar se në qoftë se Evropa do ta miratojë vetëvendosjen e sllavëve për shtete të pavarura apo

²²⁷ S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 115; marrë nga Mehmet Ali Ayni, *Milliyetçilik*, f. 279-280.

²²⁸ Po aty, f. 27.

autonome, është e qartë se shqiptarët nuk mund të kënaqen me një administrim aq të kalbur dhe të keq, siç është ai në të cilin kanë qenë gjer me sot. Ata janë të bindur, në të njëjtën mënyrë sikurse edhe shtresat e tjera të perandorisë, se pushteti osman s’do dhe as që ka mundësi t’u japë atyre një gjë më të mirë... Po qe se, pra, Bullgaria, Serbia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, do të shkëputen pak a shumë nga Perandoria dhe do të vetëvendosin si të dëshirojnë, për sa u përket interesave të tyre nacionale, nuk ka asnjë arsye që t’i detyrojnë shqiptarët që të heqin dorë nga përparësitë e një qeverisjeje autonome apo nga dëshira për të parë depërtimin e një rrezeje të qytetërimit në atdheun e tyre, të cilin injoranca dhe keqpërdorimi e kanë mbështjellë në hijen e mjerimit dhe të degradimit... Të gjithë shqiptarët kanë vendosur t’i këpusin zinxhirët që i kanë lidhur me Perandorinë Osmane dhe kërkojnë një qeveri të ndarë, e cila do të jetë në harmoni me kërkesat dhe traditat e tyre; ata kërkojnë të drejtën për të hyrë në gjirin e familjes së madhe evropiane së cilës i përkasin për nga raca dhe farefisnia...”²²⁹

Shpresoj se në fund të këtij vështrimi, lexuesi do të ndahet i kënaqur me punën tonë. Nëse ia kemi qëlluar, kjo është nga Allahu Fuqiplotë, e nëse nuk ia kemi arritur qëllimit tonë, kjo është pasojë e mendimit tonë dhe e lusim Allahun për falje.

B-Rëndësia e Lidhjes

Për rëndësinë²³⁰ e madhe historike, politike dhe fetare që ka kjo Lidhje, do të ndalemi më gjatë se sa për ngjarjet e tjera.

²²⁹ S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 24; marrë nga: The Public Record Office, London, F.O. 78/2784: The British Library, London, AAP(38)LXXXII, 298-302

²³⁰ Shih: *Muslim Identity and the Balkan State*, f. 142-143.

Si pasojë e Tanzimatit²³¹ administrativ shtetëror në Perandorinë Osmane ishte edhe krijimi, formimi dhe themelimi i kësaj Lidhje Shqiptare, me seli në Prizren. Kjo Lidhje erdhi si reagim i shqiptarëve ndaj qeverisë osmane që kishte marrë tatëpjetën e saj dhe, po ashtu, për shkak se çështja e identitetit shqiptar kishte arritur kulmin e rrezikut: të ekzistonte ky popull apo jo?

Është e udhës të shohim se çka na thotë studiuesi Dr. Ismail Bardhi rreth rrethanave dhe planeve ndërkombëtare në kohën kur u formua kjo Lidhje. Siç thamë më lart pyetja ishte se:

“...Të ekzistonte ky popull apo jo? Shumë strategë të ndryshëm, psikologë, sociologë, politikanë etj., janë marrë me shkrime për çështjet e shqiptarëve në Ballkan...Në dekadencën dhe tatëpjezën e Perandorisë Osmane, padrejtësi e madhe u bë muslimanëve, si në aspektin gjeografik, ashtu edhe politik. Një ndër padrejtësitë kryesore ndaj shqiptarëve ka qenë edhe ajo në fund të shek. të XIX-të në konferencën e Berlinit, ku ata u konsideruan si turq për shkak të përkatësisë së fetare islame. Kjo konferencë ishte si parapërgatitje për spastrimin e shqiptarëve prej territoreve të tyre, ashtu si janë spastruar muslimanët nga vendet e tjera. Kështu, në Konferencën e Londrës, u mor vendimi që trojet shqiptare të ndahen mes disa shteteve fqinje. Një pjesë e trojeve iu dha Greqisë,²³² një pjesë

²³¹ Mehmet Maksudoglu, *Ottoman History...*, f. 344.

²³² Fanariotët grekë, për shekuj me radhë, e kanë keqpërdorur patriarkanën e Stambollit për t'i helenizuar popujt e tjerë jo ortodoksë, si shqiptarët, romët, vllahët etj., sepse kjo patriarkanë e kontrollonte sistemin e mileteve në Perandorinë Osmane...Shih *Muslim Identity and the Balkan State*, f. 17. Për masakrat, gjenocidin, grabitjen dhe plaçkitjen e pasurisë së muslimanëve shqiptarë në Greqi, deportimin masiv të tyre, fushatat e pushtetarëve shqiptarë athino-fanaritë, vërshimin masiv të të krishterëve grekë mbi tokat e shqiptarëve muslimanë në Çamëri, Janinë, Pogon, Konicë etj. rekomandohet të lexohet libri i historianit dhe studiuesit shqiptar musliman nga Çamëria, Ibrahim Daut Hoxha, me titull: *Viset kombëtare shqiptare në shtetin grek*, (Shtëpia Bot. Hasan Tahsini, Bot. i parë, Tiranë, 2000), të cilin e pata nderin ta vizitoja në shtëpinë tij modeste, në Tiranë, së bashku me Dr. Ramiz Zekaj,

*Maqedonisë, një Serbisë, një Malit të Zi, ndërsa vetëm një pjesë mbeti e banuar në Kosovë, dhe kjo e fundit u desh të jetë përbrenda mbretërive serbe-jugosllave. Në konferencën e Varshavës, më 1919 dhe të Parisit, kjo çështje u bë më shumë e evidente. Po ashtu edhe me konferencën e Dejtonit shqiptarët u lanë anash...Sa herë që shqiptarët kanë tentuar të bashkohen me ndihmën dhe përkrahjen e të huajve, ata i ka goditur tragjedia dhe dëmi i madh...*²³³

Me historikun e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e cila ishte edhe organizatë politiko-ushtarake, parti politike, lëvizje kombëtare shqiptare etj.,²³⁴ janë marrë shumë studiues shqiptarë dhe të huaj. Mirëpo mua më ka pëlqyer studimi dhe monografia e Prof. Dr. Skënder Rizajt, me të njëjtin titull (Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1877-1885), për shumë arsye, e ndër to veçojmë:

1-Se autori, gjatë ish-Jugosllavisë, në kohën e Titos, ka qenë një prej profesorëve, këshilltarëve, osmanologëve më të njohur dhe më të mëdhenj të Kosovës dhe të botës shqiptare (dhe është ende).

2-Se autori është njohës i mirë i disa gjuhëve dhe sidomos asaj të osmanishtes. Fakti tjetër është se ai ka punuar një kohë të gjatë (dhe ende punon me sa di unë) në arkivin qendror të Stambollit. Po ashtu, ai iu është referuar arkivave të ndryshëm botërorë dhe është konsultuar me burime të ndryshme të

më datën 15.08.2001. Më ka lënë përshtypje të madhe në zemër dhe në mendje për atë dituri, histori, moral dhe mikpritje të shqiptarit musliman që kishte. Allahu e shpërbleftë, i ndihmoftë dhe më mundësoftë që të përfitoj më tepër prej diturisë së tij herëve të tjera kur ta vizitoj in sha'Allahu Teala.

²³³Më gjerësisht shih artikullin e lartpërmendur në internet në gjuhën angleze: *Brief Survey of the Religious Situation and Games within the Albanian Ethnicum*, në: [www.http://msanews.mynet.net](http://msanews.mynet.net)

²³⁴S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 107.

publikuara dhe të papublikuara osmane, angleze, gjermane, frënge, serbe, ruse, italiane dhe shqiptare.²³⁵

C-Faktorët që ndikuan në lindjen dhe veprimtarinë e saj

Sipas S. Rizajt, në formimin dhe veprimtarinë e Lidhjes kanë ndikuar katër faktorë kryesorë:

1. Konfliktet dhe interesat e fuqive të mëdha imperialiste, në dëm të interesave shqiptare
2. Reformat politiko-shoqërore administrative të pushtetit qendror të Perandorisë Osmane, në dëm të interesave shqiptare
3. Dëbimi me dhunë i një numri të madh të shqiptarëve nga vatrat e tyre
4. Nevoja e domosdoshme për pavarësi apo autonomi...etj.²³⁶

Në fund besoj²³⁷ që ky prezentim i thuktë i historisë sonë antike dhe moderne nga këto këndvështrime islame, objektive, shkencore, globale, metodologjike na mjafton për argument që kjo histori është e sëmurë, pa vlerë, jo objektive, një anshme...etj, dhe se dëmshpërblimi i këtij ushqimi akademik të helmuar për gjeneratat që kanë shkuar është: *që kjo histori të rishkruhet rishtazi, tekstet shkollore dhe univerzitare të përpilohen rishtazi nga fillimi i kapitullit të parë gjer në halkën e fundit të saj*. Përndryshe; këtë gabim shkecor, akademik,

²³⁵ S. Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, f. 8.

²³⁶ Po aty, f. 8.

²³⁷ Kritikant objektive jo tendencioze, jo efenduese, të bazuara në fakte historike dhe logjike, të histories së përgjithshme njerzore, shqiptare dhe asaj islame; janë të mirseardhura dhe I marim parasysh dhe përfitojmë nga ato. Në këtë prezentim të shkurtë nuk e kemi ndjek rrugen e ofendimeve personale apo fetare në mënyrë paushalle. Çdo mendim, fakt historik e kemi bazuar në referenca përkatëse dhe kjo është mjaftë e pranueshme shkencërisht dhe akademikisht. As profeti Muhamed a.s. nuk ka shpëtuar nga kritikant.

politik dhe fetar; nuk da ta fal populli shqiptar, e as Allahu i Lartëmadheruar, në këtë jetë e as në Ahiret-botën tjetër.

Në fund të këtij studimi lus Allahun Fuqiplotë që këtë vepër ta pranojë nga unë dhe shpërblimin e saj të ma reservojë për atë ditë-Ditën e Gjykimit- kur nuk do të ketë dobi dhe vlerë asgjë te Allahu xh.sh, në përjashtim të veprave të sinçerta dhe atyre robërve të Tij që kanë qenë të sinqertë dhe me zemër të bardhe e të pastërt. Amin

Vessalamu Alejkum ve rahmetullah

Doha-Qatar

15.06.2013

Literatura e konsultuar

1. Ahmeti, Abib: *Theranda-Prizreni Nder Shekuj*, Orient, Prizren, 1996.
2. Ahmeti, Bajrush, *Perandoria Osmane dhe perhapja e Islamit ne trojet shqiptare dhe ne viset fqinje*, Prishtine, 1997.
3. Ajdini, Azem: *Masakra e Tivarit Serbo-Malazeze*, Edlor, Tirane, 1998.
4. Anton Ceta, Zymer Neziri, Myrvete Dreshaj, Sadri Fetiu, Mehmet Halimi: *Pajtimi i gjaqeve, 1990-1991*, Era, Prishtine, 2001.
5. Bajrami, Hakif: *Kosova-Njezet Shekuj te Identitetit te saj-Argumente Historike*, Era, 2000.
6. Bardhi, Ismail, *Hafiz Ibrahim Dalliu dhe egzgjyrza e tij Kur'anore*, Logos-A, 1997, Shkup.
7. Basha.Ali, *Islami ne Shqiperi Gjate shekujve*, Tirane, 2000.
8. Biberaj, Elez: *Albania a socialist Maverick*, USA, 1990.
9. Cana, Zekeria: *Gjenocidi i Malit te Zi mbi Popullaten Shqiptare 1912-1913, Dokumente*, Instituti Albanologjik I Prishtines, Prishtine, 1996.
10. Castellan, Georges: *Historia e Ballkanit, shek XIV-XX*, Cabej, Libra per nje shoqeri te hapur, 1991.
11. Cubrilovic, Vaso: *The Problem of Minorities in the new Yugoslavia - Truth on Kosova*.
12. Feraj, Hysamedin: *Skice e Mendimit Politik Shqiptar*. Logos-A, Shkup. 1997.
13. Fikret Karcic, *Islamic Studies - Islam in The Balkans*, Islamic research Institute, Intern ational Islamic University Islamabad, Pakistan, 1997.
14. Fikret Karcic: *The Bosniaks and The Challenges of Modernity - Late Ottoman and Hapsburg Time*, El-Kalem, Sarajevo, 1999.
15. Fischer, Bernd J.: *Mbreti Zog dhe perpjekja per stabilitet ne Shqiperi*, -Perktheu nga origjinali: Krenar Hajderi, Cabej, Tirane, bot. II, 1984.
16. Frasheri Naim: *Vepra Letrare*5, Naim Frasheri, Tirane, 1996, Qerbelaja, 13-316

17. Frasheri, Mehdi, *Historia e Lashte e Shqiperise dhe Shqipetareve*, Phoenix, Tirane, bot.II, 2000.
18. Frasheri, Sami: *Shqiperia C'ka qene, C'eshte, e C'do behete*, Dija, Prishtine, 1999.
19. *Gjenocidi Serb ne Kosove*, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qyteterimit Islam, Sesion shkencor, qershor 1999.
20. Hadri, Ali: *Historia e popullit shqiptar per shkollat e mesme*, Enti I teksteve dhe I mjeteve mesimore, Prishtine, 1967.
21. *Historia e popullit shqiptar, grup autoresh per vitin e katert te shkolles se mesme*. SH.B.L.SH.,2000.
22. *Historia e Popullit Shqiptar*: Universiteti Shtetror i Tiranes, Instituti i Gjuhesise dhe i Historise, bot. i trete, 1967.
23. *Historia e Shqiperise*: Akademia e R.P.S. te Shqiperise, Instituti I Gjuhesise, Tirane, 1984 .
24. *Historia e Shqiperise*: Universiteti Shtetror i Tiranes,1959.
25. Hoxha, Ibrahim Daut, *Viset Kombetare Shqiptare ne Shtetin Grek*. Tirane.
26. Hoxha, Ibrahim Daut: *Hoxhe Hasan-Tahsin efendiu-Te tjeret per te*, AIITC, Tirane, 1998.
27. Hoxha, Ibrahim, Daut: *Turqit dhe Shqiptaret*, Hasan Tahsni, 1994.
28. Islam in the Balkans, Lopasic, Alexander, *Islamization of the Balkans with special reference to Bosnia*.
29. J.Costa, Nicollas: *Albania – a European enigma*, Columbia University Press, New York, 1995.
30. Jacques, Edwin, E: *The Albanians - an ethnic history from prehistoric times to the present*, Mc. Farland & Company, Inc. Publishers Jefferson, North Carolina and Lindon, 1995.
31. Journal of Islamic Studies, 5:2, July 1994, Mufaku, Muhamed, *Two Hijras and Two Fatwas*.

32. *Journal Of Islamic Studies*: V. 5, No.2, July 1994, Oxford University Press,
33. *Journal of the International Institute of Islamic Thought and Civilization (ISTAC)*, Vol. 6:1, Abdal Rahijm, Muddathir, (*Muslim Minorities in Western Societies-The Medieval Scene*).
34. Justin McCarthy: *Death and Exile -The Ethnic Cleansing of Ottoman Muslims 1821-1922*, 3rd printing, USA, 1999.
35. Kola, Harrila: *Gjenocidi Serb ndaj Shqiptareve ne viset e tyre etnike ne Jugosllavi 1941-1967*, Elton, Tirane, 2000.
36. Krasniqi, Mark: *Toleranca fetare ne levizjet clirimtare te popullit shqiptar ne shek.XVII-XVIII - Feja, kultura dhe tradita islame nder shqiptaret*,
37. Maksudoglu, Mehmet: *Ottoman History Based Mainly on Ottoman Sources*, International Islamic University, Malaysia, 1993.
38. Malcolm, Noel: *Bosnia - A short History*, New York University Press, 1994.
39. Malcolm, Noel: *Kosova nje histori e shkurter*, KOHA, Prishtine, 2001, Perktheu nga anglishtja: Dr.Abdullah Karjagdiu.
40. Malcolm, Noel: *Kosovo - A Short History*, Harper Collins Publishers, New York University, 1998.
41. Michael, A. Sells: *The Bridge Betrayed- Religion and Genocide in Bosnia*, University of California Press, Berkely, 1996.
42. Mufaku, Muhamed: *Shqiptaret ne Boten Arabe*, Rilindja, Prishtine, 1990.
43. Nathalie Clayer, *Islam, State and Society in Post-Communist Albania Muslim identity and the Balkan State*, Hugh Pullton & Suha Taji - Farouki - editors, Hurst & Company, London, 1997.
44. Norris, H.T.: *Islam in the Balkans-Religion and Society Between Europe and the Arab World*, Hurst & Company, London, 1993.
45. P.Alpan - Kaci, Nesim: *Shqiptaret ne Perandorine Osmane*, Albin, Tirane, 1997.

46. Pirraku, Muhamed: *Kultura Kombetare Shqiptare deri ne Lidhjen e Prizrenit*, Instituti Albanologjik I Prishtines, Prishtine, 1989.
47. Pirraku, Muhamed: *Levizja gjithpopullore shqiptare per faljen e gjaqeve 1990-1992*, Kronike, (Instituti I Albanologjik I Prishtines, Prishtine, 1998.
48. Pllana, E: *The Deportation of Albanians from the Teritory of Sandjak of Nish of* , Truth on Kosova.
49. Polisi,Mehdi: *Sami Frasheri, Vepra 9, Personalitete Shqiptare ne Kamus al-A'lam*, Logos-A,Shkup,1994.
50. Poullton, Hough, & Farouki, Suha Taji, *Muslim Identity and the Ballkan State*, (Hurst&Company, London,1997.
51. Prifti, Kristaq: *Popullsia Myslimane Shqiptare ne Ballkan ne fund te shek. XIX dhe ne fillim te shek.xx (...)?*
52. Pulaha, Selami: *The Albanians in Kosova in the 12th -18th centuries in* -Truth on Kosova
53. Rizaj, Skender: *Historia e Pergjithshme, Koha ere 1453-1789*, Prishtine, Universiteti i Kosoves ne Prishtine, bot. dyte, 1983.
54. Rizaj, Skender: *Kosova Gjate Shekujve XV-XVI-XVII, Administrimi, ekonomia, shoqeria dhe levizja popullore*, Rilindja, Prishtine, 1982.
55. Shehu,Bedrush: *Qeshtje Shqiptare ne vitet 30 te shek.XIX*, Instituti Albanologjik ne Prishtine, 1990.
56. Shpuza, Gazmend: *Kuvendime per historine kombetare*, Shtepia botuese DITURIA, Tirane.
57. Shtylla, Z: *The Deportation of Albanians in Yugoslavia after the second World War 1950-1966*, Truth on Kosova.
58. Silajxhic, Haris: *Shqiperia dhe SHBA ne Arkivat e Washingtonit*, Albanija I SAD
59. Skendi, Stavro: *Zgjimi Kombetar Shqiptar*, Phoenix, Tirane, 1967.

60. Suflay,M: *The Illyrians, The Albanians, and the Sllavs - problems of continuity and symbiosis-Truth on Kosova.*
61. Swire, John: *Albania - the rise of a Kingdom*, Arno Press, The New York Times, New York, 1971.
62. *The Truth on Kosova*: The Academy of Sciences of the Republic of Albania, Institute of History, Encyclopaedia publishing house, Tirana, 1993.
63. Thengjilli, Petrika: *Historia Shqiperise*, Prishtine, 2001.
64. Thomas, Robert: *Serbia Under Milosevic - Politics in 1990s*, Hurst -Company, London, 1999,
65. Wilkes, John, *The peoples of Europe - The Illyrians*, Blackwell Publishers Ltd, Oxford, UK, 2000.
66. William Simpson & Martin Jones, *Europe, 1783-1914*, Routledge –Taylor and Francis Group, London &New York,1st publ.2000.
67. Zavalan,Tajar: *Histori e Shqipnise*, Londer, 1957
68. Zefi, Don Shan: *Islamizimi i Shqipetareve gjate shekujve*, Drita, Prizren, 2000.